



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

THËRRAS

Mbledhjen e XLIII-të (dyzetetë - mandati VII)-e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **12 shtator 2024**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës, në orën **10:00**, me këtë;

REND TË DITËS

1. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2024
2. Propozim vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025
3. Propozim vendimi për fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor të Komunës së Podujevës
4. Propozim vendimi për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës
5. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - *Njësia kadastrale P-437-1, ZK Podujevë*
5.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
6. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - *Njësitë kadastrale P-704-0 dhe P-706-0, ZK Llapashticë e Poshtme*
6.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
7. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - *Njësia kadastrale P-1615-4, ZK Orllan*
7.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
8. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - *Njësia kadastrale P-1119-0, ZK Balloc*
8.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
9. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - *Njësia kadastrale P-1057-0, ZK Balloc*
9.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
10. Të Ndryshme

Nr.Prot.01-060/03-0060274/24
Podujevë, datë; 03 shtator 2024



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XLII-të (dyzet e dy)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 31 korrik 2024.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokrri; Drita Pajaziti; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; kurse munguan; Qëndresë Hajrizi; Lirika Maliqi.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Donjetë Sheqiri; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; kurse munguan; Arjant Topanica; Ilir Koprani.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor.

Të pavarur, Demokrat Hodolli; Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Shuajb Blakçori-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS (U.D. drejtoresh); Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSH; Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;).

Të pranishëm ishin edhe Caleb Waugh dhe Samir Calaković përfaqësues të OSBE, media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar punë të mbarë në këtë mbledhje, ndër të tjera theksoi, ne mund të vazhdojmë me mbledhjen, kuorumi ekziston për momentin në sallë prezent janë 27 anëtar të Kuvendit ndërsa mungojnë 8 prej tyre, mungesat janë bërë të shpeshta dhe shumë herë të pa arsyeshme prandaj është mirë edhe ata që mungojnë të kenë arsyeime sepse sipas ligjit në fuqi secili anëtar i Kuvendit të Komunës është i obliguar të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit, nuk është kjo veç dëshirë dhe vullnet por është edhe obligim. Pasi kuorumi ekziston urdhëroni nëse ndokush dëshiron të marrë fjalën lidhur me rendin e ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, do të ishte më mirë të mos filloj seanca e re kur e dimë mirë që seancat e datës 23.05.2024 dhe ajo e datës 27.06.2024 nuk kanë përfunduar dhe jemi dëshmitar kur kalojnë pikat që i konvenojnë pushtetit dalin e lëshojnë mbledhjen dhe ne mbesim këtu pa kuorum dhe rrjedhimisht seanca nuk mbyllet, pastaj muajin tjetër vazhdon seanca tjetër. Në këtë vit vetëm njëherë është mbajtur pika Të Ndryshme, andaj qysh mund të fillojnë një seancë e re kur 2 seanca

nuk kanë përfunduar dhe janë të hapura, andaj së pari do të doja të vazhdojnë seancat që kanë mbet gjysmë e pastaj të vazhdojë kjo seancë e re ngase po sa të kalojnë pikat e juaja që i keni në interes ju po dilni nga salla dhe nuk po mund t'ju ndjekim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, seanca e kaluar ashtu ka qenë siç e potencoj z.Ekrem Rrahmani, është lëshuar mbledhja dhe kam propozuar që pika Të Ndryshme të diskutohet në mbledhjen e radhës, arsyeja ka qenë për mos me thirr vazhdimin e mbledhjes edhe pse ka qenë mundësia sipas ligjit që të thirret vazhdimi i mbledhjes vetëm për pikën që ka mbete pa u diskutuar.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, kam një propozim për ta shtuar pikë të re të rendit të ditës, bëhet fjalë për propozim vendimin për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të një prone të paluajtshme me sipërfaqe 338 m² në Zonën Kadastrale Llugë me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e trotuarit në këtë fshat. Gjatë realizimit të projektit i cili është i planifikuar për ndërtimin e këtij trotuari në atë pjesë është një pronë private ku për realizimin e këtij projekti duhet të shpallet në interes të përgjithshëm pjesa e pronës përkatëse dhe pastaj në fazat e mëvonshme të bëhet edhe procesi i këmbimit të pronës, mirëpo fillimisht Kuvendi i Komunës duhet që këtë pronë me atë sipërfaqe ta shpallë në interes të përgjithshëm publik, andaj ju kërkohet falje që po ju paraqesim këtë propozim brenda kësaj seance por kjo gjatë këtyre ditëve është shpallë si domosdoshmëri ku është dashur të bëhen edhe matjet gjeodezike nga gjeodetët e që ka marrë kohë dhe nuk kemi pasë mundësi që as në mbledhjen e KPF-së ta paraqesim këtë propozim, por ju ftoj që ta mbështetni këtë propozim sepse është në interes të atij fshati për ndërtimin e këtij projekti.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani mund të vazhdojmë me propozimin e drejtorit që të hyjë si pikë e rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe 2 pikat shitesë që janë shtuar dhe rekomanduar nga mbledhja e KPF-së por edhe këtë, ju pushtet jeni i keni mundësitë me na i sjellë fletët poseduese me numra dhe informata tjera sepse ne ekspertë apo gjeodetë nuk jemi që ta dimë se ku është ajo parcelë, çështje e cila nuk është e vështirë sepse këto mund të na i siguroj DPKGJ, sepse ne duhet ta dimë çka po votojmë. Të mos bëhemi makinë votuese këtu veç të ngrisim duart e të votojmë, unë mund t'i besoj drejtorit parafolës se ajo parcelë është në fshatin Llugë por pse të mos i shohim ato parcela dhe përse të vrapojmë duke i pyetur 20 persona për vendndodhjen e parcelës e që për 1 minutë kohë Drejtoria mund t'na e sjellë kopjen e planit dhe fletën poseduese për të qenë gjithçka në rregull për trajtim tutje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këto që parafolësi i potencoj dhe kërkoj, do të diskutohen kur të vije radha e kësaj pike ngase nuk është nevoja të hapet debat për propozime, por kur të shqyrtohet kjo pikë kurse tani jemi në fazën vetëm a të futet apo jo në rend të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, nuk mund të shprehesh ti për diçka që kërkohet sepse paraprakisht ishte një propozim, më vie keq që po më duhet në këtë formë ta kërkoj fjalën, nuk është hera e parë kjo dhe është për keqardhje kjo çka po ndodhë, mirëpo është kështu siç është situata dhe ne po mundohemi të veprojmë konform kësaj situatë që ju Kryesues po e krijoni.

Pra kemi dy propozime, propozimi i parë ishte nga z.Ekrem Rrahmani që përse të fillohet një seancë e re përderisa nuk janë përmbyllë dy tjerat paraprake kurse përgjigjja juaj ishte s'ka debat, më ka ardhë keq, s'më ka ardhë keq, unë ju them se nuk ka këtu më ka ardhë keq, s'më ka ardhë keq për një çështje që është e rregulluar me rregullativë ligjore, keqardhja është morale e njerëzore por atë duhet me përmbushë kurse çfarë shpjegimi morëm ne për pikën Të Ndryshme që u propozua, a e hedhe në votim, jo, e potencove atë që kam thënë edhe unë edhe dje në mbledhjen e KPF-së që rendi i ditës është shumë i gjerë dhe sërish duhet të veprojmë kështu, mirëpo kush vendos

këtu, a jemi ne që vendosim, andaj në këtë kontest e kisha fjalën kurse ti e kalove shumë në heshtje edhe propozimin e z.Ekrem Rrahmani dhe nuk e hedhe në votim që pika Të Ndryshme të vazhdoj. Krejt në rregull jemi për pikën që e propozoi drejtori parafolës dhe unë sërish po e potencoj se do ishte mirë që ne ta kemi një fletë/material sepse aty bëhet fjalë për 3 ari, do të thotë është një pjesë shumë e vogël por është shumë jetike për ndërtimin e trotuarit në rrugën që lidh fshatin në fjalë, dhe në këtë kontest jemi në rregull sepse është nevojë që e lidh komunitetin, ndërsa proceduralisht edhe unë e them se është dashur të përfillen procedurat në mënyrë që ta kemi nga një kopje të kopjes së planit dhe materialit tjetër përkatës, mirëpo duke pas parasysh nevojën dhe raportin e ndryshimit e që mendoj se është minor prej 3 ari që bëhet për nevoja të komunitetit, unë s'kam si mos ta mbështes atë, mirëpo ana procedurale ndoshta do të ishte mirë të përmbillet ashtu siç e përmendi kolegu.

Pra propozimin e parë nuk e hedh në votim i nderuar Kryesues, por e kalove në heshtje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë pa humbur kohë më shumë e vë në votim propozimin e z.Ekrem Rrahmanit që ishte për vazhdimin e seancave të datës 23.05.2024 dhe 27.06.2024 fillimisht dhe atë në pikat Të ndryshme që nuk kanë përfunduar e që për të cilat u kërkua të përfundohen në fillim të kësaj seance, pra të futen si pikë e parë e rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 11 vota janë Për, 12 vota Kundër dhe 1 votë e Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan), dhe nuk mbështetet propozimi i z.Ekrem Rrahmanit që fillimisht të vazhdojnë seancat e datës 23.05.2024 dhe 27.06.2024, me pikën Të Ndryshme që kanë mbet gjysmë, dhe atë në pikën e parë të rendit të ditës në këtë seancë, kurse pastaj të fillohet me këtë seancë të thirrur për sot.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ta e hedh në votim propozimin e drejtorit të DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ z.Fatlum Osmanit, që në kuadër të rendit në këtë mbledhje të përfshihet pikë shtesë edhe; propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pjesën e pronës private në fshatin Llugë-Komuna e Podujevës, me qëllim të realizimit të projektit “Ndërtimi i trotuarit në fshatin Llugë”.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota Për, 1 votë Kundër dhe 1 votë të Përmbajtur, (të tjerët nuk votuan) mbështetet propozimi që në kuadër të rendit në këtë mbledhje të përfshihet edhe propozimi i drejtorit të DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ z.Fatlum Osmanit, dhe atë:

- Propozim vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pjesën e pronës private në fshatin Llugë – Komuna e Podujevës, me qëllim të realizimit të projektit “Ndërtimi i trotuarit në fshatin Llugë”.

z.Valon Demolli, theksoi, edhe unë kam një propozim që pikën Të Ndryshme të kësaj mbledhje ta zhvendosim si pikë të parë të rendit të ditës, kjo pasi që pushteti nuk po ka kohë të pres për pyetjet tona prandaj mendoj se kjo do të ishte më e udhës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në rregull, e vë në votim propozimin e parafolësit z.Valon Demolli që pika Të Ndryshme e paraparë në pikën e fundit në këtë mbledhje, të renditet në pikën 1 të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se 13 vota janë Për, 14 vota Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, nuk mbështetet propozimi i z.Valon Demolli që pika Të Ndryshme e paraparë në pikën e fundit në këtë mbledhje, të renditet në pikën 1 të rendit të ditës.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, i nderuar Kryesues, e ke për obligim që te pika Të Ndryshme t'i mbash në sallë gjithë anëtarët e Kuvendit deri në fund të seancës, kjo meqë në dy votimet tona votove kundër e që nuk është në rregull, por meqë po voton kundër mbaje fjalën që edhe të dalësh i fundit nga seanca pasi që të përfundoj kjo seancë sipas rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, propozim dhe kërkesë e imja është që deri në fund të mbledhjes të jemi prezent në sallë që të gjithë. Nëse dëshironi mund ta vëm në votim propozimin e znj.Tringa Sfishta që deri në fund të pikave të rendit të ditës të jemi prezent në sallën e Kuvendit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues, je duke bërë shaka si duket sepse nuk ka nevojë të vëhen në votim propozime të tilla për të qëndruar në sallë apo jo, kjo sepse ne të gjithë i kemi marrë votat për të qëndruar në sallë dhe në seanca të Kuvendit, pra për çfarë propozimi bëhet fjalë.

z.Haki Rudari, theksoi, unë edhe më herët e kam thënë dhe po e them sërish sot se çdo herë do të jem kundër që pika e rendit të ditës Të Ndryshme të dal si pikë e parë e rendit të ditës, gjithashtu jam kundër që të lëshohen seancat, seanca nuk lëshohet derisa të përfundoj, do të thotë jam kundër të dyjave. Pikën Të Ndryshme ta vendosësh pikë të parë të rendit të ditës është sikur t'i thuash një mjeshtri që ta vendos kulmin së pari, pastaj të tjerat, kurse mjeshtri i mirë thotë, po shkoj në shtëpi sepse këtë nuk e bëjë, andaj edhe kolegëve të subjektit tim por edhe të gjitha subjekteve tjera ju them se nuk lëshohet seanca, a kritikohet ose jo ajo është çështje tjetër, ne jemi në debat këtu, seanca nuk lëshohet deri sa të përfundoj.

Një kërkesë e pati kolegu z.Ekrem Rrahmani, unë mendoj që është shumë e arsyeshme, materialin për çdo ndryshim të rendit të ditës duhet ta kenë anëtarët e Kuvendit, ne në mbledhjen e KPF-së materialin e kemi marrë, por tjerat që nuk kanë qenë që s'janë pjesë e KPF-së, është dashur ta kemi këtë material sepse nuk ka qenë ndonjë problem kushedi sa i Drejtorisë t'ia shpërndaj nga një kopje të materialit për secilin propozim që do të hyj si pikë shtesë në rend të ditës, kështu që secili anëtar i Kuvendit është dashur të pajiset me material.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i gjithë materiali është shpërndarë me kohë, mirëpo nuk është shpërnda vetëm ky i fundit siç e ceku z.Ekrem Rrahmani, fleta poseduese dhe kopja e planit.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë një fillim jo i mbarë i kësaj seance, një diçka që dikush në një kohë të caktuar edhe e ka quajtur tallava, dikush që qëndrimet dhe shqetësimet qytetare të cilat nuk po mund t'i kalojmë si pika të rendit të ditës, po i ngrisin në pikën Të Ndryshme, e që dikush të jetë kundër kësaj pike, në shumë vende ne e dimë që këtu jemi për Podujevë, por është e rregulluar *pyetje dhe përgjigje* si pikë e parë e rendit të ditës, jashtë rendit të ditës, por në dy seancat e kaluara ashtu siç e potencova në fillim të seancës, kjo pikë që vërtetë ka të bëjë drejtpërsëdrejti me shqetësimet qytetare aktuale që nuk arrijnë të artikulohen si pika të Kuvendit e që po i'u cungohet e drejta e përfaqësuesve të qytetarëve nga të cilët kanë marrë besimin që shqetësimet e tyre t'i ngrisin në këtë Kuvend për çka jemi dhe kjo formë besoj se nuk i bënë nder një qeverisje të mirë as një qeverisje transparente dhe asnjë qeverisje llogaridhënëse, dhe këtë po e them se të cungosh të drejtën e atyre që kanë shqetësime që përmes përfaqësuesve të tyre t'i paraqesin në tempullin e demokracisë, në tempullin ku e mban qytetari përgjegjës për votën e tij që dikujt ja ka besuar e që është Kuvendi i Komunës, vërtetë është e pa kuptimtë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kam një pyetje, njëra prej pikave që u shtua që është ajo prona për çerdhe, ky material a është për atë pikën që ka kaluar këtu në Kuvend e është kthyer sërish apo është ndonjë pronë tjetër dhe një pikë tjetër. Nëse ju janë kthyer dokumentet juve nga Ministria i nderuar Kryesues a duhet të na njoftosh dhe të na i sjellësh ato letra dhe të na japësh arsyetim se deri ku ka mbërritur procesi dhe çka ka vendos Ministria apo vetëm e mbanë atë dokument në dollap ti, për këtu dy çështje pres sqarim nga ti.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kur t'ju vie radha atyre pikave të rendit të ditës do të diskutojmë lidhur çështjet e ngritura, prandaj pa humbur kohë më shumë unë e vë në votim rendin e ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe dy pikat shtesë të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe pikën shtesë të përkrahur në këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 19 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbytur (të tjerët nuk votuan), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe dy pikat shtesë të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe pikën shtesë të përkrahur në këtë mbledhje paraprakisht.

Rendi i miratuar i ditës:

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 29 mars 2024; 23 maj 2024; 19 qershor 2024 dhe 27 qershor 2024

2. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizim me mekanizëm bujqësor"

3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizim me mëshqerra"

4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizim me sera"

5. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme shoqërore - "Mekanizmi" nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë: Njësitë kadastrale 00244-2 dhe 00244-3 në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit "Ndërtimi i objektit për Banim të Përbalueshëm".

6. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Llapi" Sh.A. në Podujevë

7. Raporti Financiar për periudhën janar - qershor 2024

8. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2023

8.1. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit

9. Propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit nr.prot.01-016/01-0045377/23 për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës

10. Propozim vendimi për inicimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të Hollësishtëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1

11. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-163-0, ZK Siboc i Epërm

11.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim.

12. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-297-0, ZK Dobratin

12.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

13. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-1, ZK Dobratin

13.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

14. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-2, ZK Dobratin

14.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

15. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-336-0, ZK Dobratin

15.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

16. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-640-0, ZK Lupç i Poshtëm

16.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

17. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1392-0, ZK Dobërdol

17.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

18. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1378-0, ZK Dobërdol

18.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

19. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-1, ZK Dobërdol

19.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

20. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-2, ZK Dobërdol

20.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

21. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronat nën menaxhimin e AKP-së, me qëllim të realizimit të projekteve: Muzeu i Qytetit; Ndërtimi i banimit me kosto të përballeshme; Objekt arsimor – Çerdhe; Ndërtimi i parkut.

22. Propozim vendimi për Transferin e buxhetit të Komunës për vitin 2024

23. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronën private në fshatin Llugë – Komuna e Podujevës, me qëllim të ndërtimit të trotuarit në fshatin Llugë.

24. Të Ndryshme

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 29 mars 2024; 23 maj 2024; 19 qershor 2024 dhe 27 qershor 2024

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, janë katër procesverbale të mbledhjeve dhe tani po i vëm në votim secilin veç e veç, mirëpo urdhëroni fillimisht nëse ndokush ka ndonjë plotësim ndryshim apo vërejtje eventuale rreth këtyre procesverbaleve.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, e kam lexuar procesverbalin e datës 29.03.2024 dhe me të vërtetë u bëra i dyshimtë a kam qenë prezent në seancë apo jo sepse në dy vende në fillim në njërin anën thuhet që kam qenë prezent, pastaj në fjalimin tënd Kryesues thuhet që mungoj, ndërsa unë me leje të kam njoftuar që vonohem rreth 20 minuta për arsye se kam pas probleme shëndetësore.

Pra unë kam qenë prezent në seancë dhe është mirë të përmirësohet procesverbali dhe të ceket se është vonuar Xhevdet Maloku dhe jo ka munguar komplet seancën.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, faleminderit i nderuar mirëpo ashtu siç keni thënë ashtu kam thënë edhe unë në mbledhje, kam thënë z.Xhevdet Maloku mungon për pak kohë me arsyetim, kam thënë se do vonohet rreth 20 minuta, këtë e kam thënë në mbledhje.

Urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth procesverbalit të datës 29.03.2024, nëse jo atëherë e vë në votim, me korigjimin e diskutimit të fjalimi hyrës i Kryesuesit ku thuhet që z.Xhevdet Maloku “mungon”

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri, me 28 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime, procesverbali i mbledhjes së Kuvendit të mbajtur më 29 mars 2024, me korrigjimin e diskutimit te fjalimi hyrës i Kryesuesit ku thuhet që z.Xhevdet Maloku “mungon”, riformulohet si vijon; “...kurse për momentin mungojnë 8 e prej tyre 2 dy janë me arsyeje dhe të cilët më kanë njoftuar, Demokrat Hodolli i cili më ka njoftuar se nuk mund të merr pjesë në këtë mbledhje, dhe Xhevdet Maloku i cili më ka njoftuar se vonohet rreth 10 minuta.. .”

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri, me 28 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime, procesverbali i mbledhjes së Kuvendit të mbajtur më 23 maj 2024.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri, me 28 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime, procesverbali i mbledhjes solemne të Kuvendit të mbajtur më 19 qershor 2024.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri, me 28 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, miratohet pa vërejtje apo plotësim ndryshime, procesverbali i mbledhjes së Kuvendit të mbajtur më 27 qershor 2024.

2. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me mekanizëm bujqësor”

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, projekti për furnizim me mekanizëm bujqësor i cili është i planifikuar në buxhetin e Komunës së Podujevës dhe në planin e prokurimit, i cili është realizuar në këtë vit.

Në bazë të Rregullores dhe thirrjes publike fermerët janë të obliguar që të participojnë me 30%, të vlerës së projektit dhe për këtë shumë buxhetore për të cilën participojnë fermerët është e domosdoshme që të kalojë në Kuvendine Komunës në mënyrë që të realizohet projekti në fjalë.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me mekanizëm bujqësor” në shumë prej 41,610.00€, pra shuma e përgjithshme e projektit është 138,700.00€, ndërsa participimi nga 30% e jep atë shumë që e ceka më herët, prandaj konsiderojmë se është në interes të fermerëve dhe qytetarëve andaj në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë propozim.

z.Valon Demolli, theksoi, sa i përket propozim vendimit për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me mekanizëm bujqësor, në një rrethanë normale nuk do duhet të diskutohej për propozim vendimet për hapjen e kodeve të reja për mekanizëm bujqësor, mëshqerra dhe sera, kurse sot jemi në një situatë ku ne si Grup i LDK-së nuk do të votojmë për arsye se nuk dëshirojmë të jemi pjesë e keqpërdorimit të buxhetit të taksapaguesve Llapjan.

Të gjithë jemi dëshmitar se ky Kryetar me Ekzekutivin e tij që në fillim të mandatit anuloi listën e fermerëve përfitues të motokultivatorëve me arsyen se ishin militantë të LDK-së, për t’i shpërblyer militantët dhe jaranat e tij. Pastaj skandalet nuk i ndali kur ndau mjete me vendim të veçantë për fermerin Fadil Behrami për dëmet e shkaktuara në makinerinë e tij bujqësore mirëpo atë pastaj e anuloi dhe nuk e publikoi në ueb faqe të Komunës. Se ky Ekzekutiv keqpërdori dhe po keqpërdor subvencione në bujqësi këtë po ua dëshmojmë me fakte siç ishte rasti te dëmet e fermerëve ku tentoj t’i fusë në atë listë miqtë, familjarët dhe shokët e tij ku si pasojë pësuan ata fermer të vërtetë

në atë listë të cilën e anuloi Ministria, dhe kjo nuk u ndal me kaq kur tentoj prapë përmes Kuvendit t'i bartë përgjegjësitë e tij e t'i shpërblej jaranat e tij.

Tash kthehemi te tema kryesore te subvencionet e mëshqerrave ku nuk përfillen rregullat e përcaktuara me rregulloren për ndarje të subvencioneve madje ky kryetar ndërhyr direkt në punët e Drejtorisë dhe komisionit vlerësues, lidhë kontratë përmes procedurave të prokurimit për 154 fermer përfitues, listën preliminare nuk e publikojnë sipas afateve ligjore sepse atë listë e ndryshon dhe i fut njerëzit që si plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas Rregullores. Keqpërdorimet vazhdojnë kur ajo listë preliminare ndryshon, nuk shpallen përfituesit e asaj liste, shpallet lista me 150 fermerë përfitues dhe kjo ka një shpjegim sepse ka ndërhyrje në punët e komisionit vlerësues dhe çudia më e madhe është qysh heshtë Drejtoresha e DPKGJ kur vjen nga fusha e drejtësisë, ku me mos veprimin e saj së bashku me shefin e saj kryejnë vepër penale sepse detyrojnë komisionin ta ndryshojnë procesverbalin dhe dokumentacionin e fermerëve përfitues. Se këtu ka skandale e keqpërdorime nuk diskutohet sepse pa u shpallë lista përfundimtare nga ana e DPKGJ ftohen fermerët të bëjnë pagesën prej 30% për një mëshqerrë. Ishte seanca e kaluar kur Kryetari më ka kërkuar ta njoftoj nëse ka keqpërdorime e unë sot nga kjo foltore them se Kryetari është keqpërdoruesi i buxhetit sepse së bashku me shoferët e tij dhe disa asamblastë, nëse jeni transparent na i sillni procesverbalet e komisionit vlerësues me numra të protokollit si dhe vendimet e komisionit vlerësues për secilin fermer që iu ka refuzuar kërkesa për subvencionim me mëshqerra, gjithashtu na i sillni edhe faturat e pagesave që janë bërë pa u shpallë listat e përfituesve. Nga kjo foltore ftoj prokurorinë ta hetojë rastin në fjalë sepse adresa ka emër, ai është Shpejtim Bulliqi,

Sa i përket pikave 2, 3 dhe 4 për shtim të kodeve të reja, qëndrimi i Grupit të LDK-së është se nuk marrim pjesë në votim ngase disa herë kemi kërkuar që participimi i fermerëve të hiqet krejt, e mos të jetë 30%.

z.Bashkim Sylja, theksoi, për shkak të vërejtjeve dhe shqetësimeve që i kam ngritë edhe në mbledhjen e KPF-së, ne si Grup i PDK-së sa i përket 3 pikave për shtim të buxhetit për mekanizëm bujqësor, mëshqerra dhe sera, do të abstenojmë për shkak të shqetësimit që kemi ngritë dhe s'kemi marrë përgjigje për asnjërën prej tyre, e vetmja arsye që abstenojmë është që mos t'i dëmtojmë disa bujq që janë vërtetë meritator, kurse për pjesën tjetër ne shpresojmë që në të ardhmen të ndryshohet Rregullorja edhe pse është bërë mënyra e vlerësimit me pikë mirëpo i njëjti avaz është duke shkuar sikurse edhe viteve të kaluara, kështu që ne si Grup i PDK-së për pikat 2, 3 dhe 4 do të abstenojmë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron të marrë fjalën, nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin "Furnizim me mekanizëm bujqësor", sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 15 vota Për, asnjë votë Kundër, 3 vota të Përmbytura (të tjerët nuk votuan), miratohet propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti "Furnizim me mekanizëm bujqësor", sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me mëshqerra”

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, është e njëjta arsye, është participimi i fermerëve në projektin furnizim mëshqerra që është 30% i mjeteve të fermerëve përfitues.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me mëshqerra”.

z.Naim Çunaku, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së siç e potencoi edhe shefi i Grupit në fillim, ne nuk marrim pjesë në votim për 3 pikat e lartcekura.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron të marrë fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin “Furnizim me mëshqerra”.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 15 vota Për, asnjë votë Kundër, 3 vota të Përmbytura (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me mëshqerra”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me sera”

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, prapë e ceku se është e njëjta arsye, do të thotë qytetarët që aplikojnë për sera në vlerë 30% duhet të kaloj përmes Kuvendit të Komunës në mënyrë që të realizohet ky projekt.

z.Bahri Blakçori, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së, e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me sera”.

z.Burim Hasani, theksoi, sa i përket propozim vendimiit për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me sera”, nga subjekti AAK e përkrahim sepse është një projekt i mirë dhe kemi të bëjmë me fermer serioz ku në këtë situatë kemi të bëjmë me sera 50 m² deri në 500 m², prandaj ne e përkrahim këtë propozim.

z.Naim Çunaku, theksoi, duhet të jemi transparent para qytetarëve, ne edhe në diskutimin e shefit të Grupit të LDK-së deklaruar se jemi ata që mbështesim çdo lehtësim të veprimtarive bujqësore gjegjësisht çdo subvencionim që i bëhet bujqve e ka mbështetjen tonë, mirëpo forma qysh po mbështeten dhe si po futet participimi në shumë kaq të madhe nuk konsiderojmë se është lehtësim dhe e konsiderojmë se ata nuk duhet të paguajnë participimin, qoftë nevoja të zvogëlohet edhe fondi i atyre që marrin subvencione, të paktën le të marrin subvencione ata që janë meritator.

Pra ky ishte qëndrimi ynë dhe nuk do të doja të kemi keqkuptime, ne përkrahim çdo subvencionim për bujqit por nuk përkrahim atë formë që t’ju shesim bujqve apo t’i detyrojmë të paguajnë pjesën e subvencioneve që marrin.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e vë në votim këtë propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin “Furnizim me sera”.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 17 vota Për, asnjë votë Kundër, 3 vota të Përmbytura (të tjerët nuk votuan), miratohet Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “Furnizim me sera”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

5. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme shoqërore - “Mekanizmi” nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë: Njësitë kadastrale 00244-2 dhe 00244-3 në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit “Ndërtimi i objektit për Banim të Përballueshëm”.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, me qëllim të realizimit të projektit për banim të përballueshëm i cili do të bëhet në pjesën ku është Tregu i qytetit dihet që Kuvendi Komunal e ka marrë një vendim që të realizohet ky projekt mirëpo në hapësirën përkatëse që është afër 60 ari, figurojnë dhe janë dy prona të cilat në zyrat e kadastrit figurojnë si prona të Agjencionit Kosovar të privatizimit përkatësisht të ish Ndërmarrjes Mekanizmi, andaj me qëllim të realizimit të këtij projekti duhet të shpallet në interes të përgjithshëm publik për të hapur rrugë për shpronësim të këtyre pronave nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe të realizohet ky projekt që është shumë i rëndësishëm për qytetarët e Komunës së Podujevës, kështu që nga ana e juaj kërkoj mbështetja e këtij projekti.

z.Ragip Fetahu, theksoi, projekti për ndërtimin e objektit për banim të përballueshëm është një prej projekteve më të rëndësishme dhe më strategjike të qeverisjes lokale e cila është në koordinim me nivelin qendror dhe korrespondon me politikën e përgjithshme të ndjekura për familjen dhe zhvillimin e saj. Projekti në fjalë do të jetë te Tregu aktual dhe është një projekt shumë i rëndësishëm sepse në njërin anë ndihmon qytetarët ose çiftet e reja të cilat kanë nevojë për banim të përballueshëm dhe në anën tjetër shfrytëzon hapësirën e cila është aty në mënyrë racionale duke u mundësuar tregtarëve aktual të cilët funksionojnë në tenda të kenë mundësi që punën e tyre ta vazhdojnë në lokale të cilat do të jenë të dinjitetshme ku do kenë mundësi ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre pa ndryshuar vendin. Prandaj në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë iniciativë dhe sugjeroj që edhe ju të tjerët si anëtar të Kuvendit ta përkrahni këtë propozim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe ne Grup i LVV-së e përkrahim këtë propozim por kam një pyetje, për këtë vend këtu ne kemi bërë një komision nga Kuvendi nga të gjitha subjektet politike për t'i dhënë në shfrytëzim ato lokale, njëherë është publikuar në faqe të Komunës njoftimi i cili ka mbet ashtu dhe pastaj është tërheq, prandaj këtu a nuk ka koordinim apo çka, përse bëhet njëherë komisioni për me i dhënë ato lokale në shfrytëzim, kush e shkarkoi atë komision nëse ne e kemi votuar këtu si Kuvend, a është dashtë me ardh këtu e me thënë se e kemi bërë gabim këtë punë, e jo njëherë komisioni me i dhënë lokalet në shfrytëzim e pastaj të sjellët vendim mbi vendim, unë këto nuk po i kuptoj. Është dashtë me ardh ata me dhënë një sqarim sepse ne i kemi votuar dhe i'u kemi dhënë njëfarë besimi e jo këta të mbajnë mbledhje dhe mos të na japin arsye neve që i kemi votuar për ta anuluar atë sepse kanë do të bëjnë një punë tjetër ose ndonjë arsye tjetër, prandaj nuk e di përse nuk po shkojnë sipas rregullave me këtë punë.

z.Naim Çunaku, theksoi, që e bukur ajo ta dëgjosh kolegun z.Ragip Fetahu se si përkujdesemi për kategoritë në nevojë por nuk e di a bëjnë zgjidhje apo vetëm fjalë, tani e di që sigurisht do të thotë po, ne po provojmë një projekt dhe për atë po ndajmë lokacione, por paraprakisht lind pyetja, në projektbuxhetin e Komunës tonë a figuron një kod për këtë, jo, në projekt buxhetin ose listën e buxhetit të Kosovës a kemi kod të paraparë për këtë, jo, atëherë a do të thotë që po mbesin vetëm fjalë të bukura në letër dhe të paktën le të shohin një ëndërr të mirë ata që kanë nevojë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, veç deshta t'ia jap një informacion kolegut tim parafolës se lidhur me këtë çështje është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi mes Ministrisë përkatëse dhe Komunës së Podujevës që ky projekt të zhvillohet posa të kryhen procedurat për shpronësimin e tokës.

z.Naim Çunaku, theksoi, më duket se unë isha shumë i kuartë, thash në buxhetin tonë komunal a ka mjete të parapara, jo, dhe në buxhetin e Kosovës a ka mjete të parapara, jo, kaq.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, ky është një projekt që realizohet nga ana e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe për këtë së fundi tash është miratuar Ligji për banim të përballeshëm dhe njëkohësisht është nënshkruar një Marrëveshje për kredi ndërkombëtare nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nëse nuk gaboj nuk vlen vetëm për Komunën e Podujevës por është afër 60,000,000.00€ kjo kredi me të cilën do të realizohet projekti për banim me kosto të përballeshme.

Në buxhetin e Komunës së Podujevës është e vërtetë se nuk figuron, për arsye se do të jetë financim i Qeverisë, jo vetëm për Komunën e Podujevës por në të gjitha komunat tjera të cilat e kanë detyrim që ta ofrojnë parcelën dhe çështjet tjera deri tek leja e ndërtimit në bazë të Hartës Zonale dhe dokumenteve tjera.

z.Naim Çunaku, theksoi, drejtori parafolës më bërë që sërish të marrë fjalën ngase sikur nuk po kuptohemi, unë projeksionet dhe kush çka ka brenda në mendje si dhe Memorandumet e Mirëkuptimit gjitha i kuptoj, por për realizimin e një projekti duhet të kesh kod buxhetor me çka duhet të realizohet sepse çdo projekt ka kosto buxhetore dhe unë e shfaq atë që nuk e kemi në kodin tonë buxhetor asnjë cent të paraparë për këtë dhe as në ligjin për buxhet, ndërsa çfarë bëhet pastaj ndërkohë dhe kush çka ka në mendje, çfarë idesh ka, ato derisa kalojnë në projekt buxhet mbeten vetëm ide.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e vë në votim propozim vendimin për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme shoqërore “Mekanizmi” nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë: Njësitë kadastrale 00244-2 dhe 00244-3 në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit “Ndërtimi i objektit për Banim të Përballeshëm”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 25 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbytur, (2 anëtarë të Kuvendit nuk votuan) , miratohet propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik pronat e paluajtshme shoqërore - “Mekanizmi” nën menaxhimin e AKP-së, dhe atë: Njësitë kadastrale 00244-2 dhe 00244-3 në Zonën Kadastrale Podujevë, për realizimin e projektit “Ndërtimi i objektit për Banim të Përballeshëm”, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

6. Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Llapi” është një Ndërmarrje e re Shoqëri Aksionare me kapital aksionar lokal e themeluar nga Komuna e Podujevës me vendim të Kuvendit të Komunës dhe për realizimin e veprimtarisë së saj nevojitet një pronë për vendosjen e makinerive dhe pajisjeve të cilat i ka për kryerjen e shërbimeve në mirëmbajtjen e qytetit, prandaj ju e posedoni propozim vendimin përkatës që ju është dërguar për këtë çështje, por vetëm më lejoni të paraqes një përmirësim të njësitë kadastrale do të thotë ngastra P-71712062-05143-2, kjo parcelë tërhiqet nga propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim për arsye se është pronë publike mirëpo aty është e ndërtuar një rrugë dhe kjo pjesë nuk jepet në shfrytëzim, ndërsa dy ngastrat tjera

kadastrale do të thotë faktikisht 3 të tjerat vlejné në këtë propozim vendim në mënyrë që të jepen në shfrytëzim për NPL “Eko-Llapi” në funksion të krijimit të kushteve për realizimin e veprimtarisë së saj.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, e mbështesim propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim të pjesës kadastrale të kërkuar nga NPL “Eko-Llapi në Podujevë, e cila do të jepet për një periudhë kohore 10 vjeçare e që parashihet të jepet në shfrytëzim pa kompensim duke i përcaktuar me kontratë kushtet e shfrytëzimit të kësaj prone.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, është mirë që ky propozim ka ardh këtu, unë para dy seancave në emër të LDK-së kur është bërë propozimi për me i nda 30,000.00€ kësaj Ndërmarrje e kam potencuar se kësaj ndërmarrje i duhet një vend. Unë sot e vizitova vendin që është propozuar për këtë ndërmarrje por nuk e kam ditë se në qytetin e Podujevës ka aso gërmadhash e që asnjëherë nuk e kisha besuar dhe i bëra disa foto dhe më së shumti më bërën përshtypje tabelat e rrugëve të dy njerëzve shumë të rëndësishëm të Llapit dhe ato tabela të emërtimeve të rrugëve i fotografova, këtu në gërmadha shkruan rruga e Heroit rr.”Zahir Pajaziti” e që gjendet në bërlllog, dhe tabela me emrin e tjetrit Hero rr.”Xhemajl Mustafa” (*paraqet fotot*), shikojeni bërlllokun, kam bërë shumë fotografi dhe të gjitha nuk po ua tregoj, mirëpo por nuk e di këtu një muaj punë duhet për ta pastruar atë vend sepse aty kish gjithçka, madje edhe gypa të ndryshëm, por të shkosh dhe t’i shohësh emrat e Dëshmorëve në bërlllok kjo është tmerr për neve si qytet, tmerr është. Dy prej njerëzve më të mëdhenj që i ka pas Llapi t’jua gjesh emrat në tokë nuk e di kush ka qenë ai zyrtar që i ka hedh aty apo ajo firmë që kur kanë kryer punë aty i ka hedh në tokë ato tabela me emrat e tyre, ose ai menaxher kush ka qenë, të paktën vet ai kur ka punuar aty është dashtë t’i rregulloj sepse vetëm një bulon është dashtë ta zhdredh, bile gypin/shtyllën le ta hedh por tabelën me emra të Dëshmorëve të cekur ta merrte dhe ta sillte në Komunë, por jo ta hedh në tokë ashtu.

Unë isha duke ardh në seancë dhe nuk kisha kohë, përndryshe shkoj i heq vet ato sepse është turp t’i shoh ndokush ato tabela në atë gjendje.

z.Bashkim Syla, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e mbështesim propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse dëshiron fjalën ndokush për këtë pikë të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e vë në votim.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 30 vota Për, (nga anëtarët e Kuvendit sa ishin prezent), miratohet propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje dhe plotësim ndryshimin e propozuar që në propozim vendim të fshihet parcela kadastrale P-71712062-01543-2 me sipërfaqe 1279 m².

7. Raporti Financiar për periudhën janar - qershor 2024

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, e paraqiti raportin në fjalë, theksoi, Komuna e Podujevës për vitin 2024 e ka një buxhet prej 31,043,019.00€, nga këto ka një strukturë të shpenzimeve 16,518,288.00€ për paga dhe mëditje, 3,585,000.00€ për mallra dhe shërbime, 513,000.00€ për shpenzime kapitale, 1,670,000.00€ për subvencione si dhe për shpenzime kapitale 8,756,000.00€.

Nga kjo strukturë e cila ka qenë e planifikuar në buxhetin e vitit 2024, në periudhën janar-qershor, janë realizuar këto shpenzime, në kategorinë paga dhe mëditje janë shpenzuar 10,051,682.00€, për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 1,101,000.00€, për shpenzime komunale 236,865.00€, për subvencione dhe transfere 560,267.00€, si dhe për investime kapitale 2,568,556.00€, në total shpenzimet kanë arrite 14,519,039.00€. Në tabelat të cilat i keni në raportin financiar janë të paraqitura të gjitha shpenzimet në bazë të kodeve ekonomike dhe në bazë të projekteve të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe, gjithashtu është paraqitur edhe inkasimi i të hyrave vetanake ku gjatë kësaj periudhe janë realizuar të hyra në vlerë 924,330.00€.

Ky është raporti për periudhën janar-qershor, dhe unë e paraqita në pika të shkurtra në mënyrë që mos t'ju marrë kohë më shumë, mirëpo për çështjet të cilat ju interesojnë jemi në gatishmëri që t'i sqarojmë për shpenzimet për këtë periudhë kohore.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e vlerësojmë përgjithësisht mirë këtë raport duke parë investime të ndryshme në arsim, shëndetësi, në fushat sportive, rrugë lokale, shtretër të lumenjve e kështu me radhë, megjithatë unë kam një pyetje sepse e kam të paqartë te kodi 13950 dhe 13951, si është e mundur regjistrimi i automjeteve nga vitit i kaluar 3,371.20 €, në 30 €, dhe e kundërta te sigurimi i automjeteve vitin e kaluar vetëm 500 € kurse në këtë vit shumë më shumë. Po ashtu te ujësjellësi a bëhet fjalë për mirëmbajtjen apo rregullimin e rrjetit të ujësjellësit apo çfarë është konkretisht.

Gjithashtu dua sqarime edhe për kujdestarinë në punë gjatë natës përse gjithë kjo shumë në këtë vit e jo në vitin e kaluar as një shumë për këtë kod, këtë pyetje e kam bërë edhe në seancat e kaluara dhe nuk kam marrë përgjigje, kështu që këtë pyetje nuk po e bëjë sërish sepse s'marr përgjigje hiç.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me pikën e rendit të ditës raporti financiar janar-qershor 2024, vërtetë ne si Kuvend dhe monitorues të shpenzimit të buxhetit, gjegjësisht të arriturat në investimet kapitale dhe shpenzimet tjera buxhetore i shohim përmes raporteve periodike financiare si obligim ligjor që e ka Ekzekutivi në këtë rast për paraqitjen e raporteve para Kuvendit.

Me këtë raport duke pas parasysh që në këtë Kuvend nuk kemi pas një plan pune apo një program pune të Ekzekutivit, nuk kemi pas një plan pune të zyrës së prokurimit publik për dinamikën dhe rrjedhën e investimeve, neve na mbetet vetëm ky raport me të cilin e monitorojmë punën e Ekzekutivit si obligim ligjor, si një prej tri shtyllave që e monitoron shpenzimin e buxhetit e ato tri shtylla janë Kuvendi, Auditori i Brendshëm, Auditori i Jashtëm. Me i përmend auditorët nuk po na del mirë as puna e auditorëve sepse nuk e kemi mirë, ndërsa e dëgjova me kujdes parafolësin kolegun z.Xhevdet Maloku që në fjalitë e para e përgëzoi për këtë raport, e që unë mund ta përgëzoi Ekzekutivin vetëm për një përmbushje ligjore, për të mos thënë sa për sy e faqe, dhe duke u munduar që këtyre të votuarve të qytetarëve tu hedhim hi syve rreth asaj çka kemi.

Nuk është në natyrën time fort të jap kualifikime të rënda por vërtetë ky raport me fjalën me të butë me thënë është i mangët, është i pa vërtetë, nëse e them se është i mangët dhe i pa vërtetë sigurisht dikush do të më thotë po ku po e sheh ashtu jepna një shembull që është i pa vërtetë, unë po mundohem të jem i shkurt dhe po i potencoj vetëm dy kode, mirëpo nëse dëshironi të gjitha

kodet mund t'i diskutojmë, por për të mos marrë kohë shumë po i referohem këtij raportit që e kemi përpara, jo diçka tjetër.

Te kodi shpenzime të varrimit e kemi parë të gjithë që në raport kemi zero euro shpenzime, a do të thotë kjo që në Komunën tonë nuk kemi pas shpenzime të varrimit për një gjashtë mujor, sigurisht që jo sepse të gjithë jemi dëshmitar që kemi pas, a do të thotë edhe pse kemi pas, Komuna nuk i ka kryer pagesat, edhe këtë po e them në bazë të fletëpagesave të cilat kanë dalë nga Ekzekutivi dhe dihet ku kanë shkuar, në xhirollogarinë e Këshillit të Bashkësisë Islame. Kodi 1340 emërtimi i shërbimeve të varrimit në raport paraqitet zero euro, ndërsa këtu është poenta, lus drejtorët përkatës nëse ka mundësi të ndalni llafet sepse për juve është ka bëhet fjalë, derisa ta përfundoj diskutimin, përndryshe mund të praktikoni sikurse dje në mbledhjen e KPF-së që ta nënçmoni skajshmërisht Kuvendin edhe pse ligjërisht para Kuvendit jeni llogaridhënës, ju e kemi fuqinë elektorale dhe jeni duke manipuluar në një formë dhe e kemi shndërruar Kuvendin në diçka që duhet të votohen pa e pasur kokën, ngase juve ju duhet vetëm dora e jo kryet, kështu që ju kisha lutur, përndryshe nëse s'kemi durim të dëgjoni unë e ndërpres diskutimin dhe pres.

Isha duke i përmendur pagesat që i janë bërë Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë, e ceka se për mua është raport i rrejshëm edhe pse nuk është në natyrën time të them kështu, më datë 07.05.2024 pagesë 10,800.00€, më datë 20.06.2024 pagesë 10,200.00€, më datë 12.02.2024 pagesë 14,400.00€, më 12.02.2024 pagesë 10,800.00€, më datë 06.03.2024 pagesë 10,800.00€, dhe më datë 04.04.2024 pagesë 9,800.00€, do të thotë Komuna ka bërë pagesa 66,800.00€, ndërsa në raportin tonë figuron zero euro pagesa, çka t'i themi kësaj, si ta quajmë ndryshe kur neve na paraqitet zero pagesa e në realitet ka dalje 68,000.00€, a neglizhencë, a papërgjegjësi apo hedhje e hirit syve sa për ta përmbush një obligim ligjor se e kemi përgatit një raport, madje vitin e kaluar s'janë lodh as atë obligimin 9 mujor me përmbush.

E përmenda rastin tjetër që s'desha t'ju lodhi më shumë por po i them vetëm gjërat më elementare për të mos ju marr kohë më shumë, në raportin 6 mujor shpenzime për petty cash apo para të imëta, në raportin që neve na është dërguar të cilin të gjithë e kemi paravetës, në kodin buxhetor janë paraqitur 500.00€ që janë shpenzuar, ndërsa po të hysh në pagesa që Komuna ka lëshuar për petty cash janë këto, më datë 27.03.2024 avanc për para të imëta shuma 500.00€, kjo e mbulon atë që na është prezantuar, ndërsa këto që po i lexoj të tjerat janë të pa prezantuara dhe përse ka ndodh kjo këtë duhet ta dijë ai që e ka bërë kështu, më datë 14.06.2024 shuma 500.00€, më datë 11.03.2024 avanc për furnizim në zyrë 288.00€, më datë 11.03.2024 ushqim (pa pije) 211.00€ sepse me pije ndoshta ish dalë më shtrenjtë, pastaj mirëmbajtja 164.00€, më datë 11.06.2024 ushqim me pije shuma 131.00€, më datë 11.06.2024 furnizim shuma 204.00€, gjithsej na dalin mbi 2,000.00€ shpenzime, ndërsa në raport i kemi vetëm 500.00€, andaj a mund ta quajmë këtë raport të saktë dhe të vërtetë, jo.

Për ta parë diskrepancën gjegjësisht atë se si ka rrjedhë shpenzimi i buxhetit dhe i taksës së qytetarëve krejt, e potencova se deri sa nuk kemi plan dhe program të punës ne të vetmin mjet e kemi krahasimin me vitet paraprake, po e përmendi sërish një krahasim duke u thirrur në dokumentin zyrtar që kam paravetës, vërtetë ose i bie që s'po di të lexoj ose më e vogla ai që e ka shkruar nuk e din çfarë ka bërë. Regjistrimi i automjeteve, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve në këtë periudhë kohore në vitin e kaluar kemi pas 5,600.00€, tani kemi 17,000.00€, është e kuptueshme se veturat vijnë duke u vjetruar por ndoshta kjo shumë nuk është ajo e duhura sa që e përcjell amortizimin, mirëpo kemi këtë rritje, pastaj te mirëmbajtja e ndërtesave arsimore në vitin e kaluar po në këtë periudhë i kemi pas 29,000.00€ shpenzime ndërsa tani kemi mbi 100,000.00€ të shpenzuara, te mirëmbajtja e mobile që unë kisha dashur sqarim çka kuptojmë me mirëmbajtje të mobileve, në vitin e kaluar në këtë periudhë kohore kemi pas 7,000.00€ të shpenzuara ndërsa tani

kemi 33,000.00€ të shpenzuara. Shpenzimet gjyqësore e di arsye që është kontrata kolektive, mandej një element tjetër janë fushat sportive që në vitin e kaluar në këtë periudhë kohore i kemi pas të shpenzuara 4,900.00€ kurse tani kemi 14,000.00€ të shpenzuara, unë nga ajo që frekuentoj qytetin aty kemi një fushë sportive në gjendje të mjerueshme nëse e sheh dikush në trekëndëshin Llugë-Sibofc-Kaçybeg, unë nuk jam shumë i shkathët dhe nuk kam bërë fotografi sikurse kolegu z.Ekrem Rrahmani, por vërtetë është tmerr të shohësh atë gjendje e që sigurisht disa prej nesh këtë e dinë sepse ka ca muaj që është ajo gjendje aty.

Te shpenzimet e ujësjellësit është një problematikë që Podujevën e rëndon me vite të tëra, furnizimi me ujë të pijes e në veçanti gjatë stinës së verës dhe nga kolegët e nderuar këtu kemi pas edhe pikë të propozuar që Kuvendi i Komunës të merret me këtë shqetësim të qytetarëve e në veçanti kur mërgimtarët e frekuentojnë Komunën e Podujevës, këtu te ne në raport nuk figuron vitin e kaluar asnjë shpenzim, në këtë vit janë 60,000.00€, ndërsa në të njëjtën kohë Ekzekutivi i Komunës sa herë që është biseduar për ujin ka thënë nuk është kompetencë e jona kjo dhe nuk e kemi të drejtën të bëjmë investime ne aty, e që edhe pse mund ta thonë, e thonë sa për t'i ikur obligimit ligjor sepse në bazë të Ligjit për vetëqeverisjen lokale Komuna është kompetente për furnizimin e qytetarëve të vet me ujë, unë e di që s'mund të ndërtojmë kapacitetet për të prodhuar ujë të pijshëm por një përkushtim sado të vogël ashtu siç i kam dëgjuar duke i përmend pusët e Peranit, pusët te Blakçorët e kështu me radhë, me dy ose tri shpime të puseve të paktën do të kishim ujë të mjaftueshëm për këta muaj.

Sa i përket regjistrimit të automjeteve është goxha qesharake kodi buxhetor 13950, vitin e kaluar Komuna jonë për shpenzime të regjistrimeve të automjeteve i ka harxhuar 3,371.20€, a e dini sa janë shpenzimet tani, vetëm 30€, çka ka ndodhë qysh janë regjistruar nuk e di por është vërtetë shqetësuese. Për të mos e zgjatë më tepër dhe t'ju jepet mundësia edhe kolegëve për t'i ngritë shqetësimet e tyre po mundohem të jem edhe më i shkurtër.

Fola për shpenzimet por nuk fola për planifikimet për të hyrat vetanake në Komunën tonë, vërtetë planifikime jo të qëlluara as për së afërmi, mund të dështosh në planifikim 30% - 40%, por t'ia huçësh 100%, po mos të hyj në detaje e t'i lexoj rend ku janë ato huçje dhe t'ua argumentoj, vërtetë kisha dashur që Komuna ime ku pavarësisht grupimeve dhe qëndrimeve politike unë jam banor i Komunës së Podujevës dhe do të doja që Komuna e Podujevës ta ketë një buxhet të shpenzuar ashtu të bazuar në rregullativën ligjore dhe mos të kemi defekte të tilla.

Për ta përmbyll diskutimin, rëndë po më vie ta them për raportin e para dy viteve të auditorit të jashtëm ku ka thënë se ka raportime të rrejshme, më ka ardhë rëndë ta potencoj, por po e them nga këto të gjetura dhe nga këto letra që i kam unë, s'mund ta quaj tjetër vetëm raportim jo të drejtë.

z.Bashkim Sylaj, theksoi, në bazë të dhënave që na janë sjellë nga DBF, në raportin financiar gjashtëmuor e parë të vitit 2024, për mallra dhe shërbime nga 3,585,000.00€ janë shpenzuar 1,101,000.00€ ose në përqindje i bie 27%, te kategoria subvencione dhe transfere nga 1,670,000.00€ janë shpenzuar 560,000.00€ ose 29%, te investimet kapitale nga 8,756,000.00€ sa janë planifikuar janë investuar 2,568,000.00€ ose 34% e që është një përqindje shumë e ulët dhe zakonisht kur nuk realizohen të hyrat në investime kapitale gjithmonë në fund po ankohemi se po kemi suficit pastaj.

Sa i përket shpenzimeve me kode buxhetore u tha shumë këtu dhe s'po dua t'i përsërisë, mirëpo një vërejtje te të hyrat vetanake, inkasimi i të hyrave vetanake për periudhën janar-qershor janë inkasuar 924,329.00€, por është shkruar që shumica e të hyrave janë nga tatimi në pronë gjë që në bazë të tabelës nuk është e vërtetë ose është bërë ndonjë gabim teknik ose nuk është shikuar mirë sepse te shfrytëzimi i tokës dhe lejet e ndërtimit i kemi 227,000.00€ të inkasuara.

Po ashtu te pagesa lidhur me automjetet i kemi 185,000.00€. Pastaj ashtu siç e potencoj edhe kolegu z.Naim Çunaku në raport të auditorit është cek që raportet financiare të vitit të kaluar nuk kanë qenë të detajuara dhe të pasqyruara në mënyrë të drejtë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, sa i përket raportit financiar për periudhën janar-qershor 2024, unë i kam dy raportet, edhe raportin financiar që na është dërguar nga Kryesuesi i Kuvendit edhe raportin financiar të nxjerrë nga Free Balance, por ka shumë pak gjëra që përputhen këtu.

Po filloj prej luksit dhe të gjitha po i përmendi, shembull dreka dhe darka zyrtare, këtu në raport janë paraqitur 3,217.80€ kurse realisht të harxhuara janë 21,000.00€ për dreka dhe darka zyrtare, i kam të shkruara të gjitha faturat e restoranteve ku janë bërë këto pagesa.

Shërbime këshillëdhënëse 14,329.00€, me “ble mend” kaq shtrenjtë për çdo 6 muaj gjithë kjo shifër nuk e di pse kështu, tani s’kam çare pa e përmend, shembull kjo “Dejona Çitaku” jo, por Edona Çitaku kush është kjo me marrë gjithë këtë avanc, për udhëtim zyrtar 1,000.00€, akomodim 610€, ushqim 170€, avanc për udhëtim zyrtar prapë 2,500.00€, në total 4,280.00€, më duket ua kanë sjellë edhe juve Dejona Mihailin këtu veç pak emrin ia kanë ndërruar me disa shkronja.

Pastaj ishte një pikë te raporti në fjalë, akomodim brenda vendit i vërejta dy fatura e ndoshta nuk është mirë që po i përmendi emrat por te këto dy restorante unë shkoj më së shpeshti, shembull “Te kafja e Sabitit” akomodim, unë i kam parë disa drejtorë duke ec “dredhtë” por që kanë flejtë në karrige kurrë se kam ditë, pastaj tjetra ishte në “Kafe të Ramishit” akomodim, shkova këqyra a ka dhomë dhe aty s’ka, (unë shpesh rri deri vonë në qytet dhe shpesh gruaja ime po ma merr veturën dhe po mbes në qytet e thash të shkoj për me fjetë aty por aty më than se për me fjet mundesh ose në bodrum ose në karrige), kjo është shumë interesant.

Shërbime kontraktuese tjera 162,170.00€, kurrë nuk na treguat çfarë janë këto shërbime tjera, a veç i merr dikush këto shërbime, a veç janë të tjera. Pastaj një kod e keni shkruar akomodim për udhëtim zyrtar brenda vendit 12,161.00€, akomodim udhëtime zyrtare jashtë vendit 4,876.00€, kurrë nuk e kam ditë që më lirë është shëtitje në Evropë sesa në Kosovë, askund s’përputhen këto.

Drejtori z.Bahri Selimi s’qenka këtu se edhe atij deshta t’ia numëroj udhëtimet zyrtare dhe shpenzimet për mëditje, aq shumë po e don ajo “Merkelka” që veç në “bisht të aeroplanit” po rrinë ky, avanc për udhëtim zyrtar 2,000.00€, mëditje 680.00€, shpenzime tjera 40.00€, avanc për udhëtim zyrtar 2,000.00€, që i bjen 4,720.00€. Kryesuesi i Kuvendit neve na dërgoi atje (në Gjermani) dhe as drek e as pije nuk ka dhënë/paguar, madje në disa raste ka paguar kolegu z.Ragip Fetahu dhe në disa raste kemi paguar vetë ne.

Mandej mobile 81,752.00€, shumë mirë do ishte të na tregonit se ku po shkojnë këto mobile sepse përditë po ndërrohen, hiç mobile të reja vendos mobile të reja, po ashtu mirëmbajtja e mobileve 33,357.00€, nuk e di qysh mirëmbahen mobilet, ato ose duhet të ndërrohen ose të mirëmbahen, kurrë këto mobile nuk janë as të lyera.

Gjithashtu më bënë përshtypje dy pagesa në rr.“Xhemajl Mustafa”, nuk e di përse bëhet pagesa kur operatori nuk e ka kryer punën, kur e ka tejkaluar edhe afatin kohor, e që në kushte normale për 10 muaj është dashur të realizohet kurse ajo kontratë ka më shumë se 12 apo 13 muaj që është nënshkruar, fillimisht nisën punët e hoqën një pjesë të asfaltit, pastaj herë e qitshin e herë e heqshin asfaltin, tash i kanë rënë në fije në mes të asfaltit te vija e bardhë po e heqin asfaltin edhe po e lëshojnë një gyp dhe menjëherë po e shtrojnë asfaltin dhe paratë po i marrin, prandaj nuk e di pse bëhet pagesa kur është procedura pasi të përfundojnë punimet del projekt menaxheri dhe komisioni e pranon punën dhe është një afat prej 30 ditëve pasi të bëhet pranimi teknik i punës të lëshohen parat, e jo ai duke punuar ju ia leshoni faturat.

znj.Arjeta Salihu, theksoi, edhe unë i kam disa pyetje për drejtorin e DBF-së, te raporti financiar është një kod ku shkruan shtesa e veçantë për zgjedhurit, a ka mundësi t'ju shpjegoni qytetarëve dhe neve se për cilët të zgjedhur është fjala. Mandej tjetra është shtesa për punë pa orar të paracaktuar dhe puna jashtë orarit të punës, ne mendojmë që janë njësoj, andaj përse janë dy kode këtu, prandaj edhe këtë do të doja të na sqarosh neve dhe qytetarëve, ose ku është dallimi.

Te shërbimet kontraktuese kemi një shumë 160,000.00€, a mundesh i nderuar drejtor më detajisht të na tregosh për çfarë shërbimesh është fjala edhe te ky kod.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, u than shumë nga kolegët parafolës, mirëpo te investimet kapitale brenda 6 muajve janë rreth 2,500,000.00€ të shpenzuara kurse sipas kodeve mirëmbajtja e autorrugëve është 11,000.00€, mirëmbajtja e auto rrugëve lokale 27,000.00€, mirëmbajtja rutinore 9,000.00€, rrugët lokale rreth 750,000.00€, trotualet 126,000.00€, nga të hyrat vetanake sërish është kodi rrugët lokale rreth 80,000.00€, dhe nëse i mbledhim gjitha këto del që rreth 40% ose 1,000,000.00€ janë investuar vetëm në rrugë dhe asfalt, kjo tregon që jeni pa ide, kur e sheh gjithë këtë investim që është bërë vetëm në rrugë e asfalt dhe jemi në vitin 2024 kurse investimet po bëhen sikurse në vitin 2004, e gjithë kjo po ndodh sepse e dimë që asfalti është i shtrenjtë dhe në mënyrë të sinkronizuar shkon edhe keqpërdorimi në këto projekte, këtë e ka vërtetuar tash e dy vite edhe raporti i auditorit.

Te udhëtimet jashtë vendit dhe udhëtimet brenda vendit, vetëm në raport sa na janë paraqitur janë rreth 30,000.00€, por sipas raportit të Free Balance shuma del më shumë, që është një shumë mjaftë e lartë e shpenzuar për lluks nga gardianët e parasë publike.

z.Haki Rudari, theksoi, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i pushtetit lokal i cili është i autorizuar ligjërisht për ta monitoruar dhe shikoj buxhetin në tërësi por në të njëjtën kohë edhe raportimet financiare, prandaj raportimi financiar është një mekanizëm kryesor përmes së cilave këshilltarët në radhë të parë por edhe qytetarët njoftohen lidhur me grumbullimin e mjeteve sipas burimeve dhe në të njëjtën kohë lidhur me rrjedhjen apo shpenzimet nëpër kode të ndryshme ekonomike, prandaj këto janë dy elemente të cilat ne i gjejmë te raporti financiar, grumbullimin e mjeteve apo burimet nga të cilat kanë ardh dhe natyrisht shpenzimet e ndryshme.

Dikush nga parafolësit pyeti qysh e vlerëson raportin, ky si është, unë s'kam mundësi as ta bëjë më të mirë e as më të keq, dhe unë po ndalem kështu si na ka ardh neve, e tha realisht edhe një koleg edhe unë e kam pritë që investime kapitale të ketë paksa më shumë, do isha më i lumtur po të kishte investime kapitale më shumë e jo të ndalemi në shumën 2,568,556.00€, megjithatë ato mund të jenë çështje të prokurimit si dhe çështjet ligjore të Ekzekutivit që i nuk i di të gjitha në tërësi.

Një çështje tjetër të cilën e tha një prej kolegëve nga LDK, kemi shumë pagesa nga vendimet gjyqësore dhe është e vërtetë që kjo është rrjedhojë e obligim nga kontrata kolektive dhe këtë problem e kanë të gjitha komunat. Edhe më herët por edhe ne tani që jemi në pushtet në nivel qendror është dashur ta ndalim këtë çështje, është dashur të merremi seriozisht me këtë çështje e jo të maltretohemi, unë vijë nga fusha e arsimit dhe ka raste q te shkolla vjen një avokat, shkon një avokat, ai tjetri, ky tjetri, prandaj për mendimin tim edhe kjo është e pa pranueshme, kjo formë si është duke shkuar kështu po dëmtohen edhe punëtorët e arsimit, shëndetësisë, administratës por natyrisht dëmtohet edhe Komuna përmes përmbaruesve në procedurat tjera.

Sa i përket çështjeve tjera që u potencuan është e vërtetë që ka disa kode të cilat kanë rritje por megjithatë unë them që paratë janë për të bërë investime, prandaj unë jam që të ketë investime dhe natyrisht kur bëhen investime ka edhe harxhime, dhe për atë është buxheti.

znj.Arjeta Salihu, theksoi, i nderuar drejtor i DBF, edhe një pyetje kam lidhur me një kod tjetër që është për subvencionet për etnitete jo publike kodit 21200, viti 2024, keni shpenzuar 530,267.00€, ndërsa në vitin 2023 janë shpenzuar 212,000.00€, do të thotë kjo është një diferencë e madhe, andaj nga ju kërkojmë një sqarim.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, pa dashur me i përsëritë këto që i than kolegët tjerë, unë po e bëjë një pyetje për shpenzimet për anëtarësim rreth 15,000.00€, çfarë anëtarësimi ka paguar Komuna e Podujevës, sepse në këtë raport potencohet që shpenzimet për odën e mjekëve dhe odën e infermierëve Komuna më nuk i paguan por në fakt e ka një kosto prej 15,000.00€ për disa shpenzime të cilat ne nuk i dimë, cilat anëtarësime i ka paguar Komuna e Podujevës.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, faleminderit për të gjithë për pyetjet dhe diskutimet të cilat i parashtruat gjatë këtij diskutimi për raportin financiar për 6 mujorin e parë janar-qershor 2024, do bëjë përpjekje që në formë të përmbledhur t'i japë përgjigjet për të gjitha këto pyetje duke shpresuar që mos të mbesim diçka pa u sqaruar. Disa çështje u shtruan nga disa asamblistë dhe normalisht për ato po e japim vetëm një përgjigje në mënyrë që mos të përsëritëm.

Fillimisht ishte çështja te regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve, dihet që regjistrimi i automjeteve është një pagesë që i bëhet Ministrisë së Punëve të Brendshme për automjetet të cilat i ka në pronësi Komuna e Podujevës, QKMF dhe Shërbimi i zjarrfikësve për automjetet të cilat i ka për kryerjen e shërbimeve të tyre dhe afërsisht kostot vjetore të këtyre dy kategorive janë thuajse të ngjashme, mirëpo ajo ku mund të dalloj është brenda raporteve periodike financiare është se në disa vite mund të kryhen këto pagesa, ta zëmë një muaj më herët varësisht se si sjellën faturat kur skadojnë regjistrimet dhe sigurimet e automjeteve si dhe çështjet e planifikimit financiar, përndryshe është e ngjashme përjashtimisht ka rritje sepse dy automjete janë të reja në Komunën e Podujevës gjatë vitit 2024 të cila nuk kanë qenë në vitin 2023 si dhe 3 automjete në shëndetësi të cilat janë të reja dhe regjistrohen edhe sigurohen. Në përgjithësi këtu bëhet fjalë për transfer të mjeteve brenda institucioneve publike që është shumë transparente dhe çdo gjë është në rregull.

Te ujësjellësi ishte fjala për një shpenzim 60,000.00€, pyetja që u shtrua nga dy asamblistë bëhet fjalë për një Marrëveshje / Memorandum të bashkëpunimit të cilin e ka nënshkruar Komuna e Podujevës me ujësjellësin ku ka qenë një projekt afër 300,000.00€ dhe pjesën dërmuese të vlerës së projektit për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit e ka pas Kompania e Ujësjellësit, një pjesë e ka pas Ministria e Ekonomisë dhe 60,000.00€ ka qenë participim i Komunës së Podujevës, pra bëhet fjalë për zgjerimin e ujësjellësit në fshatrat Llugë dhe Bellopojë, dhe kjo ka të bëjë me këtë shpenzim.

Dinamika e rrjedhjes së investimeve kapitale u diskutua ku është kjo vlerë të cilën e paraqitëm te investimet kapitale është një çështje që zakonisht tre mujori i parë dhe tre mujori i dytë kanë një shpenzim më të vogël të investimeve kapitale për arsye se tre mujori i parë ka të bëjë edhe me çështje klimatike, mirëpo edhe kjo është një periudhë kur është procedura e prokurimit dhe fillimi i projekteve dhe pagesa ka ma pakë për arsye se dinamika e punëve në terren është më e vogël në këtë periudhë për shkak që kontratat zakonisht e që kemi edhe sot shumë kontrata që ende janë në procedurë të prokurimit dhe tani është kryesisht faza e lidhjes së kontratave që bëhet fjalë ta zëmë për një fshat ku janë të planifikuara 40,000.00€, në fshatin tjetër 60,000.00€, fshatin tjetër 50,000.00 që janë projekte jo të mëdha në kuptimin financiar por kur të grumbullohen kanë një vlerë të madhe financiare dhe me këtë dinamikë qysh është në plan të prokurimit dhe me këtë dinamikën e shpenzimeve financiare besojë që do të kemi një realizm të kënaqshëm të investimeve kapitale për vitin 2024.

Te shpenzimet e varrimit është cekë dhe sigurisht këtu është çështja që është bërë nga pagesa e kodit për shpenzime kontraktuese se këto mjete të cilat i kemi ne faktikisht bëhet fjalë për

subvencione për etnitete jo publike, i nderuar Naim Çunaku, është çështja të shpenzimet e varrimit, arsyeja se këto mjete realizohen nga kategoria e subvencioneve dhe janë subvencion për etnitet jo publik qysh është subvencion për Bashkësinë Islame ku në bazë të Marrëveshjes dhe në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës paguhet vlera financiare për çdo person të vdekur ku subvencionohen shpenzimet e varrimit nga Komuna e Podujevës dhe bëhet fjalë për mjetet të cilat i janë transferuar Bashkësisë Islame të Komunës së Podujevës.

Te mirëmbajtja e ndërtesave arsimore u cek se ka një diferencë, tani kjo varet nëse e krahasojmë periudhën që është shumë mirë që janë bërë investime për mirëmbajtjen e ndërtesave komunale por nëse e shohim krahasimin mes dy viteve kjo është për arsye se gjatë kësaj faze janë realizuar punime, tani mundemi në 6 mujorin e dytë me pas shpenzime më pak në mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, këto janë në bazë të planifikimeve buxhetore që kemi për vitin 2024.

U cek edhe mirëmbajtja e mobileve dhe nga 2-3 asamblistë, bëhet fjalë për një kod ekonomik, jo vetëm në këtë rast por çdo shpenzim i cili figuron në raportin financiar e ka një kod ekonomik, kodi ekonomik është me plan kontabël, planin kontabël nuk e bën Komuna e Podujevës dhe nuk i përcakton këto kode Komuna e Podujevës, është një plan kontabël i miratuar nga ana e Ministrisë së Financave ku ne jemi të detyruar t'i përmbahemi domosdo dhe për arsye teknike nuk mund të kalohet ai pa i'u përmbajtje atij, do të thotë në momentin kur ekzekutohet një pagesë zyrtari zotues duhet ta shënoj kodin ekonomik, në rast se nuk e shënon kodin ekonomik në bazë të planit kontabël ajo pagesë nuk mund të procedohet, nuk lejon as teknikisht në sistemi SIMFK të pagesave për realizimin e pagesës.

Te mirëmbajtja e mobileve bëhet fjalë për mobile dhe pajisje, bëhet fjalë për mobile dhe mirëmbajtje të mobileve, ky kod dhe ky shpenzim për vlerën 30,000.00€ që u cek bëhet fjalë për mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, mirëmbajtjen e kamerave të qytetit dhe disa mirëmbajtje të tjera, nuk ka të bëjë me mirëmbajtjen e karrigeve ta quaj ashtu apo këtyre mobileve ku jemi të ulur ne, por bëhet fjalë për mobile dhe pajisje, kështu është kodi ekonomik dhe plani kontabël.

Sa i përket fushave sportive që u ceken, kjo është një kontratë dy vjeçare ku për këtë vit janë të planifikuara 200,000.00€ dhe është një projekt në realizim e sipër varësisht prej raporteve të pranimit të cilat i bëjnë menaxherët e kontratave, procedohet dhe bëhet pagesa për realizimin projektit në fjalë.

Te të hyrat vetanake, këtu e mira është që kemi një trend nëse e këqyrim me planifikimin e përgjithshëm të të hyrave vetanake kemi një trend të kënaqshëm të të hyrave vetanake, mirëpo kemi një ngecje dhe kemi një rënie të konsiderueshme të të hyrat vetanake nga tatimi në pronë për arsye se ne si Komunë e Podujevës, përkatësisht në propozim të Ekzekutivit Kuvendi i Komunës ka miratuar vendimin që ta kemi një falje të tatimit në pronë në vlerë 100€, dhe normalisht kjo ka ndikuar që të kemi një rënie të të hyrave vetanake në rast se e krahasojmë me vitin e kaluar, çështje kjo e cila u diskutua nga z.Bashkim Syla dhe 1 anëtar tjetër i Kuvendit që ishte lidhur me trendin e investimeve kapitale dhe trendin e të hyrave vetanake.

Te çështjet e drekave zyrtare dhe akomodimeve, sërish po më duhet të lidhem me planin kontabël dhe kanë apo nuk kanë akomodim restorantet, vitet e kaluara ka qenë një kod ekonomik për dreka zyrtare, në planin kontabël këtë vit Ministria e Financave e ka larguar si kod dreka zyrtare, i vetmi kod ekonomik është akomodimi për udhëtime, madje nëse e bazojmë në numër është i njëjti kod ekonomik që ka qenë për dreka zyrtare dhe kryesisht ky ka të bëjë me dreka zyrtare ku pjesë e këtyre shpenzimeve ashtu siç e kemi cek edhe në raportin e 3 mujorit dhe një shpenzim që e kemi bërë e që kanë qenë të pranishëm edhe asamblistët për drekën e fund vitit ku kanë marrë pjesë të gjithë zyrtarët komunal, Ekzekutivi njëkohësisht edhe e gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës, dhe për drekat tjera të cilat janë të delegacioneve të ndryshme apo edhe për akomodim siç ka qenë

rasti i znj.Dorisc Pack që ka ardhë në Komunën e Podujevës si mysafire dhe i është paguar akomodimi për udhëtim zyrtar brenda vendit.

Shërbimet këshillëdhënëse, që u ceken nga z.Ekrem Rrahmani, shërbime këshillëdhënëse kanë të bëjnë me pagesa për të cilat janë bërë për hartim të projekteve, do të thotë hartimet e projekteve të cilat janë kontraktuar, kodi ekonomik për këtë çështje është për shërbimet këshillëdhënëse, shërbimet kontraktuese tjera ka shumë shpenzime të cilat bëhen me këtë kod ekonomik, shembull këtë e kemi sqaruar besoj edhe herëve tjera, dezinfektimi i hapësirave publike është shërbim kontraktues dhe ajo ka një kosto, pastaj kemi shpenzimet e transportit të cilat bëhen për shërbimet e transportit të nxënësve nga shkolla në shtëpi anasjelltas dhe këto janë përmes kodit të shërbimeve kontraktuese dhe normalisht nëse i grumbullojmë të gjitha, është kjo vlerë afër 130,000.00€ të cilat janë për këtë 6 mujor për shërbimet kontraktuese.

U përmend edhe pagesa për rr.“Xhemajl Mustafa”, është një çështje që pagesat dhe realizmi i projekteve shkojnë në mënyrë të sinkronizuar, por si është çështja, një kontratë i ka disa situacione, ta zëmë nëse vlera e një kontrate është 1,000,000.00€, ajo mund të kryhet me 5 pagesa për punë të realizuar deri në vlerë 200,000.00€, bëhet raporti i menaxherëve të kontratës dhe dorëzohet në Komunë / DBF, dhe në bazë të raportit sikurse në çdo procedurë tjetër dhe në fund kur bëhet raporti i pranimit teknik bëhet pagesa e situacionit përfundimtar, andaj me këtë trend është edhe pagesa e rr.“Xhemajl Mustafa” dhe jo vetëm për këtë rrugë, por për secilën rrugë që është bërë pagesa e që ndoshta deri më tani ndonjë rrugë nuk është kryer përfundimisht dhe janë në fazën e realizimit dhe në bazë të realizimit dhe raportit të menaxherit të kontratës bëhet edhe pagesa e tyre.

Nga znj.Arjeta Salihu u ceken shërbimet tjera kontraktuese për të cilat veç se u përgjigja mirëpo bëhet fjalë për pagesat për punë jashtë orarit të punës e që shumë zyrtar publik për punë të cilat i bëjnë pas orës 16:00 ose gjatë vikendeve, në bazë të Ligjit të punës, Komuna është e detyruar t’jua bëjë pagesën atyre si kompensim për arsye se ai zyrtar i cili punon pas orarit në bazë të një urdhërese që i është lëshuar nga mbikëqyrësi për atë arsye bëhet pagesa e atyre zyrtarëve komunal apo punonjësve shëndetësor apo zyrtarëve të arsimit.

Një çështje tjetër që u cek rreth shpenzimeve të anëtarësimit në shumë 15,000.00€, bëhet fjalë për shpenzime të anëtarësimit të cilat zyrtarët komunal, punonjësit e arsimit apo të shëndetësisë janë të anëtarësuar në sindikata dhe në momentin kur është i anëtarësuar në shpenzimet e anëtarësimit atyre, do të thotë në listë të pagave, iu ndalet ajo pagesë dhe në mënyrë automatike shkon në sindikatë e që kjo bëhet me vullnetin e çdo punonjësi i cili nënshkruan për pagesë në sindikatë.

Te investimet kapitale që u përmenden rrugët lokale nga të hyrat vetanake, këto janë në bazë të planifikimit të buxhetit, do të thotë ka pas investime kapitale të cilat janë për ndërtim të rrugëve dhe këtu kemi një kod ku janë shpenzuar 670,000.00€ në kodin ekonomik toka që është te investimet kapitale dhe që ka të bëjë me shpronësimet që janë bërë për zonën industriale dhe ka këtë kod ekonomik ngase kemi blerë tokë edhe pse është kod për ndërtimin e zonës industriale, mirëpo kemi blerë tokë prej AKP-së dhe kemi paguar 20% të vlerës së pronës.

Nuk e di a i mbeta ndokujt obligim për ndonjë pyetje, mirëpo u përgjigja në formë të përgjithësuar për t’i ofruar këto sqarime, kështu që faleminderit për vëmendje.

z.Naim Çunaku, theksoi, faleminderit për atë që drejtori i DBF-së tentoj të na sqaroj rreth pyetjeve dhe shqetësimeve tona por duhet të kthehem në ato që në fillim unë i potencova në foltore dhe që i kisha të bazuara në këtë raport të cilin e kam marrë si dokument zyrtar - material të punës së Kuvendit, dhe ajo që dua të dal, unë e di që mbi 60,000.00€ shpenzime të varrimit s’mund të “avullohen” sepse nuk kemi shkuar në atë masë, mirëpo e di që në këtë kod ekonomik që e keni paraqitur, kodi 13490 është zero, andaj unë po lexoj çka shkruan në raportin që na është paraqitur dhe nuk po shpikë diçka unë por vetëm po lexoj këtu çfarë shkruan dhe duke u bazuar në këtë

raport që na është paraqitur neve, sepse të gjitha ato mundësi që ato shifra po të ishin reale sigurisht se nuk do të ishim ne përballë këtu ngase janë goxha shumë dhe po besoj që nuk ka shkuar shteti ynë në atë masë për mos me marrë masa, mirëpo kur paraqitet një raport duhet të jetë në rend të parë i shpjegueshëm në mënyrë që unë si kuvendar ta di çka ka ndodh me buxhetin dhe nga ajo që unë kam këtu jam i hutuar, jo i informuar por i hutuar.

E para ishte te shpenzimet e varrimit që thash zero, pastaj te petty cash s'përputhet askund, edhe një element tjetër më vie mirë që tani prezent është edhe drejtori i DSHPMSH-së z.Bahri Selimi sepse kur përmenda investimet në ujësjellës ajo problematikë nuk është e sodit por dikush duhet ta zgjedhë dhe kjo problematikë për çdo ditë është duke u rritë prej defekteve me furnizim me ujë, ndërsa sa herë që e kemi pas këtë temë drejtori i DSHPMSH-së, me të drejtë sepse Komuna jonë i ka deleguar kompetencat e saj një Ndërmarrjeje Regjionale, pra me Ligj i është dhënë asaj Ndërmarrje dhe nëse dëshironi me hy më në detaje po hyj sepse Komuna kurrë s'ia ka dhënë, por i është dhënë kur Kosova është qeverisë prej UNMIK-ut - shtylla e 4 e UNMIK-ut por nuk dua të lëshohem në këtë sepse janë tema të gjëra, pra ajo kompetencë në një formë është bartë jo shumë vullnetshëm por e kanë pranuar edhe menaxherët e komunave si diçka më të lehtë edhe pse ligji e ka përcaktuar se komuna është përgjegjëse, mirëpo në këtë çështje ka diçka që s'mund të pajtohem, nëse ne kemi investuar aty ku konkretisht u përmend fshati im, në fakt të gjitha më dhëmbin por më së shumti më dhëmb fshati ku jetoj unë e që kjo është normale, ndërsa drejtori parafolës më dha përgjigjen duke potencuar se bëhet fjalë për zgjerimin e projektit për furnizim me ujë të ujësjellësit në fshatin Llugë, dhe tani shtrohet pyetja, nëse ne mendojmë ekonomikisht dhe prej taksave të qytetarëve dhe prej buxhetit të komunës tonë i ndajmë një Ndërmarrje publike ku jemi aksionarë dhe pra i ndajmë buxhet për menaxhimin e rrjetit, ngase aty nuk është bërë zgjerimi i rrjetit, aty është bërë zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit, dhe një pyetje logjike ekonomike e kam, kompania e ujësjellësit regjional po inkason të hyrat e veta për shërbimin që e bën tek qytetarët, po, apo paguajmë faturat, po, dhe kush është obligues aty për mirëmbajtje të atij rrjet, janë ata, pse ne duhet dy herë t'i paguajmë të njëjtës kompani, kur e them dy herë, njëherë i kam paguar drejtpërdrejtë për shërbimin që më ka ofruar ujë, kam paguar për një shërbim që s'më ofron kurrë asgjë, për kanalizim e kjo nuk është veç për mua por është për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës sepse në faturë shkruan edhe kanalizim e as kurrfarë përgjegjësie nuk ka për punën e kanalizimit, dhe e dyta herë paguaj përmes taksës përmes buxhetit të Komunës investimet tona kosto benefitit të saj. Prandaj në këtë kontest, nuk jam kundër investimeve në ujësjellës por forma qysh janë duke na trajtuar nuk është në rregull, dhe ato konstatimet e mia nuk i shpika por i bazova në letra që më janë dërguar nga ju drejtor.

znj.Arjeta Salihu, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, tek pyetja ime pati paksa një devijim dhe nuk mora përgjigjen e pyetjes që parashtrova, pyetja nuk ishte pse paguhen për orar të pa caktuar dhe jashtë orarit, por pse janë dy kode, kur janë dy gjëra të njëjta.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe unë pak a shumë e pata të njëjtën pyetje sikurse parafolësja kolege te këto pagesat shtesë, një kod thotë shtesat e veçanta për tu zgjedhur, tjetri shtesa për punë për orar të paracaktuar, pastaj një kod për shtesa për vëllimin e punës, tjetri shtesë për kujdestari, puna gjatë natës dhe puna jashtë orarit të natës, pastaj kemi edhe tjetrin ku thuhet shtesat transitore, prandaj a ka mundësi të na shpjegoni rreth tyre në mënyrë që ne ta dim sakt për çka janë, ndoshta ne këto i marrim vesh paksa, por qytetarët pak i kuptojnë.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, një pyetje e kam rreth kodit buxhetor 13509 pajisjet tjera, çka përmbajnë këto pajisje se e shohim se ka edhe kode të tjera të cilat përmbajnë pajisje mjekësore, pastaj shembull kompjuter, ndërsa kjo është e specifikuar si pajisje të tjera, andaj pyes çfarë përmban saktësisht ky kod.

z.Ragip Fetahu, theksoi, natyrisht se ka për të diskutuar në këtë raport financiar sepse vetë fjala raport do të thotë është një përmbledhje dhe ka aq shumë informacione sa është krejt normale që të kërkohet sqarim e diskutim për çështje të ndryshme të cilat përfshihen në këtë raport.

Unë pajtohem plotësisht se furnizimi me ujë i qytetarëve të Komunës tonë duhet të jetë prioritet sidomos gjatë pikut të verës duke pasur parasysh edhe faktin që tani kemi një numër të madh ose procedura të lëshimit të lejeve të banimit kolektiv e cila do të vështirësoj edhe më shumë furnizimin me ujë dhe që kërkon trajtim ose zgjidhje shumë më të shpejtë, natyrisht është paraparë edhe ndërtimi i digës mirëpo mendojmë që të kemi zgjidhje sa më të shpejtë për këtë çështje.

Ajo në të cilën unë dua të fokusohem dhe ta theksoi është efikasiteti i Komunës, efikasiteti i Ekzekutivit në mbledhjen e të hyrave vetanake në qoftë se i shikojmë dhe analizojmë tabelat mund të konstatojmë se kemi një rritje të theksuar si për shfrytëzimin e tokës komunale që do të thotë se është një aftësi në menaxhimin e pronave publike, pastaj kemi te dhënia e lejeve po ashtu rritje që do të thotë se ka interesim shumë të madh të bizneseve dhe të investimeve kapitale, pra ka një interesim shumë të madh të njerëzve / bizneseve dhe kthimin e potencialit kapital në Komunën tonë që do të thotë se është një shenjë e mirë dhe shumë pozitive sepse shihet pozitiv edhe nga investitorët privat Ekzekutivi i Komunës duke marrë parasysh transparencën e përgjithshme të Komunës së Podujevës.

Pastaj ajo që unë shohë këtu kemi një rritje të të hyrave nga taksat e pronës komunale ku siç e dimë në të kaluarën prona komunale ka qenë në shfrytëzim vetëm për interesa personale dhe nuk ka gjeneruar të hyra në nivelin lokal dhe duke u bazuar në këto fakte mund të themi se kemi ndryshime shumë pozitive në investimet dhe në të hyrat e përgjithshme në Komunën tonë, natyrisht se çështjet të cilat u ngritën janë për tu diskutuar dhe drejtori i DBF-së mund të na informoj më tej për informacionet e kërkuara.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, bëra përpjekje edhe herën e parë në formë të përgjithësuar t'i trajtoj të gjitha, diçka çka është një çështje që ndoshta vlen të ceket që shpenzimi i parasë publike dhe të gjitha këto pagesa të cilat paraqiten në raport ka një procedurë të cilat realizohen, të cilat kalojnë nëpër disa zyrtarë deri sa të vije puna te certifikimi i disa pagesave dhe për çdo gjë jemi shumë transparent, ne kemi këtu prej një asamblisti të LDK-së, por besoj se e kanë shpërndarë edhe për të tjerët ku e kanë kërkuar raportin financiar për çdo faturë të shpenzuar që është e drejtë përmes qasjes në dokumentet zyrtare, iu kam thënë edhe në të kaluarën se i është ofruar ajo qasje çdo herë dhe në çdo kohë mjafton një e-mail me dy fjalë ku e kërkon raportin financiar, jo vetëm raportin qysh e ka kërkuar z.Ekrem Rrahmani nga Free Balance, mirëpo ne jemi shumë në disponim t'ju ofrojmë komplet pagesat në formë të skanuar të cilat i realizojmë në DBF. Çdo pagesë e cila bëhet komplet dosjen e asaj pagese ne e skanojmë, për arsye tona ne i skanojmë ato pagesa me nënshkrimet e zyrtarëve përkatës, me nënshkrimet e drejtorëve, me raportet e menaxherit të kontratës komplet lënda skanohet dhe neve na duhen 3 minuta kohë t'ju japim komplet dosjen.

Ishin edhe dy çështje që u shtruan si pyetje lidhur me çështjet e shpenzimit të pagës, shpenzimet e veçanta për të zgjedhurit që janë në listë të pagave që kanë kode ekonomike të ndryshme, shtesa për punën pa orar të paracaktuar, shtesa për vëllim të punës, shtesa për nëpunësin në sistem shëndetësor edhe këto kujdestaria gjatë natës dhe punë jashtë orarit të punës, që të gjitha këto janë në bazë të Ligjit të ri të pagave dhe në bazë të disa Rregulloreve të cilat janë miratuar dhe në bazë të vendimeve të cilët angazhohen zyrtarët e caktuar publik.

Ta zëmë shtesa e veçantë për të zgjedhurit, dihet kush janë të zgjedhurit, janë stafi politik, asamblistë, drejtorët dhe të tjerët, shtesa për punë pa orar të paracaktuar ka një mundësi që zyrtarëve për shkaqe specifike iu jepet shtesë për punën pa orar të paracaktuar, shtesa për vëllim të

punës ka ndonjë zyrtarë të caktuar të cilit i është deleguar një punë shtesë jashtë detyrave të tij dhe i jepet një shtesë për vëllim të shtuar të punës dhe shtesat për vendim për nëpunësit e sistemit gjyqësor, si dhe punët për shtesat tranzitore që i keni në një kod ekonomik që ka kod ekonomik të veçantë, dhe tani me Ligjin e pagave disa zyrtarëve i'u është zvogëluar paga në raport me atë që ka pasë paraprakisht mirëpo është një detyrim ligjor të cilin e përcakton sërish Ligji i pagave që atij nuk i zvogëlohet paga për dy vite dhe gjatë këtyre dy viteve merr një shtesë tranzitore deri sa të kalojnë këto dy vite dhe mund të ndodh rritja e koeficientit dhe njëkohësisht rritja e pagave ia mbulon këtë rritjen paraprake dhe këta zyrtarë komunal kanë një shtesë tranzitore që e mbulon.

Asambleistja znj. Arnisa Sylejmani e pati një pyetje për pajisjet të tjera, tani ka shumë pajisje të cilat e kanë kodin ekonomik, shembull është kodi për kompjuter, kodi për aparate fotokopjuese edhe pse nuk kemi blerë, pastaj pajisjet mjekësore kanë kodin e vet ekonomik, mirëpo janë disa pajisje të cilat nuk kanë kod të veçantë ekonomik, shembull kamerat nuk ka kod të veçantë ekonomik, klimat në rast se blihet diçka edhe kjo nuk e ka kodin e veçantë ekonomik por specifikohet me kod ekonomik që është pajisje tjera, është pajisje dhe identifikohet si pajisje tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës përfunduan andaj edhe e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

Meqë po e vërej se shumica e anëtarëve të Kuvendit po kërkojnë pauzë, atëherë nëse pajtoheni mund të shkojmë në pauzë për 1 orë, dhe atë deri në 13:15.

Meqë askush nuk ishte kundër, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë 1 orë, për tu kthyer me vazhdimin e mbledhjes sipas rendit të ditës nga ora 13:15

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 13:35.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi kuorumin ku prezent për momentin janë 26 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit, dhe atë:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori.

(Nga LDK Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Donjetë Sheqiri; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor.

Të pavarur, Adnan Zymeri.

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes nga Ekzekutivi i Komunës ishin drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Shuajb Blakçori-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Humolli Humolli Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS (U.D. drejtoresh); Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimimit DSHPMSh; Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE;).

Të pranishëm ishin përfaqësues të media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me mbledhjen aty ku kemi mbet me radhë në pikën e tetë të rendit të ditës.

8. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2023

8.1. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, Zyra Kombëtare e Auditimit ka bërë auditimin e pasqyrave financiare dhe veprimtarive të tjera të Komunës së Podujevës, ku periudha e auditimit ka përfunduar në dy faza, faza e parë ka qenë në muajin shtator dhe pastaj pas përmbylljes së vitit fiskal është kryer auditimi përfundimtar nga ana e Zyrës Kombëtare të Auditimit. E vërteta është që edhe në këtë vit ashtu si edhe pjesa dërmuese e komunave kemi një raport të kualifikuar nga Zyra Kombëtare e Auditorit, kualifikim ky që vjen kryesisht nga keq klasifikimet e që keq klasifikimet nuk janë si rezultat i veprimeve tona si Komunë, mirëpo janë si rezultat i kontratës kolektive dhe vendimeve gjyqësore të cilat janë marr dhe janë ekzekutuar mjetet nga buxheti i Komunës së Podujevës për realizimin e kontratave kolektive të cilat kanë qenë vendime gjyqësore dhe janë ekzekutuar pastaj me urdhër të Thesarit të shtetit, pra këto janë ekzekutuar nga ana e Thesarit dhe jo nga ana jon.

Pjesa dërmuese e këtyre vendimeve gjyqësore janë ekzekutuar nga kategoritë përkatëse pra nga kategoria e pagave, mirëpo një pjesë e tyre është marr nga kategoritë e tjera si kategoritë e investimeve kapitale dhe e mallrave dhe kjo ka ndikuar në opinionin e auditorit.

Në bazë të raportit të auditorit të pasqyrat financiare konstaton se pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik sipas kontabilitetit të bazuar në parat e gatshme.

Në këtë vit janë 13 të gjetura nga ana e auditorit ku kryesisht apo të gjitha janë të natyrës teknike administrative dhe nuk është asnjë e gjetur nga ana e auditorit i cili rrjedh nga një shkelje ligjore ose abuzive nga ana e Komunës së Podujevës, mirëpo janë të gjetura që kanë të bëjnë me keq klasifikime me llogari të arkëtushme, me regjistrimin e pasurive, me disa vonesa të pagesave të cilat janë bërë për arsyeje të mungesës së buxhetit në periudha të caktuara kohore kur kanë ardhur faturat ku kryesisht kanë të bëjnë me planin e menaxhimit të Cash-it ose çështje të tjera.

Të bashkëngjitur e keni edhe planin e veprimit për zbatimin e këtyre rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit edhe në qoftë se e krahasojmë me të gjeturat e vitit të kaluar, ka disa të gjetura të cilat nuk janë të përsëritura në këtë vit, pra kjo nënkupton që janë zbatuar rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, mirëpo janë disa të gjetura siç është keq klasifikimi ku e shpjegova arsyen se pse ka ardhur deri te keq klasifikimi, regjistrimi i pasurive është një problematik që e shoqëron Komunën e Podujevës ndër vite për arsyeje teknike dhe organizative për arsye se Ministria e Financave ka një periudhë kohore ku me 10 janar e mbyll sistemin dhe po është fundi i vitit ku numri i pagesave po është më i madh në këtë periudhë dhe janë pagesa të cilat ekzekutohen, pastaj nuk regjistrohen si pasuri në periudhën e caktuar kohore.

Përveç kësaj kemi pas edhe një çështje që ka të bëjë me ndërrimin e zyrtarit të pasurisë ku kemi pas një vonesë në certifikimin e zyrtarit të pasurisë dhe i kanë mbetur disa pasuri të tjera të pa regjistruara. Ka llogari të arkëtueshme që është një e gjetur e cila përsëritet, përkundër që ka një përmirësim të mbledhjes së të hyrave vetanake dhe zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme prapë është një numër i madh i llogarive të arkëtueshme të cilat i ka Komuna e Podujevës e që nuk ka arritur t'i mbledh as gjatë vitit 2023, por po e them që e mira dhe konstatimi nga ky raport i auditimit që mund të nxjerrim është se nuk ka asnjë cent të humbur buxhet si rezultat i veprimeve të zyrtarëve apo stafit të përgjithshëm të Komunës së Podujevës, pra nuk ka asnjë të gjetur e cila konstaton humbje buxhetore për Komunën e Podujevës. Nuk dua që të zgjas më shumë, por për të gjitha diskutimet që bëhen nga ana e anëtarëve të Kuvendit dhe të gjitha çështjet të cilat shtrohen rreth raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit jam i gatshëm që të jap përgjigje.

z.Haki Rudari, theksoi, në raportin financiar e theksova që janë tri shkallë të cilat e mbikëqyrin buxhetin e Komunës në tërësi dhe tash jemi te shkalla e tretë që për mendimin tim është edhe auditimi i jashtëm. Pra shkalla e tretë e mbikëqyrjes së buxhetit komunal është Zyra e Auditorit të Përgjithshëm përmes personelit si në rastin konkret.

Çka është auditimi i jashtëm, Auditimi i jashtëm është një kontroll i pavarur i pasqyrave financiare i një etniteti qëllim i të cilit është dhënia e opinionit lidhur me atë se a janë pasqyrat financiare pamje e vërtetë dhe e drejtë në aspektin financiar të operacioneve të ndryshme, si dhe a janë në pajtueshmëri me standardet e raportuesit të kontabilitetit dhe standardet financiare të adaptuara të cilin e theksoi edhe drejtori i DBF më herët. Në raportin e auditimit që realisht është i kualifikuar që të them në gjuhën sportive apo në aspektin sportiv kualifikimi është sukses, mirëpo në rastin konkret raporti i kualifikuar nuk e thekson të njëjtën gjë. Janë 13 të gjetura të cilat i përmendi edhe drejtori i DBF-së, natyrisht unë nuk dua që të ndalem te këto çështje sepse as nuk mund t'i largoj apo t'i ndryshoj, por një çështje që e theksova te raporti financiar që kemi te raporti i auditimit është prapë çështja e procedurave gjyqësore që ndërlihet vërtetë me kontratën kolektive.

Unë do të ndalem më shumë te progresi i zbatimit të rekomandimeve, realisht në bazë të këtij raporti 5 rekomandime janë zbatuar, një është mbyllur dhe tetë rekomandime të tjera nuk janë zbatuar ende, dhe unë shfrytëzoj rastin që të thërras Ekzekutivin që të gjitha rekomandimet të merren seriozisht në mënyrë që të vije deri te përmirësimi i tyre dhe fundja dëshira mbetet dëshirë, por raportin që na kanë sjell është raport që ne duhet të pranojmë, prandaj në këtë drejtim thërras dhe kërkoj që rekomandimet që kanë ardhur të merren më seriozisht dhe natyrisht që të bëhen angazhime në eliminimin e tyre.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, është viti i dytë me radhë që raporti i auditorit në Komunën ton rezulton i kualifikuar, prandaj mendoj që është shumë e nevojshme të paraqesim realitetin para qytetarëve dhe të njoftohen për të gjitha shkeljet dhe keqpërdorimet që po bëhen nga ky Ekzekutiv. Për të gjitha kemi reaguar gjatë gjithë kohës, por të gjitha ato që i kemi thënë kanë rënë në vesh të shurdhur pasi që i ka habitur lakmia e zhvatja që po i bëhet parasë publike nga këta që i kemi ulur përball dhe menaxhojnë me paranë publike. Në raportin e fundit vërtetohen të gjitha ato që i kemi thënë, pra këta janë duke dështuar që të përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve por assesi nuk po dështojnë që t'i mbushin gjepat e tyre.

Gjetjet kryesore të raportit të auditorit janë mungesa e projekteve ekzistuese ku në tri raste Komuna ka filluar procedurat e prokurimit dhe ka lidhur kontratë pa hartuar projekt ekzekutiv, raste këto të cilat përfshijnë asfaltimin e rrugëve në qytet në Loti 1 në vlerë prej 144,000.00 €, asfaltimi i rrugëve në qytet Loti 3 në vlerë prej 118,000.00 € dhe rrethojat e oborreve të shkollave në vlerë rreth 47,000.00 €, pastaj përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë ku Komuna kishte përdorur gabimisht llojin e kontratës publike kornizë për projektin kapital rrethojat e oborreve të shkollave në vlerë rreth 47,000.00 € dhe kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit për të respektuar kërkesat ligjore që ndërlidhen me kontratën publike kornizë për punë. Pra po bëhen katër vite qeverisje dhe ende të bëhen gabime të tilla për diçka që duhet të lidhet me çmim fiks këta lidhin kontrata kornizë duke lejuar plus-minus deri 30% tejkalimin e vlerës së kontratës dhe a e dini pse, sepse minimumi i atyre 30% hyn në gjepat e tyre.

Tejkalimi i sasive indikative në kontratën publike kornizë, te kontrata publike kornizë furnizim me barna dhe reagenca në vlerë prej 541,956,00 € janë identifikuar tejkalime të sasive në 11 pozicione në vlerë prej 3,838.00 €, kjo tregon që ky pushtet nuk ka kursyer edhe keqpërdorimin në barna.

Inicimi i projektit pa zotim të mjaftueshëm të mjeteve, ku në katër raste Komuna e Podujevës kishte hyrë në obligime kontraktuale pa mjete të mjaftueshme të zotuara duke e fut në obligime financiare Komunën dhe kjo në gjuhën e popullit kuptohet si shprehje “hajt se të vij”. Nënvlërësimi i pasurive mbi dhe nën 1.000 €, pasurit kapitale mbi 1.000 € të raportuara në nenin 19.3.1 në raportin vjetor financiar ishin nënvlerësuar për shkak se pagesat në vlerë prej 1,293,000.00 € nuk ishin të regjistruara në sistemin informativ për menaxhimin e financave, po ashtu pasurit kapitale nën 1.000 € për vitin 2023 nuk ishin të regjistruara në sistemin e-pasurisë në vlerë rreth 250,000.00 €.

Keq klasifikim i shpenzimeve ku nga testimi i mostrave është vërejtur keq klasifikim i shpenzimeve në kategorinë ekonomike në vlerë prej 300,00.00 €, këto kishin ndodhur për shkak të planifikimit jo të mirë buxhetor dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate dhe këtë çdo herë e kemi ngritur si shqetësim për keq klasifikim dhe keq planifikim, e që po bëhet një vit dhe po e shihni buxhetin si një thes të vetëm që nuk janë të rëndësishme kategoritë buxhetore, pra shpenzon kush çka dëshiron. Pagesa e projektit nga fondet e një projekti tjetër pa miratim nga Kuvendi Komunal, Komuna ka paguar 200,000.00 € nga fondet e projekteve për ndërtimin dhe ri ndërtimin e kanalizimit fekal dhe atmosferik në fshatin Bajçinë deri në fshatin Lupç për projektin zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të Lumit Llap në qytet pa miratimin e Kuvendit Komunal, pra edhe kjo e

njëjtë si ajo paraprake, i sjellni mjetet ka të dëshironi ju. Regjistrimi i pasurisë në kategorinë e gabuar, pasurit e regjistruara në kategorinë e gabuar ose jo adekuate ishin në vlerë rreth 380,000.00 €, pasi që ato duhet të ishin të regjistruara si investim në vijim.

Mosrespektimi i hapave për procedimin e pagesave nga 32 mostrat e testuar në kategorinë mallra dhe shërbime në 13 raste në vlerë rreth 390,000.00 € nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave. Vonesat në kryerjen e obligimeve të papaguara, në 5 raste në vlerë rreth 250,000.00 € Komuna nuk i ka kryer obligimet financiare brenda afatit 30 ditësh. Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, Komuna nuk kishte një menaxhim efektiv në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme, në pjesën më të madhe që vie nga tatimi pronë në vlerën prej 2,600,000.00 €.

Mos sigurimi i garancionit të performancës dhe orarit të pagesave, Komuna kishte paguar paradhënie për projektin ndërtimi i Shtëpisë për qëndrim ditor për të moshuarit kuzhinë humanitare dhe bujtinë, pa siguruar garancionin e performancës dhe orarin e pagesave. Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës e-prokurimi, menaxherët e kontratave apo projekteve nuk e kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktueseve.

Edhe njëherë dua që të theksoj që këto të gjetura janë një dëshmi e qartë e keq qeverisjes, korrupsionit dhe mungesës së përgjegjësisë nga na e pushtetit aktual në Komunën e Podujevës, kjo qeverisje ka treguar se është e paaftë për të menaxhuar siç duhet fondet publike dhe projektet infrastrukturale duke dëmtuar interesat e qytetarëve të Podujevës, ne do të vazhdojmë që të ngritim zërin për çdo keqpërdorim dhe kërkojmë që përgjegjësit të japin llogari për veprimet e tyre.

z.Bashkim Sylja, theksoi, Zyra Kombëtare e Auditorit ka dhënë një opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore. Raporti zyrtar i auditimit ka nxjerr 13 rekomandime prej të cilave 5 janë rekomandime të reja dhe 8 janë të përsëritura nga viti 2023. Mos regjistrimi i pasurive në klasën e duhur, hyrja në obligime kontraktuale pa zotim të mjeteve të mjaftueshme, menaxhimi i kontratave nuk është bërë përmes platformës e-prokurimi, keq klasifikim i shpenzimeve, fillim i procedurave të prokurimit pa projekt ekzistues, Komuna edhe në këtë vit nuk i ka regjistruar të gjitha pasurit në platformën e-pasuria, mos kryerja e pagesave në afat prej 30 dite, mos përmirësimi i procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, nënvlerësim i pasurive nën dhe mbi 1.000 €, mos sigurimi i garancionit të performancës dhe orarit të pagesave, tejkallim i sasive indikativë në kontratat publike kornizë, mungesë e projekteve ekzistuese, pagesa e projektit nga fondet e një projekti tjetër pa miratim të Kuvendit Komunal.

Unë dua që ti theksoj dy çështje, e di që gjatë procesit të qeverisjes dalin shumë projekte të tjera dhe ka mundësi që disa rekomandime mos të përmirësohen apo të mos zbatohen, mirëpo për disa rekomandime ose nuk keni staf profesional që i bënë këto ose ju nuk jeni të angazhuar personalisht, sepse e kemi rastin te mos regjistrimi i pasurive në klasën e duhur si dhe pagesa e projektit nga fondet tjera e që nuk është problem që të sjellët në Kuvend një propozim vendim në mënyrë që të kryhen procedurat për këto pagesa. Te nënvlerësimi i pasurive dallimi ishte 247 € pra është fjala te nënvlerësimi i pasurive nën 1.000 €, andaj ose është neglizhencë e njerëzve që janë të caktuar për të kryer këto punë ose nuk jeni të interesuar ju vet. Kështu që 8 rekomandime janë përsëritë mendoj se janë shumë, por shpresoj që në vitin tjetër të paktën 3 prej tyre do të përsëriten kurse 5 do të përmirësohen.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, tek gjetjet te furnizimi me barna dhe reagenca, Auditori i Përgjithshëm Kombëtar ka gjetur shkelje te kontratat publike kornizë furnizim me barna dhe reagenca, përkatësisht te pozicioni 16 meteligometrinë ampulë ku sasia e realizuar ishte 1000 copë ndërsa sasia e kontraktuar 300 copë, prandaj a mund të na jepni një sqarim se ku ka mbetur sasia e kontraktuar dhe për çfarë arsyeje janë porositur përderisa nuk gjinden në QKMF, ndërsa tek

pozicioni 35 kanilla 24 gram ku sasia e realizuar ishte 3500 copë ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2000 copë, pastaj gjithashtu edhe te pozicioni 158 mikroveta ku sasia e realizuar ishte 3000 copë ndërsa sasia e kontraktuar ishte 2000 copë, si dhe te pozicioni 204 Lanceta sasia e realizuar ishte 3500 copë ndërsa sasia e kontraktuar 2000 copë, a mundeni që të na jepni sqarime për këto të gjetura të Auditorit, dhe a do të thotë kjo keq planifikim apo keq menaxhim apo të dyja bashkë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, më bëri përshtypje fjala e drejtorit të DBF-së i cili nuk po thotë që Auditori na ka kualifikuar por po e përmend një kontratë kolektive, pra ajo ke vetëm njëra nga pikat ku janë 13 të gjetura dhe shkelje të rënda. Nuk e di pse me kaq komoditet e kalove i nderuar drejtor si mos të ishte asgjë, unë prita nga ti që të bësh kritikë sepse nuk është marre të kritikosh vetën. Më 31 mars e kam thënë në foltore që Auditori në këtë vit do të na kualifikon, drejtoresha më ka kritikuar sepse ka qenë fjala për mjetet që janë dhënë para se të filloj së ndërtuari objekti i shtëpisë së të moshuarave, e që drejtoresha e DSHMS doli bëri popullzim por unë nuk e kundërshtova, dhe tani pikërisht Auditori e ka potencuar këtu në raport.

Në këtë raport nuk është vetëm kontrata kolektive sepse këtu ka shumë të gjetura, njëra ndër të është kur ceket që Komuna kishte përdorur gabimisht kontratën publike kornizë, kjo nuk përdoret gabimisht por përdoret shumë me qëllim sepse kontrata publike kornizë dhe kontrata e punës kanë shumë dallim, nëse e shpall për të ndërtuar një rrethoj të shkollës nuk ka kontratë kornizë aty por ajo është punë që ka për të kryer në oborrin e shkollës, ndërsa kornizë mund të jetë nëse është kontratë 1 vjeçare me mallra dhe herë pas herë e thekson se kur të sjellët malli, pra kjo nuk është gabimisht por kjo është me qëllim për atë 30%-in.

Komuna kishte lëshuar dokumentacion të tenderit pa hartuar projektin ekzistues, pra këtu sipas gjitha gjasave Auditori ka bërë gjetje te fusha e sportit në fshatin Peran, gjithë ne e dimë ku në ueb faqe të Komunës ka qenë kontrata e nënshkruar dhe kontraktuesi i ka lënë punët pa përfunduar, pra pa u përmbyll kontrata dhe është bërë kontratë tjetër e që në asnjë mënyrë nuk guxon të bëhet kontratë mbi kontratë, por që përveç kësaj qa ka ndodhur me ato kontrata janë ndërruar edhe dimensionet e fushës, madje kur e pash me dronë nga 5 km lartësi në mënyrë që të duket bukur video personalisht u çudita sepse ajo nuk është për tu lëvdur por është për marre të shkohet te ajo fushë, aty pa ekskavator nuk mundesh me hy sepse sa mbeturinat janë afër aty nuk mundesh që të hysh prej tyre, dhe përveç kësaj gypat e pusëve ishin në mes të fushës, dhe unë vetëm një gjë nuk po mund të kuptoj, këtu ose ka shumë “budallë” ose ka shumë trima, por ma shumë dyshoj te ajo e para sepse me pas guxim për t’i bërë ato gjëra, kontratë mbi kontratë dhe të ndërrohen dimensionet dhe gjitha tjerat, nuk e di si e merr gjumi atë, ose nuk ka prokurori këtu apo hetuesi.

Tani thoni që nuk ka gjetje dhe nuk është keqpërdor, e keni mësuar vetëm kontrata kolektive dhe po e përmendni vetëm atë edhe pse në të gjitha fushat keni thënë se po sa vijmë ne në pushtet do të rregullojmë atë, tani pas 4 viteve pushtet sërish fajin t’jua lëni atyre para 50 viteve, vërtetë unë nuk e kuptoj këtë punë. Pika tjetër thekson që Komuna ka hyrë në obligime kontraktuale pa pasur fonde të mjaftueshme të zotuara, mandej mos pagesa e obligimeve brenda afatit ligjor 30 ditë, unë pak më herët te raporti financiar e potencova shembullin që ka kompani të cilës pa e përfunduar punën i jepen parat, kurse këtu thuhet pasi ka dorëzuar të gjitha dokumentet që ka përfunduar puna jo 30 ditë por deri 4 muaj është bërë vonesa e pagesave, ndërsa në anën tjetër tepron buxheti, andaj nuk e di përse ndodhin vonesa këtu, a duhet ai që të vij këtu dhe të lut ndonjërin merri kaq dhe lëshomi këto fatura apo pse bëhet kjo vonesë ngase është e përcaktuar me ligj kur më së largu pas pranimit të punës 30 ditë është afati për të bërë pagesën dhe nuk ka logjikë që të bëhen pagesat ditën e fundit, mirëpo si të përfundon punën është mirë të bëhen pagesat, sepse ka kompani që i merr parat para se të përfundoj punën dhe para se të nis punën e që vëreja te raporti financiar ku

janë cek pagesat e fushave në qytet dhe që është përfunduar fusha në Siboc por që ajo fushë nuk është përfunduar.

Ka ende pika tjera të cilat nuk janë siç po e theksoni ju, një ndër to është keq klasifikimi i shpenzimeve e që nuk është për kontratë kolektive por për shumë pika të tjera që nuk kanë të bëjnë me kontratën kolektive. Gjetje tjetër është ajo që Komuna kishte filluar procedurat e prokurimit dhe kishte lidhur kontratë pa hartuar projekte, unë nuk e di çfarë kontrate lidhë pa pasur projekt, madje çuditërisht edhe me ata që konkurrojnë apo vetëm nëse ju i tregoni që të konkurrojnë me këtë ose atë çmim sepse pa e ditur se çka do të ndërtoj qysh i'a vendos çmimin projektit dhe qysh konkurren dikush pa pasur projekt fare, prandaj nuk e di arsyen përse po e bëni kaq të lehtë sepse nuk është kështu. Kemi shembullin tjetër asfaltimet e rrugëve në qytet Loto 1, 2, 3, kjo më shumë është vetëm t'i japim ndokujt ndonjë pare, rasti konkret rr."Ilir Konushëfci" që është te Stacioni i Policisë e që unë mendoj që prej të gjithave rrugëve asfaltin më të mirë e ka pas, kurse e keni heq asfaltin e mirë dhe e keni shtruar asfalt të keq, kjo është katastrofë.

Si pikë tjetër është ku Komuna në 4 raste ka hyrë në obligime pa mjete të mjaftueshme të zotuara, këtu është një dallim, shembull, ekzaminimi i materialeve ndërtimore ku vlera e zotimit ishte 4.000 € ndërsa vlera e parashikuar e kontratës 40.000 €, dhe nëse nuk e dalloni këtë vlerë të shumës unë nuk e kuptoj. Pastaj rasti tjetër është tek hartimi i projekteve ku vlera e zotimeve është 3.000 € ndërsa kontrata 140,000.00 €, pra këtu është një diferencë tepër e madhe, mandej furnizim me materiale për mirëmbajtje të objekteve komunale vlera e zotimit 20,000.00 € ndërsa vlera e kontratës 119,000.130 €, pra janë të zotuara 20.000.00 € dhe vetëm edhe një 1-sh përpara dhe bëhet 120,000.00 € e që edhe tek kjo kontrata diferenca është shumë e madhe.

Ka edhe pika tjera dhe nuk e pata ndërmend të marr fjalën por mu duk që shumë me lehtësi e pranuat këtë raport. Sa kam informata që nga paslufta raport i kualifikuar nga Auditori është hera e tretë që është sjellë, një herë mund të falet sepse ka qenë pandemia dhe kanë qenë rrethana të tjera, mirëpo ju në këtë kohë vitin e kaluar keni thënë që këto nuk do të ndodhin më dhe do t'i eliminoni si dhe do t'i bëni planifikimet e duhura, kurse tani në këtë vit raporti është edhe më keq, edhe pse në të gjitha e keni shkruar, pajtohem, pra kjo është më e keqja, jeni pajtuar dhe kanë mbetur ashtu prapë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, **kërkoj nga parafolësi** z.Ekrem Rrahmani të jesh i kujdesshëm me fjalorin sepse më herët përdore terme siç ishte fjala "budall", nuk është nevoja që këto fjalë të përdoren në Kuvendin e Komunës sepse nuk mund të japim ne konstatime për askënd, prandaj ju lus të keni kujdes herëve të tjera sepse është Kuvend dhe nuk lejohet.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur po e trajtomë raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2023, po trajtojmë një raport të një organi të pavarur pa shkronja të partive politike, por organ kompetent i konsoliduar nga Kuvendi i Kosovës për të bërë auditimin dhe të gjeturat duke hequr ngjyrimet politike, krejt si preventiv që çdo buxhet të menaxhohet dhe të shpenzohet atë ku e ka vendin që është përcaktuar me norma ligjore. Që në fillim të këtij raporti drejtori i DBF si autoritet, me plot gojë e thotë që nuk kemi humbje asnjë cent, por çka ka ndodhur me këtë raport që e kemi të kualifikuar pra, kemi pasur keq menaxhim, keq planifikim dhe lind pyetja nëse të gjitha këto janë keq, a mund të quhet diçka e mirë këtu. Pastaj më bëri përshtypje dhe po e marr me sportivitet fjalinë e një kolegu këtu që e theksoi që vërtetë me gjuhën e sportit të folësh për kualifikime është mirë sepse është mirë të kualifikohem ama në aspektin sportiv, mirëpo kur të fillosh të flasësh me gjuhën e sportit ndoshta nuk është keq me fol edhe me gjuhën shnetës/shëndetit dhe kur e them me gjuhën e shnetes, nëse e bënë një testim për një sëmundje dhe aty të rezulton pozitiv dhe i kualifikuar duhet të trajtohet urgjent sepse puna është keq dhe tani po largohem nga kjo gjuhë dhe po dal te gjuha e atyre që ne i kemi marr votat dhe qytetarët e

theksojnë që kujdes punës “telhyqe” sepse puna në asgjë dëmi është i gatshëm dhe në këtë formë krenjt më e lehta që mund të themi është që drejtori i DBF e potencoj për punë në asgjë e kemi këtë kualifikim por dëmi nuk kemi. Nëse ndokush mendon që asnjëherë autoritet për ndarje buxhetore është ky Kuvendi i Komunës dhe kur anashkalohet ky Kuvend dhe mund të arsyetohet që nuk ka bërë shkelje, kjo vetëm arsyetim nuk mund të jetë sepse e kemi thënë disa herë që pronar gjegjësisht miratues i buxhetit është Kuvendi i Komunës dhe ekzekutues është Ekzekutivi i Komunës, kurse në këtë raport kemi të gjetura që Kuvendi nuk është pyetur fare, pa dashur të hyjmë te kontratat pa zotim të mjeteve dhe kontratat pa projekte sepse u folën shumë dhe nuk dëshiroj që të flas edhe unë dhe t’i përsërisë edhe njëherë që na është dhënë vërejtje që puna në asgjë dëmi është i gatshëm, dhe punët në asgjë këtu vetëm janë duke u trashur.

z.Ragip Fetahu, theksoi, pasi **ishte** tema e thënieve, një profesor i imi në vazhdimësi e cek, që sikur se ne do t’i përdornim poezitë ndër hije të lisit rreth malit dhe ka po shkon moj zanë me të njëjtën mënyrë se si janë artikuluar për t’i kthyer ato në zhvillim ekonomik, ne do të ishim tigër global në ekonomi.

Çështja e cila po shtrohet këtu është çështje që duhet të trajtohet, kemi një raport të tillë ashtu siç është dhe nuk mund të ndryshohet, mirëpo ajo që dua të theksoj është se duhet të kemi kujdes me fjalën publike, “korrupsion 30%” që po e cek kolegu, duhet të kesh shumë kujdes sepse fjala publike është fjalë me përgjegjësi sepse mund të filloj hetimet prokuroria direkt dhe duhet të nxirren argumentet pastaj se ku është ai 30%.

Sa i përket projekteve të cilat janë bërë gjatë kësaj periudhe ku Auditori i ka gjetur edhe të shkelurat e që unë mendoj dhe më tepër e shoh një vullnet dhe një nguti të njerëzve të cilët po merren me këto çështje për t’i kryer ato projekte sa më shpejt për interes të përgjithshëm dhe më shumë është shkelje teknike se sa problematik apo çështje që është bërë qëllimshëm.

Raportin e Auditorit e kam lexuar me kujdes dhe nuk kam parë të gjetur e cila implikon direkt përfitime financiare të një individi apo të një grupi nga të hyrat publike, pra që është një përparësi, dhe raportin të cilin ne e kemi është i kualifikuar dhe unë mendoj që duhet t’i jepet një vërejtje se pse po zhvillohen punime pa pasur projekt dhe që duhet të pasur kujdes në të ardhmen ku është një nga pikat që të përmirësohen në të ardhmen, përndryshe të gjitha ato vërejtje të Auditorit mund të gjinden në Komuna dhe në secilin vend ku punohet. Përkundër kësaj ne shohim zhvillim shumë pozitiv në Komunën tonë dhe shohim shumë projekte duke u punuar dhe shumë çështje të cilat janë në interes publik që janë duke u bërë e që nuk janë bërë asnjëherë dhe këto projekte duhet të përshëndeten, duke punuar natyrisht që mund të ketë çështje të cilat mund të tejkalojnë rregullativën ligjore, mirëpo mendoj që kjo punë e cila është duke u bërë tani nga Ekzekutivi i Komunës është për tu vlerësuar dhe admiruar.

Edhe njëherë po e potencoj se fjala publike ka shumë peshë dhe duhet të kemi kujdes se çka themi dhe atë që e themi duhet të kemi fakte dhe argumente sepse të thuash që ka 30% korrupsion në projekte duhet të kesh fakte dhe argumente për këtë, unë nuk jam prokuror dhe as jurist mirëpo mendoj se qysh tani prokuroria e shtetit duhet të filloj me intervistimin e pretendentëve se ku janë faktet dhe argumentet për atë çështje.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, kolegu i nderuar po tregohet super servil dhe po del shumë qesharak e që i kisha preferuar të mos dal më në foltore. Sa i përket fjalës korrupsion dhe 30%, unë e ftoj prokurorin nga këtu që të nis hetimet, nëse edhe unë jam pjesë mundem të bashkëpunoj për cilëndo kontratë të Komunës së Podujevës. E di se çka është fjala publike dhe e di po e rëndësishme është, pra edhe njëherë e ftoi prokurorinë që të filloj hetimet që nga ky koment për të gjitha të gjeturat që unë i përmenda.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, është një çështje që u përmend sam i përket raportit në krahasim me vitet e kaluara se a kanë qenë raportet e auditimit të kualifikuara apo të pa kualifikuara. Është e vërtetë se që nga viti 2020 Zyra Kombëtare e Auditimit çështjet të cilat kanë të bëjnë me keq klasifikime dhe regjistrim të pasurive i ka kualifikuar ato raporte, ndërsa para vitit 2020 çështjet të cilat kanë pas të bëjnë me keq klasifikime vetëm janë cilësuar nga auditori si raport me theksim çështje dhe i ka pasur të gjetura të cilat janë realizuar gjatë procesit të auditimit.

E vërteta është që Komuna e Podujevës këtë vit i ka 13 të gjetura, ndërsa vitet e kaluara ka pasur raport me 15-16 të gjetura varësisht se siç është çështja, por një e vërtetë tjetër që vlen për sot dhe gjithmonë është se kur bëhet një auditim i një organizate buxhetore që ka buxhet mbi 30 milion euro dhe që zhvillon e që ka aktivitete, prokurim dhe projekte të shumta pra që ka realizim të shumë transaksioneve financiare dhe që ndan shumë subvencione që lidhen shumë me çështjet ligjore, gjithmonë ekziston mundësia që ka të gjetura që mund të jenë të natyrës teknike apo administrative, pra këto janë të gjeturat të cilat i thotë ky raport i Zyrës Kombëtare të Auditimit i cili jep të gjeturat që janë 13 dhe po e përsërisë se asnjëra nuk ka të bëjë me asnjë euro të humbur buxhetore mbi bazën e asaj të cilën e thotë Zyra Kombëtare e Auditimit në këtë rast në këtë raport. Sot këtë diskutim e kemi lidhur me këtë raport të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për këto të gjetura, jo për çështjet tjera që njerëzit mund t'i diskutojnë “jo kjo kontratë u krye, punët apo ky asfalt nuk është kështu” pra ajo është një çështje tjetër, pastaj jemi duke folur për raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit që e thotë këtë çështje.

U thanë të gjitha sepse këtu janë 13 të gjetura, tash themi që zyra Kombëtare e Auditimit i ka audituar në bazë të mostrave 300 çështje kushtimisht e them, sepse i ka kërkuar dhe ne normalisht i autorizojmë zyrtarët dhe ata e kanë kompetencë që çdo zyrtari t'i kërkohej dokumentacioni përkatës dhe ata janë të obliguar t'ia dërgojnë Zyrës Kombëtare të Auditimit që vijnë dhe qëndrojnë këtu 1 muaj, pra i ka gjetur vetëm 13 të gjetura dhe ata nuk e theksojnë atë që nuk e ka gjetur, pra nuk i thotë anët pozitive përjashtimisht kësaj postulatës së përgjithshme që e cekta në fillim që pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të Komunës së Podujevës, pjesën tjetër i raporton vetëm të gjeturat dhe jo ato që nuk i ka gjetur. Në qoftë se i trajtojmë një nga një ato që i ka thënë Zyra Kombëtare e Auditimit të gjithë ato i theksoat edhe ju. Përdorimi i gabuar kontratës publike kornizë, edhe tani ne kemi kontratë publike kornizë të cilat kanë të bëjnë shembull, me renovim të institucioneve shëndetësore dhe atyre arsimore, pra ato janë kontrata të punës, mirëpo shumë është e përshtatshme që të kemi kontrata publike kornizë, shembull kontrata për rregullimin e kulmeve, edhe në këtë vit e kemi pra domosdo ne duhet të kemi kontratë publike për rregullimin e kulmeve edhe pse është aktivitet pune, mirëpo duhet të kemi sepse përgjatë vitit gjithmonë duhet të ketë renovime dhe intervenime në kulme, pastaj kontratën për gëlqerosjen e institucioneve arsimore që janë kontrata kornizë sepse nuk ka mundësi ndryshe dhe është mënyra më e përshtatshme që të ketë intervenime për rregullimin e infrastrukturës arsimore dhe asaj shëndetësore me kontratë kornizë. Zyra Kombëtare e Auditimit e ka dhënë por është e pa mundshme të veprohet ndryshe përveç se me kontrata kornizë siç është rregullimi i njejeve sanitare ose çështjet tjera. Sa i përket tejkalimit të sasive të kontratës kornizë këtu bëhet fjalë për një kontratë 3 vjeçare për furnizim me barna e reagenca e cila i ka dhjetëra pozicione, ku bëhet fjalë për disa materiale që janë të imta (vogla) por janë të domosdoshme për furnizim me barna, shembull nëse nuk gaboje “shiringa” kanë qenë të planifikuara kaq sasi për gjatë 3 viteve dhe u tejkaluar ai 30%, që bëhet fjalë për disa artikuj që çmimi i tyre është 10-20 cent mirëpo ka qenë nevojë e domosdoshme dhe nuk ka qenë interes i askujt që të porositet ajo sasi më shumë, pra është e vështirë për QKMF-në ajo edhe pse kontrata publike kornizë është për këtë arsye sepse kur

bëhet fjalë për disa materiale të imta ndoshta saktësisht të dihet shpenzimi i asaj dhe ka pasur një tejkalim dhe është material shpenzues të cilin e kanë pranuar menaxherët e kontratës ku është porositur nga ana e QKMF-së, pranua nga menaxheret e kontratave gjithashtu edhe nga ana e komisionit dhe është bërë pagesa, pra nuk ka të bëjë me çështje tjera.

Inicimi i projekteve pa zotim të mjeteve, u përmendën disa çështje, ne i cekëm edhe te kontrata kornizë edhe inspektimet, shembull kur fillon kontrata për hartimin e projekteve zakonisht ajo kontratë është lidhë shembull në muajin qershor apo korrik dhe për të përfunduar një projekt hartimi i projektit zgjatë shumë më shumë dhe në qoftë se kontrata për hartimin e projekteve është 140,000.00 €, ne e kemi pas një shpenzim brenda vitit 2023 më pak se 30,000.00 € do të thotë 26,000.00 € nëse nuk gaboje, pra vetëm një vlerë e kësaj kontrate që shpenzohet dhe nuk mund të zotosh mjetet 140,000.00 € sepse aty është një bllokim i mjeteve financiare dhe rrjedhimisht nuk kryhen pagesa sepse nuk është përfunduar puna.

Te pasuritë dhe te përdorimi i pasurive në kode të gabuara që ka të bëjë me pasuritë në vijim dhe pasuritë në përdorim, kjo është ndikim edhe prej viteve të kaluara për një arsyeje se një pasuri që është regjistruar para dy apo tri viteve me një kod të gabuar dhe tani është e pamundshme të përmirësohet dhe ajo vazhdon që të rrjedh derisa të del në pasuri në përdorim dhe vetëm koha mund të përmirësojë për arsyeje së në mënyrë teknike kështu nuk mund që të ketë ndërhyrje që të përmirësohet kjo çështje që ka të bëjë me pasuritë. Procedimi te hapat e pagesave, gabim në hapa të pagesave, është një çështje e caktuar dhe është e vërtetë që rregullorja thotë që më së pari që duhet të ketë zotim të mjeteve financiare pastaj të vije malli dhe të bëhet pranim i shpenzimeve dhe certifikimi, mirëpo siç e kam cekë në raport pra në plan të veprimit në shumë raste është e pamundur të praktikohet kjo, arsyeja është, shembull ne paguajmë edhe për shërbimet e materialeve të fotokopjuesve dhe nuk mund ta dim ne saktë para fillimit të muajit sa materiale do të fotokopjohen, por fotokopjohen ato dhe në bazë të raporteve e bëjmë zotimin dhe pagesat, apo rasti tjetër është furnizim i automjeteve me naftë e që nuk mundem paraprakisht t'i zotojmë mjetet buxhetore e pastaj të shkoj automjeti të mbushet me naftë e pastaj të bëhet pagesa, pra nuk mund të dim saktësisht një automjet sa do të mbushet naftë, pra në kuptimin teknik është e pamundshme edhe përkundër asaj që e thotë rregullorja.

Vonesa në kryerjen e obligimeve, Auditori e ka shumë të lehtë përkundër që ai vepron me mostra dhe komplet e ka raportin për ditën kur janë protokolluar pagesat dhe për vonesën e atyre pagesave, janë mbi 2000 pagesa dhe ka prej tyre që janë vonuar ku disa prej tyre janë për arsyeje specifike, pra për arsyeje se nuk ka pasur planifikim të buxhetit ngase tani është bërë edhe planifikimi mujor i shpenzimeve, pra ka mundur të vije fatura në muajin prill e që nuk ka mundur të ketë planifikim për muajin prill dhe është vazhduar si dhe kryesisht kanë mbetur disa mbetje të kontratave ku ka qenë kontrata 80,000.00 € dhe janë paguar 70,000.00 € kurse shumica e mbetur nuk është paguar për një periudhë dhe normalisht është diçka të cilën Zyra Kombëtare e Auditimit e paraqet si vonesë, mirëpo janë arsyet e caktuara dhe nuk ka të bëjë asgjë me ato që u theksuan nga disa parafolës.

Te llogarit e arkëtueshme, për të sqaruar edhe për opinionin publik llogaritë e arkëtueshme janë detyrime të cilat qytetarët i kanë ndaj Komunës së Podujevës, ato detyrime rrjedhin si detyrime për tatimin në pronë, për qira, si dhe detyrime për çështje të tjera, por kryesisht janë të tatimit në pronë dhe te qiratë. Te tatimi pronë Komuna e Podujevës në vitin e kaluar ka pasur afër 3,000,000.00 € detyrime të cilat qytetarët i kanë pas ndaj Komunës, tani është diçka mbi 2,000,000.00 € dhe përkundër që i kemi rritur, të hyrat janë zvogëluar nga llogarit e arkëtueshme sërish dhe ka qenë e pamundshme që të gjitha detyrimet të cilat janë rrjedhojë e shumë viteve të mëparshme e që mund të themi se ka qytetarë që nuk ka paguar tatim asnjëherë pas luftës dhe tash është problematikë që

të trajtohen edhe me Gjykatë këto çështje sepse janë detyrime të cilat kanë mundësi të parashkruhen edhe nëse i dërgojmë në Gjykatë mund të humbet si lëndë, por po e them është çështje specifike, edhe për kundër që kemi pasur rritje të të hyrave prapë mbetet një numër i konsiderueshëm i llogarive të arkëtueshme si një vlerë financiare.

Te pagesa që ka të bëjë me ndërtimin e Qendrës Rezidenciale, ne kemi paguar avancë për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale dhe është avancë i bazuar në rregulloren financiare ku ne kemi pas të drejtë në muajin dhjetor të ekzekutojmë deri në 5% të vlerës së kontratës, pra kemi pasur dhe kemi ekzekutuar 126,500.00 €, Auditori e ka shkruar një vërejtje që pse ne nuk kemi marr sigurim për atë avancë, pra sigurimi është kredi dhe një donatori është e pamundshme t'ja kërkojë që të hyjë ai në kredi në mënyrë që t'na siguroj ai që po e përfundon projektin e që ai donator absolutisht thotë jo sepse është edhe nënvlerësim për të mendoj, sepse në njërin anë ai po i jep 2,000,000.00 € për një projekt publik, në anën tjetër për një participim që e ka të vogël si Komunë ti thuash shko ti hyrë në kredi dhe me garanto mua përmes një garancie bankare ose të sigurimit që ne të sigurohemi për ato mjete në rast se ti nuk investon ne do ta konfiskojmë garancionin pra është e pamundshme të ndodh kjo.

Çështja tjetër që ka të bëjë me menaxhimin e kontratave përmes e-prokurimit, tani menaxheri i kontratës ka kompetencat të cilat dalin nga Ligji për prokurimin publik, ku e vetmja e gjetur e Auditorit është që në raportet e cekë se planet e menaxhimit nuk janë bërë në mënyrë elektronike por e ka bërë në mënyrë fizike, çështje e cila ka ndodh për arsyeje teknike dhe procedurale.

Po e përsërisë se atë që e thotë Zyra Kombëtare e Auditimit për kundër këtyre 13 të gjeturave nuk është asnjë e gjetur e cila ka dëmtim dhe dëm financiar për Komunën e Podujevës qoftë edhe 1 €.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, të nderuar koleg, dy çështje u përmenden të cilat më nxitën të marr fjalën pa dashje dhe pa dëshirë. E para ka të bëjë me akuzën e drejtpërdrejtë që mu bë mua dhe kolegëve të mi, ndërsa e dyta fyerjet të cilat u bënë këtu gjithashtu për mu dhe kolegët. Sa i përket çështjes së parë pra akuzave të bëra, unë mund të pranoj çdo kritikë e cila është profesionale dhe ka të bëjë me çdo projekt dhe punë ku unë jam njësi kërkuese dhe pjesëmarrës në implementimin e asaj pune, por assesi nuk mund të pranoj një akuzë direkte e cila bëhet këtu publikisht ku është edhe e incizuar e që përbën ose krijon një fakt ku mund të fillojnë hetime dhe procedurat hetimore, mandej kur ftohet prokurori për hetim për një rast siç u ftua këtu prej kolegëve duhet sigurisht që të ofrohen edhe faktet, ndërsa pa fakte as prokurori e as ato fjalë të kota që vinë nga dëshirat të juaja për ta ulë personalitetin e çdo njërit prej nesh nuk ka asnjë mundësi as që të fillojnë hetime dhe as inicim procedurë, i vetmi fakt këtu që u krijua dhe që e mundëson fillimin e hetimit është akuza publike e juaja zotëri Qëndrim Softolli që ju bëre drejtorëve të Drejtorive duke thënë “duke i mbushur gjepat pare e duke e keqpërdor buxhetin me 30%”, prandaj unë sigurisht që do të merrem me këtë çështje sepse nuk mu përmend emri por u tha për të gjithë neve që jemi këtu përball jush, siç e përmende në fjalim, dhe unë besoj që tani duhet të përgatitsh edhe për këto fakte dhe për këtë në prokurori sepse është një gjë që nuk mund ta pranoj nga askush, pra nga asnjëri prej juve e as prej kolegëve të mi këtu që i kam afër dhe as për kolegët e mi që bëhen këto akuza.

Sa i përket çështjes së dytë që u bë fyerje dhe ulje e personalitetit të çdo njërit prej nesh këtu, unë sërish po e them që asnjëri nuk jemi të përkryer, të gjithë kemi mungesa edhe profesionale edhe njerëzore sepse vetëm një është që nuk ka të meta që unë besoj në të dhe është Zoti, por të ketë shprehje me fjalë aq të ulëta dhe aq jo jetike siç ishte fjala “dredhana” e që kërkoj falje që e po e theksoj por duhet të argumentoj atë që jam duke e thënë, dhe fjala tjetër “budalla”, unë besoj që përveç që edhe kjo përbën një fakt ku mund të nis hetim për shkelje apo ulje të personalitetit dhe shkelje të integritetit, nuk është etike që të shprehen këto gjëra.

Më besoni që nuk isha i interesuar të flas sepse edhe unë edhe kolegët e mi këtu jemi shumë krenar me punën që e bëjmë edhe përkundër gabimeve që mund të lëshohen gjatë procesit të punës, dhe prej krejt këtyre që thuhet këtu për mua personalisht dhe për kolegët e mi, ne do të vazhdojmë punë sepse unë mendoj që nganjëherë më shumë brengë është kur dikush punon shumë e ka mundësi për tu kapur paska në diçka se sa të mos punohet fare e që besoj që asnjëri nga ju nuk do të kishe fole fare, pra sikur të mos ishte punuar shumë këtu dhe t'ju krijohet mundësia juve për të dhënë kritika dhe ndonjë vërejtje, atëherë këtu nuk do të kishim çka të diskutojmë, por e mira e kësaj është që edhe unë personalisht jam shumë i kënaqur që nga puna e madhe dalin edhe kritika nganjëherë që i pranoj secilën, por jo këto akuza që u benë këtu.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, po ndërlihem në çështjet e përmendura rreth projekteve, konkretisht rreth raportit të Auditorit për mungesë të projekteve në asfaltimin e rrugëve në qytet Loto 1, 2 dhe 3. Në Koncept projekti përbëhet nga pjesa tekstuale dhe ajo grafike dhe asnjë projekt i iniciuar vitin e kaluar nuk ka pasur mungesë të pjesës tekstuale por edhe të pjesës grafike, në esencë nuk ka prodhuar ndryshim në ekzekutimin e këtyre kontratave në teren dhe si të tilla secila kontratë por edhe këto që u përmenden këtu si asfaltimi i rrugëve në qytet të ndara në 3 Loto kanë pasur pjesën grafike por jo të kompletuar dhe si të tillë Auditori e ka marr sikurse mungesë të projekteve, gjë kjo e cila është bërë për shkak të inicimit të procedurave dhe në fazën fillestare gjatë vitit të kaluar që ka qenë mungesë kontrata e hartimit të projekteve që edhe kjo merr pastaj një procedurë derisa të lidhet kontrata, por se çfarë është e rëndësishme që të dimë është që nuk ka prodhuar ndryshim në ekzekutimin e tyre në teren, pra janë ditur sasitë duke përfshirë për secilin pozicion ku kompanitë kanë ofertuar me vlerën e tyre përkatëse.

znj.Adelina Stublla, theksoi, faleminderit për të gjithë ata që u interesuan për çështjet e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, sa i përket punës së kontratës për furnizim me barna dhe reagenca gjë të cilën e parashtruat rreth çështjes së vërejtjeve që i ka theksuar Auditori, kjo është kontratë që është planifikuar para dy viteve por meqenëse faktikisht disa pozicione janë shpenzuar atëherë për shkak të rritjes së shërbimeve shëndetësore, gjë që të cilën po e pëlqejnë qytetarët madje edhe disa familjar të juaj, atëherë kemi bërë ndërrim të pozicioneve, kurse 70% të pozicioneve nuk janë tejkaluar.

Sa i përket çështjes së Qendrës Rezidenciale siç e ceku edhe drejtori i DBF-së kjo është bërë në bazë të Marrëveshjes, ku objektin siç edhe u cek nga vet ju, është duke e nxënë në atë vend, kështu që vetëm e gëzofshim në të ardhmen e afërt.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po filloj nga drejtoresha e DSHMS, sepse drejtori i DBF-së më herët i përmendi duke thënë pozicionet përkatëse që vlejnë nga 10 cent, pra nuk është ashtu siç e tha drejtori i DBF-së sepse pozicioni 16 e thekson që sasia e realizuar është 1000 copë ndërsa sasia në kontratë 300 copë, unë nuk jam i fushës përkatëse por i kam përcjell të gjithë tenderët e DSHMS dhe asnjëherë nuk e kam përmend sepse e di që është kategori e ndjeshme dhe nuk jam marr me atë punë. Pozicioni 16 që e kam të vështirë t'ia përmend emrin sepse nuk jam i asaj fushe metirolometrinë kjo nuk kushton 10 cent por në një barnatore në Komunën e Prishtinës e kam pyetur dhe ka kushtuar 11.50 €, e jo 10 cent, dallojnë shumë këto dy shuma e që në Komunën e Podujevës këto nuk gjinden, andaj nuk e di se si mund të thuhet diçka e tillë, kur projekt menaxheri caktohet për një kontratë dhe është i fushës dhe ai shkon në trajnim dhe e din që nuk duhet të tejkalohet, madje anëtarja kolege e Kuvendit më herët shumë mirë e potencoj që nëse janë kërkuar 300 copë dhe janë marr 1000 copë kjo nënkupton që ka pasur keq klasifikim pra nuk ka ditur të kërkoj sasinë e duhur e që tani unë nuk e di as ku i ka dërguar, a i ka shitur, a i ka lënë aty apo i kanë harxhuar para kohe dhe ju kanë dashtë më shumë, pra unë nuk e di, por kontratat duhet të zbatohen, janë kërkuar 300 copë mund shkon deri 330 copë dhe duhet të ndalet, prandaj projekt

menaxheri duhet t'i thotë operatorit se nuk mund t'i kërkoj këto, andaj kjo çështje mua më fut në dyshime pse janë kërkuar ajo sasi, a vetëm që kanë qenë më të shtrenjta dhe në disa pozicione të tjera që nuk ka pasur fitim nuk janë kërkuar. Pra ai medikament nuk kushton 10 cent por kushton 11 € deri në 15 €.

Sa i përket çështjes që drejtori i DSHPMSh e tha jam i fyer, ndoshta ai nuk më ka dëgjuar mirë edhe nuk e di përse e pati "mizën pas veshi" sepse unë e thash që këtu disa njerëz që po i qesin projektet ose janë "budallë" ose janë shumë "trima", andaj përse nuk e mori atë që thash se janë shumë trima por e mori tjetrën, edhe pse nuk ishte puna për atë drejtor por ishte për raportin e Auditorit që është i kualifikuar, kurse ai e vuri në këta terma duke u kapur për fjale, mirëpo drejtori i cekur vetëm një fjalë e tha mirë kur e theksoi që nuk jemi perfekt dhe atë e di, ndoshta edhe ne përdorim fjalë që nuk duhet t'i themi por nuk ishte ajo fjalë sepse nuk i thash askujt "ti je budallë", por mënyra e trimërisë qysh e qet dhe nuk frikësohet nga shteti kalon nga trimëria në budallaki.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, faleminderit nga drejtori i DSHPMSh dhe nga ju kolege e nderuar që po më tregoni sa e rëndësishme është fjala publike. Unë uroj dhe shpresoj që seriozisht do të merret prokuroria me krejt këto që i potencova dhe jam i gatshëm për të bashkëpunuar kur do që ata e shohin të arsyeshme. E rëndësishme dhe shumë shqetësuese është minimizimi i rëndësisë së gjetjeve të Auditorit e që kjo vërtetë na lë të kuptojmë që gabimet e njëjta do të përsëriten edhe në vitet në vazhdim. Pra janë marr 300 mostra dhe janë 13 gjetje, nëse do të merreshin më shumë mostra do të kishte edhe më shumë gjetje, madje çka nëse i'u kish ra në dorë Auditorit projekti i rrugës "Skënderbeu" që sot e asaj dite nuk e dimë se a është përfunduar apo jo, janë bërë 3-4 vite dhe ende punohet aty dhe nuk e kemi të qartë se çka po ndodhë me atë projekt. Fati i njëjtë fatkeqësisht është duke e përcjell edhe rr."Xhemajl Mustafa" dhe uroj që të mos bëhet sikurse Ura e Fshejt sepse tash e sa kohë me disa trotuare duke e prerë asfaltin dhe duke e shtruar të riun e njëjta procedurë sikur të mos kishte projekt fare e që unë po dyshoj as projekt nuk ka për atë rrugë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe tek pagesat kur e përmendi drejtori i DBF-së besoj që ai e din më mirë, pagesat nga një projekt te projekti tjetër është në kundërshtim me Ligjin e financave, nuk po i ceku nenet sepse e din ti këtë punë dhe përveç kësaj është në kundërshtim me Ligjin e Buxhetit dhe nuk mund të jen aq të lehta siç po e boni ju, sepse ti e din që Ligji për Menaxhimin e Financave publike pikat 16 dhe 17 çka thonë dhe e din që është në kundërshtim me ligjin kjo punë.

znj.Adelina Stublla, theksoi, i nderuar asamblistë e ceke ampulën metirolometrinë që është ampulë kundër ndaljes së gjakderdhjeve në rastet gjinekologjike, sa i përket së pagesës së saj kjo varet nga kompania që e sjell atë, pra varion çmimi, kurse sa i përket punës së shërbimeve që e ceke punën e pozicioneve janë shtuar shërbimet ku e ceka edhe më lart, për dallim nga kohët e mëhershme që faktikisht kam qenë punëtore aty dhe e di që për tu kontrolluar një pacient u është dashtë qytetarët t'i blejnë të gjitha, për dallim që tani nuk i blejnë asnjë të vetmen, kështu që të gjitha i kryejnë në shërbimin shtëpiak me terapi tonën dhe kjo është e kushtueshme dhe ka kosto, kështu që të gjitha renditen në pozicione të caktuara.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, e nderuar drejtoresh, je duke e qitë në një kontekst tjetër dhe askush nuk po thotë që nuk janë rritur shërbimet, ti që nuk e ke kuptuar çfarë thash tani mos bë popullizëm këtu. Kontrata pra, menaxheri i kontratës nuk guxon të del nga kontrata, ke të drejtë nëse i ke porositur me kontratë 300 copë mundesh 30% të saj pra 330 ke të drejt t'i porositësh e jo 1000 copë, mua kjo më bënë të dyshoj, nuk dua që ta di ai ilaçe për çka është, i kam mundësit dhe nuk shkoj fare me marr ilaçe aty pa pare, por unë të tregova sa kushton ajo ilaçe dhe nuk mund të thuash janë rrit shërbimet dhe tani nëse ne i kemi paraparë 300 copë ilaçe t'i porositim 1000 sepse është në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit dhe nuk ki të drejtë sepse pastaj ka të drejtë prokurori

të thotë kush je ti që nëse dikush i ka paraparë 300 copë të sillesh t'i porositësh 1000 copë, përndryshe nëse nuk ka atëherë duhet të përfundohet kontrata sepse nuk guxon kështu.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, unë kolegut z.Ekrem Rrahmani i kisha propozuar që të shkoj te ajo barnatore se ku e ka marr informatën dhe ti thotë farmacistit pse më ke rrejt. Unë qe 18 vite punoj në sektorin e farmacisë por ende nuk kam takuar çmim ampule metilogrametrimin 11 €, por çmimi i saj ka shkuar 0.20 € deri 0.30 € në raste më të këqija 0.50 €.

Unë në barnatore timen këtë ilaç nuk e kam për momentin dhe është mungesë në treg, mirëpo je duke u shërbyer me disa të pavërteta të cilat ndoshta t'i ka thënë dikush tjetër, sepse para se të vish këtu të folesh është mirë që t'i kesh së paku 3 burime dhe jo vetëm nga një burim të marrësh informacion. Për 18 vite përvojë asnjëherë nuk e ka kaluar 0.50 €, për këtë ju garantoj unë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, sinqerisht e thash me shumë qetësi dhe u ndjeva shumë keq, por të mbetem borxh sepse u mundove të përsëritësh atë që the (i drejtohet z.Ekrem Rrahmanit) mirëpo nuk munde ta përsëritësh ashtu siç e potencove më parë, unë të paktën e mbajta në mend, por meqenëse ti nuk munde që ta përsëritësh ashtu siç e the po e marr si një gjë që e ke thënë pa vetëdije dhe pa paramendim dhe kjo është një gjë që falet më lehtë sepse çdo akt që bëhet pa paramendim është më e lehtë.

Ndërsa sa i përket asaj që e theksoi kolegu (z.Qëndrim Softolli) që unë shpresoj të fillojnë hetimet, po e them që unë shpresoj dhe besoj që do të fillojnë sepse në këtë seancë është përbërë fakt për iniciimin procedurave.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar z.Bahri Selimi, po ju bëjë një pyetje, a e din kur ke qenë ulur siç jemi ne këtu, e ke marr në cilësinë e sekretarit të Vetëvendosjes sikurse Blendi Fevziu me shkop në ekran duke thënë që drejtori i prokurimit ka bërë vjedhje dhe gjëra tjera, ndërsa posa ke ardhur në pushtet ti ja ke bërë atij “tortën sa një tervesë”.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, sërish po mundohem me qetësi të them këtë si me shaka, por ajo që e kam bërë unë këtë sa kam qenë asamblistë dhe si sekretar i Vetëvendosjes unë kam ngritur aktakuzë dhe nuk kam fol kot dhe as nuk kam fol nga qielli, pra unë kam ngritur aktakuzë dhe ajo aktakuzë e ka marr edhe formën e prerë ku jam përball me të edhe pasi kam ardhur këtu si drejtor. Unë nuk munde t'ju them njerëzve të kam bërë aktakuzë dhe dil nga puna sepse nuk kam të drejtë, mirëpo aktakuza ka vazhduar edhe në kohën kur ai ka qenë vartës i imi i drejtpërdrejtë, pra aktakuza ka vazhduar deri në formën e prerë, këtë dua të them sepse kur ki fakte edhe e bënë e unë kam pas fakte sepse ka pasur video incizim dhe fakt më të madh nuk ka, prandaj kam pas fakte dhe kam iniciuar dhe bërë kallëzim penal dhe jam marr me atë lëndë derisa ka përfunduar por nuk kam mund ta shkarkoj sepse nuk është e drejtë e imja ajo, andaj mos u mundo që ta banalizosh këtë çështje i nderuar anëtar i Kuvendit sepse ekziston si lëndë e gjithë procedura që ka rrjedh dhe të gjitha mund t'i shohësh verifikosh.

Pra ti (i drejtohet z.Ekrem Rrahmanit) po thua se kur kam ardhur unë është dashtë t'i them ati zyrtari “dil nga puna”, nuk e kam atë drejt.

z.Naim Çunaku, theksoi, në kuptimin që po e shoh u ngritën disa shqetësime, jo kjo bie pjesë për prokurorin e hetuesin dhe po dua që të tregoj diçka në bazë të cilit funksionon Kuvendi i Komunës, pra po dua të flas atë që përcakton detyrat e një kuvendari gjegjësisht një anëtar i Kuvendit dhe në këtë rast Ekzekutivit. Gjithë fjalët që këtu thuhet dhe ngritën dyshime e që secili ka të drejtë të ngrisë si shqetësime nuk përbëjnë lëndë për trajtim të hetuesisë sepse fundja kjo është liria e asamblistit, pra kam imunitet për deklarimet e mia këtu në Kuvend të Komunës, nuk jam duke fol për Kuvendin e Kosovës por isha duke folur për anëtarët e Kuvendit të Komunës së Podujevë dhe Kuvendet e Komunave në gjithë Kosovën. Në bazë të ligjit unë e kam të drejtën të ngrisë dyshime dhe kam të drejtë që të thirri për hetuesi sepse hetuesia nuk paraqet diçka dënim por paraqet

hetuesi, mirëpo krejt çka pajtoj me drejtorin z.Bahri Selimi, me Kryesuesin e Kuvendit si dhe gjithë anëtarët tjerë është vërtetë mirë që të kemi kujdes gjuhën që e përdorim ndaj njëri tjetrit sepse fundja në rend të parë duhet të ruajmë njerëzoren, pra me këtë pajtoj, por në kuptimin e shqetësimit se çfarë u potencua, për këtë rri i lirshëm dhe mos harxho kohë sepse ka imunitet në deklaram.

z.Valon Demolli, theksoi, dëshiroj që të ndërlihem pak me drejtorin e DSHPMSH sa i përket ish drejtorit të prokurimit që ka qenë z.Rasim Fejza, ju sa keni qenë në opozitë e keni quajtur “tuxhar të tenderëve”, pastaj kur erdhët në pushtet nuk keni mund të funksiononi pa të, përveç kësaj i keni bërë kallëzim penal dhe tani keni vrapuar nëpër gjykata për t’ia ndal atë, prandaj tani nuk po di a ka qenë ai “tuxhar i tenderëve” apo ky shoferi i trotinetit që e keni sjell tani në atë pozitë, pse nuk po e quani “tuxhari i tenderëve” tani pra keni sjell shofer kurse në atë kohë e keni akuzuar njëriun si “tuxhar të tenderëve”

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, krejt atë që e kam thënë unë e ke publike dhe kam iniciuar kallëzim penal dhe jam marr me procedura, jemi ardhur këtu dhe nuk e kemi amnistua, nuk është e vërtetë që e kemi amnistua, unë vetëm kam qenë në seancë i ftuar për atë lëndë dhe e di se çka kam folur dhe janë shkrimet se çka kam thënë, askush nuk e ka amnistua, pra është marr me lëndën deri sa është përfunduar. A është dal apo jo në pension, i ka mbushur vitet dhe ka ecë.

E ritheksoj se askush nuk e ka amnistuar atë person dhe askush nuk ka thënë që është burrë i mirë ose i keq, ato që i kam thënë për të janë në Gjykatë dhe asnjë nuk është mohuar apo pohuar, të gjitha janë siç kam thënë dhe kam vazhduar deri në momentin e fundit.

Kur kam ardhur këtu në qeverisje të Komunës, e kam gjetur dhe ka qenë vartës i Drejtorisë së Administratës që unë kam qenë drejtor dhe jam marr me të direkt dhe i kam vazhduar procedurat deri në fund, tani sikurse që kolegu parafolës që më tha a e ke larguar nga puna apo jo, unë këtë të drejtë nuk e kam dhe askush tjetër sepse është zyrtar civil që nuk mund ta largon askush pa nxjerr Gjykata vendimin për shkarkim ose jo. Pra nuk e ka amnistuar askush dhe nuk është e vërtetë, ai e ka vazhduar punën ku njëherë është shkarkuar nga detyra dhe është bërë ndërrimi i pozicionit të tij dhe pastaj sërish është kthyer dhe ka shkuar në pension, por mos te marrim për goje tani njëriun që ka dal në pension, unë po besoj që janë mbyllë ato procedura edhe pse nuk e di saktë a kanë përfunduar mirë por kam dëgjuar që është mbyll si procedurë, përfundimin e asaj pune nuk e kam parë, prandaj janë të pavërteta ato që i the i nderuar zotëri Demolli, asnjë nuk janë të vërteta.

z.Valon Demolli, theksoi, i nderuar z.Bahri Selimi, nëse ka qenë “tuxhar i tenderëve” përse e keni lejuar ta ushtroj detyrën e shefit të prokurimit sërish. Përveç kësaj dua të dijë se a është “tuxhar i tenderëve” edhe ky shoferi i trotinetit që e keni sjellë tani, sepse atë e keni quajtur si “tuxhar të tenderëve” kurse pyes ky tani a është i njëjti dhe dua që ta dëgjoj nga ju.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet edhe për këtë pikë të rendit të ditës përfunduan, andaj edhe e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

9. Propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit nr.prot.01-016/01-0045377/23 për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, në thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje keni pranuar edhe propozim vendimin për shfuqizimin e vendimit me numër të protokollit 01-016/01-0045377/23 të datës 03.07.2023 për miratimin e planit të integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës.

Shfuqizimi i këtij vendimi duhet të bëhet për arsye se ka hyrë në fuqi Ligji nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku në bazë të tij parashihet edhe metodologjia e hartimit të planeve të integritetit. Nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kemi marrë udhëzime për shfuqizimin e vendimit për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës, shfuqizimi i vendimit bëhet në kuptim të zbatimit të nenit 25 të Ligji nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe Vendimit nr.1476/2023, të datës 26.07.2023, për miratimin e metodologjisë për Planet e Integritetit në bazë të cilave miratimi i Planit të Integritetit është në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë të Ekzekutivit të Komunës, andaj nga ana juaj kërkohet miratimi i këtij vendimi, dhe pastaj Ekzekutivi i Komunës së Podujevës do të hartoj planin e integritetit në përputhje me nenin 25 të Ligji nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit si dhe metodologjinë për hartimin e planeve të integritetit.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë nëse ne kemi pas një plan që ka hasë në kundërshtim me ligjin fundja edhe ashtu është zero sepse nuk mund të prodhoj efekte kur një instancë më e lartë këtë e rregullon ndryshe, mirëpo kam një pyetje për drejtorin në fjalë, kur e kemi miratuar ne këtë Plan të Integritetit a ka qenë në fuqi ligji i cili sot e cilëson si kompetencë të veten e jo si kompetencë të Komunës, të organeve komunale. Nga ajo që dëgjova prej drejtorit parafolës në fjalën hyrëse dhe sa kuptova, pata hamendjen që pavarësisht a ekziston ligji apo jo Komuna duhet ta ketë Planin e vet të Integritetit, mirëpo drejtori e tha që ne do ta bëjmë një Plan të Integritetit tani në harmoni me ligjin në fuqi. Nëse e kam kuptuar drejtë i nderuar drejtor do të thotë ky Plan që ne e kemi miratuar tash është në kundërshtim edhe me kompetencat dhe me përmbajtjen e ligjit përkatës që tani është në fuqi, nëse është kështu atëherë e përkrahim.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, i përcjell datat me vëmendje i nderuari asamblistë, është miratuar më datë 03.07.2023, ndërkohë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me udhëzimet konkrete të datës 26.07.2024 tanimë ka udhëzuar që të rishikohen këto Plane dhe të hartohen e miratohen në harmoni me udhëzuesin e ri që ka dalë tash së fundmi. A mund të bëhet një Plan i tillë pa u bazuar dikund, mirëpo sigurisht ka pas ndryshime dhe kanë dashtë ta bëjnë një Plan më unike që është në nivel Kosove dhe ky ka qenë si sugjerim.

z.Naim Çunaku, theksoi, atëherë del se si rezultat i ndryshimit të Ligjit duhet të ndryshoj edhe Plani, jemi në rregull po.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, edhe ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë propozim për shfuqizimin e këtij Plani. Realisht po dal diçka jashtë temës por dua ta bëj një reagim në fillim nga LDK-ja, thanë që s'po e mbajmë seancën, ku janë asamblistët tani, veç pesë veta jeni.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ky është propozim vendim që duhet të shfuqizohet vendimi i mëparshëm, prandaj e vë në votim këtë propozim, sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 20 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, (të tjerët prezent nuk votuan), miratohet propozim vendimi për shfuqizimin e vendimit nr.prot.01-016/01-0045377/23 për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2027 në Komunën e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

10. Propozim vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, DPUMM propozon hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe mirëqenies së qytetarëve në zonën përkatëse. Prezenca e stacionit hekurudhor më pastaj parkut të qytetit, pjesës së rrugës kryesore që lidhë Zonën Industriale si dhe zhvillimi jo adekuat për gjatë 20 viteve të fundit ka prodhuar që kjo zonë të mos zhvillohet në ritmin aktual urbanistik dhe si të tillë ne si Drejtori propozojmë që të hartohet një PRRH për të përcaktuar më detajisht zhvillimin e kësaj zone. Sipërfaqja për të cilën do të hartohet PRRH do të jetë 323631 m², zona në fjalë në pjesën veriore përshkruhet prej rr."Ilir Konushefci", në pjesën perëndimore prej rr."Salih Çitaku", kurse pjesa jugore është rr."Bedri Bajrami" dhe pjesa e parkut të qytetit, kjo zonë ka koeficientin 2.5 dhe si e tillë lejohet ndërtimi prej sipërfaqes 15 ari apo 1500 m². Andaj ne si DPUMM propozojmë që për këtë zonë të hartojmë një PRRH për të përcaktuar më saktësisht kahet e zhvillimit urbanistik.

z.Ardi Hasani, theksoi, në emër të këshilltarëve të LVV-së e mbështesim propozim vendimin për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1, në rr. "Salih Çitaku".

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, një gjysmë pyetje për drejtorin e DPUMM, po kemi problem ne kur po e dërgoni materialin se është një lloj fotografie e zezë dhe nuk dallohet se ku është ajo zonë.

A po ju vie zor të na sjellëni materialin këtu që ta dim në ekran dhe të shpjegoni pjesët përkatëse që të dim se për pjesët dhe zonën përkatëse që bëhet fjalë. E them këtë sepse kot thoni rr."Ilir Konushefci".... sepse unë mendoj që 70% të qytetarëve nuk e dinë as ku është rr."Ilir Konushefci", e as rr. "Salih Çitaku", ne që dalim çdo ditë i dimë sepse po i shohim por duhet me qenë më korrekt dhe të sqaroni në ekran këto çështje, madje edhe me shkop të prekni zonat sikurse z.Blendi Fevziu dhe të na tregoni pjesët prej ku deri ku e të ngjashme.

Kot e shkruan blloku 1 lindje, veri, apo perëndim, sepse unë e besoj edhe të tjerët nuk e din ku është blloku 1, në fakt ndoshta unë e di për cilën pjesë bëhet fjalë por kot e thotë ky këtë se as 10% e qytetarëve se marrin vesh ku është blloku 1.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë atë që e tha parafolësi kish qenë mirë që ta kemi të paktën në monitor se cila pjesë saktësisht bëhet fjalë, çka parashihet, si është situata dhe çka mendohet për atë në mënyrë që ta kemi saktë një pasqyrë për çka jemi duke diskutuar, për çka jemi këtu për vendimmarrje. Diçka që nuk mirëkuptoj e besoj është kur drejtori si organ kompetent dëshiron të na sqaroj brenda mundësive të tij, pra kur themi propozim vendimin për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1, a do të thotë që ne po marrim vendim vetëm për iniciimin e procedurave dhe pas një kohe pasi që t'i kalon fazat e dëgjimit publik me grupet e interesit publik do ta ketë një plan final dhe ai plan final do të vij në Kuvend për miratim, nga kjo unë kuptoj kështu, nëse është kështu atëherë s'kemi si ta kundërshtojmë një diçka që po pretendohet të bëhet në të mirën e qytetarëve, mirëpo nga materiali që unë pash, disa konstatime mu duken që me kurrfarë vendimin ne nuk mund të hyjmë në ato detaje që ishin të përcaktuara këtu, në veçanti kur bisedohet për forma të parcelave sepse fundja format e parcelave të çrregullta ose të rregullta janë ashtu siç janë dhe krejt ato mund të rregullohen me një vendim nëse e shpallim në interes ose në bazë të debatit që organizon Komuna si lehtësues i atyre banorëve për një projekt që sigurisht pjesa dërmuese do ta mbështetnin dhe sigurisht që do të lehtësonte shumë banimin dhe do të ofronte kushte të lëvizjes dhe ofrimit të

shërbimeve. Nëse është në këtë vazhde atëherë jemi në rregull, sepse kur lexoj ligjin kuptohet që qëllimi është ky ndërsa te arsyetimi vërtetë lënë shumë për të dëshiruar, kështu që edhe njëherë po kthehem prej fillimi, nëse kërkohet një vendim i Kuvendit vetëm për inicim të procedurave dhe t'i kalon pastaj fazat tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi qoftë ligjit për ndërtim qoftë ligjit për posedim ngase ato prona janë në posedim të dikujt, atëherë nuk shohë diçka të keqe që të procedohet tutje.

z.Haki Rudari, theksoi, pra kemi një propozim vendim për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1, por në të njëjtën kohë neni 2 në këtë propozim thekson se Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave urbane apo zonave rurale që është përcaktuar në Planin Zhvillimor të Komunës, pra krejt kjo sigurisht që është në koordinim me Planin Zhvillimor Komunal 2016-2025, si dhe me Hartën Zonale të Komunës 2022-2030.

Si përfundim pra kemi të bëjmë me një propozim vendim që në të ardhmen sigurisht që është në interes të asaj pjese të qytetit.

z.Leutrim Krasniqi, theksoi, sa i përket prezantimit të pozicionit të hapësirës për të cilën do të hartohet Plani Rregullues i Hollësishëm ashtu siç e përcakton edhe ligji ne kemi dërguar materialin tek ju por se ndoshta në monitor për shkaqe të caktuara nuk është shfaq.

Rreth procedurave të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm është Udhëzimi Administrativ që e përcakton prej fillimit deri në fund cilat procedura duhet të ndiqen, në këtë hap është hapi fillestar në të cilin jepet drita e gjelbër nga Kuvendi i Komunës ose ndonjë vendim tjetër për të vazhduar procedurat më tutje. Kurse pas përfundimit të diskutimit publik përsëri Plani Rregullues i Hollësishëm sjellët në Kuvend për shqyrtim përfundimtar.

Sa i përket çështjes së parcelave është e vërtetë që parcelat brenda kësaj zone nuk kanë ndonjë organizim adekuate dhe si të tillë ne do ta prezantojmë brenda planit këtë gjë me formë tjetër të bonuseve ose formë tjetër të organizimit të brendshëm nga lirimi i parcelës për rrugë dhe si të tillë do ta keni në fazën e shqyrtimit që do të vije në Kuvend në fazën përfundimtare.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse nuk ka atëherë e vë në votim propozim vendimi për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 23 anëtar/e të Kuvendit sa i shih present në sallë, me 17 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet propozim vendimi për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - blloku 1, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Nga anëtarët/et e Kuvendit të Komunës, mbështetet propozimi për pauzë 20 minuta, dhe atë duke filluar nga ora 15;10

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 15:40.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi kuorumin ku prezent për momentin janë 19 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me mbledhjen aty ku mbetëm me radhë në pikën e rendit të ditës.

11. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-163-0, ZK Siboc i Epërm

11.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim tani e tutje nga kjo pikë e deri në pikën e 20 janë të gjitha propozim vendime për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim, duke përfshirë edhe nënpikat për formimin e komisioneve përkatëse për secilin propozim që miratohet, kështu që nëse jeni të pajtimit unë do të propozoja që drejtorit të Drejtorisë përkatëse t'ia japim fjalën hyrëse për të gjitha këto e pastaj të kalojmë në shqyrtim për secilën veç e veç duke propozuar edhe anëtarët e komisioneve përkatëse.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, duke paraqitur fjalën hyrëse, theksoi, siç e ceku edhe Kryesuesi i Kuvendit nga pika 11 deri në pikën 20 janë propozime për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim si dhe propozimet për formimin e komisioneve përkatëse, besoj se materialet përkatëse i keni marrë me kohë dhe i keni analizuar, andaj ju ftoj për shqyrtimin e tyre e pastaj miratimin sipas materialeve përkatëse dhe propozimeve të anëtarëve të komisioneve përkatëse që do të jepen.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra drejtori parafolës paraqiti fjalën hyrëse për pikat e rendit të ditës nga 11 deri në 20 sipas asaj që u dakorduar paraprakisht, tani mbetet që të shqyrtohen nga ana e Kuvendit dhe njëkohësisht të jepen propozimet e anëtarëve të komisioneve përkatëse.

Pra votohet për pikën / propozimin përkatës veç e veç dhe njëkohësisht edhe për komisionin e propozuar, kështu që besoj se jemi të qartë tani.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim propozim vendimin për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-163-0, ZK Siboc i Epërm.

Për komisionin përkatës për këtë pikë të rendit të ditës e propozojmë Qëndresë Hajrizin.

z.Valon Demolli, theksoi, edhe Grupi i LDK-së e përkrah këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisionin përkatës propozon Ekrem Rrahmanin i cili vie edhe nga ky lokalitet.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga radhët e Ekzekutivit të Komunës në komisionin përkatës propozohet Shuajb Blakçori dhe Adelina Stublla, kurse nga Shoqëri Civile apo sektori jo qeveritar lokal kemi dy aplikant që janë lajmëruar për të qenë pjesë e këtyre komisioneve të cilët natyrisht se duhet t'i caktojmë në këto komisione, andaj për këtë komision propozoj Fatmir Halimin.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 19 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-163-0, ZK Siboc i Epërm, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

*znj.Oëndresa Hajrizi, nga Kuvendi i Komunës
z.Ekrem Rrahmani, nga Kuvendi i Komunës
z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës
znj.Adelinë Stublla, nga Ekzekutivi i Komunës
z.Fatmir Halimi, nga sektori joqeveritar lokal*

12. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-297-0, ZK Dobratin

12.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim dhe për anëtar të komisionit përkatës propozojmë Bahri Blakçorin,

z.Valon Demolli, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrah këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtare në komisionin përkatës propozon Edona Shabanin.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Alban Zeka dhe Vlora Humolli Jashanica, kurse nga Shoqëria civile propozohet Englantin Restelica.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 19 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-297-0, ZK Dobratin, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

*z.Bahri Blakçori, nga Kuvendi i Komunës
znj.Edona Shabani, nga Kuvendi i Komunës
z.Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës
znj.Vlora Humolli Jashanica, nga Ekzekutivi i Komunës
z.Englantin Restelica, nga sektori joqeveritar lokal*

13. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-1, ZK Dobratin

13.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

z.Kasib Bashota, theksoi, Grupi i LVV-së e përkrah këtë propozim vendim dhe anëtar në komision përkatës propozon Ardi Hasanin.

z.Valon Demolli, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrah këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisionin përkatës propozon Ilir Kopranin.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozojmë Bahri Selimin dhe Avni Fetahun, ndërsa nga Shoqëria civile Fatmir Halimin.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-1, ZK Dobratin, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

z.Ardi Hasani, nga Kuvendi i Komunës

z.Ilir Koprani, nga Kuvendi i Komunës

z.Bahri Selimi, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Avni Fetahu, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Fatmir Halimi, nga sektori joqeveritar lokal

14. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-2, ZK Dobratin

14.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtare të komisionit përkatës e propozoj Sebastina Vokrrin.

z.Valon Demolli, theksoi, edhe Grupi i LDK-ës e mbështet e këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar të komisionit e propozon Arjant Topanicën.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Adelina Stublla dhe Shuajb Blakçori, kurse nga Shoqëria civile propozohet Englantin Restelica.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 18 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-337-2, ZK Dobratin, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

znj. Sebastina Vokrri, nga Kuvendi i Komunës

z. Arjant Topanica, nga Kuvendi i Komunës

znj. Adelina Stublla, nga Ekzekutivi i Komunës

z. Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës

z. Englantin Restelica, nga sektori joqeveritar lokal

15. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-336-0, ZK Dobratin

15.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

z. Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-ës e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisioni përkatës e propozoj Drita Pajazitin.

z. Valon Demolli, theksoi, Grupi i LDK e përkrah edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtare në komisionin përkatës e propozon Arnisa Sylejmanin.

z. Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Leutrim Krasniqi dhe Avni Fetahu, kurse nga Shoqëria civile propozohet Fatmir Halimi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 18 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-336-0, ZK Dobratin, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

znj. Drita Pajaziti, nga Kuvendi i Komunës

znj. Arnisa Sylejmani, nga Kuvendi i Komunës

z. Leutrim Krasniqi, nga Ekzekutivi i Komunës

z. Avni Fetahu, nga Ekzekutivi i Komunës

z. Fatmir Halimi, nga sektori joqeveritar lokal

16. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-640-0, ZK Lupç i Poshtëm

16.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisionin përkatës e propozojmë Florent Hasanin.

z. Valon Demolli, theksoi, Grupi i LDK-së e mbështet këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisionin e propozon Tringa Sfishtën

z. Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Vlora Humolli Jashanica dhe Alban Zeka, kurse nga Shoqëria civile propozohet Englantin Restelica.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 18 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-640-0, ZK Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

z. Florent Hasani, nga Kuvendi i Komunës

znj. Tringa Sfishta, nga Kuvendi i Komunës

znj. Vlora Humolli Jashanica, nga Ekzekutivi i Komunës

z. Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës

z. Englantin Restelica, nga sektori joqeveritar lokal

17. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1392-0, ZK Dobërdol

17.1. *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

z. Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-ës e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisionin përkatës e propozoj Kasib Bashotën.

z. Valon Demolli, theksoi, Grupi i LDK e përkrah edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtare në komisionin përkatës e propozon Donjetë Sheqirin.

z. Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Shujab Blakqori dhe Alban Zeka, kurse nga Shoqëria civile propozohet Fatmir Halimi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 18 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1392, ZK Dobërdol, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

*z.Kasib Bashota, nga Kuvendi i Komunës
znj.Donjetë Sheqiri, nga Kuvendi i Komunës
z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës
z.Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës
z.Fatmir Halimi, nga sektori joqeveritar lokal*

18. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1378-0, ZK Dobërdol

18.1.Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-ës e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisioni përkatës e propozoj Artrit Mulliqin.

z.Valon Demolli, theksoi, Grupi i LDK e përkrah edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtare në komisionin përkatës e propozon Fahri Hasanin.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Avni Fetahun dhe Lirie Hotin, kurse nga Shoqëria civile propozohet Englantin Restelica

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 18 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1378-0, ZK Dobërdol, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

*z.Artrit Mulliqi, nga Kuvendi i Komunës
z.Fahri Hasani, nga Kuvendi i Komunës
z.Avni Fetahu, nga Ekzekutivi i Komunës
znj.Lirie Hoti, nga Ekzekutivi i Komunës
z.Englantin Restelica, nga sektori joqeveritar lokal*

19. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-1, ZK Dobërdol

19.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-ës e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisioni përkatës e propozoj Fitim Muqollin.

z.Valon Demolli, theksoi, Grupi i LDK e përkrah edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtare në komisionin përkatës e propozon Qëndrim Softollin.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Lirie Hoti dhe Bahri Selimi, kurse nga Shoqëria civile propozohet Fatmir Halimi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-1, ZK Dobërdol, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

z.Fitim Muçolli, nga Kuvendi i Komunës

z.Qëndrim Softolli, nga Kuvendi i Komunës

znj.Lirie Hoti, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Bahri Selimi, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Fatmir Halimi, nga sektori joqeveritar lokal

20. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-2, ZK Dobërdol

20.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-ës e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtar në komisioni përkatës e propozoj Lirika Maliqin.

z.Valon Demolli, theksoi, Grupi i LDK e përkrah edhe këtë pikë të rendit të ditës dhe anëtare në komisionin përkatës e propozon Valon Demollin.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës propozohen Alban Zeka dhe Shuajb Blakçori, kurse nga Shoqëria civile propozohet Fatmir Halimi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe nënpikën përkatës për formimin e komisionit, dhe atë sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 19 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-1381-2, ZK Dobërdol, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, si dhe propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, në këtë përbërje:

znj.Lirika Maliqi, nga Kuvendi i Komunës

z.Valon Demolli, nga Kuvendi i Komunës

z.Alban Zeka, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës

z.Fatmir Halimi, nga sektori joqeveritar lokal

21. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronat nën menaxhimin e AKP-së, me qëllim të realizmit të projekteve: Muzeu i Qytetit; Ndërtimi i banimit me kosto të përbalueshme; Objekt arsimor – Çerdhe; Ndërtimi i parkut.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, bëhet fjalë për shpallje në interes të përgjithshëm për 4 prona, pikë e cila është proceduar përmes KPF-së për arsye të një shkrese të Agjencisë Kosovare të Privatizimit e cila është ardh krejt në fund dhe ne derisa i kemi bërë disa identifikime në DPKGJ për çka na kan marrë paksa kohë.

Pra bëhet fjalë për 4 prona të cilat janë në interes publik për realizmin e disa projekteve publike që janë Muzeu i Qytetit, Ndërtimi i Banimit me kosto të përbalueshme, Objekt arsimor-Çerdhe si dhe një Park në qendër të qytetit, andaj është shumë e nevojshme shpallja e këtyre pronave interes publik dhe në rast se ky Kuvend i Komunës nuk i shpallë interes publik atëherë AKP do t'i hedh në shitje këto prona. Për këtë kemi edhe një afat të caktuar kohor dhe për këtë arsye këtë pikë të rendit të ditës e kemi futë në rend të ditës përmes KPF-së, prandaj kërkoj miratimin e këtij propozimi në mënyrë që të mos shiten nga AKP por të kthehen prona komunale, si dhe është interesi tjetër që pagesa e shpronësimit bëhet vetëm me shumën 20% e jo me 100% të vlerës së vlerësuar nga Ministria e Financave, kështu që ju ftoj ta mbështetni këtë pikë të rendit të ditës sipas propozim vendimit përkatës.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe konsiderojmë se është interes i qytetarëve, andaj edhe e përkrahim këtë propozim vendim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës edhe pse ka qenë mirë të jeni pak më korrekt dhe të na sjellën dokumentacionet e skicave dhe të tjera në mënyrë që ne të dim se ku janë ato prona, përndryshe ne jemi që ato prona të hiqen nga lista e AKP-së për shitje dhe të kthehen në prona komunale për Çerdhe dhe për çka do tjetër në interes të qytetarëve mirëpo e përsërisë që do të ishte mirë të sillej skica e këtyre pronave që ne të mos kërkojmë numra e të shikojmë dhe hulumtojmë se për cilën pronë bëhet fjalë dhe ta kemi më të qartë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29.07.2024.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronat nën menaxhimin e AKP-së, me qëllim të realizmit të projekteve: Muzeu i Qytetit; Ndërtimi i banimit me kosto të përbalueshme; Objekt arsimor - Çerdhe; Ndërtimi i parkut, sipas materialit përkatës të paraqitur dërguar me Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29.07.2024.

22. Propozim vendimi për Transferin e buxhetit të Komunës për vitin 2024

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, bëhet fjalë për transferin e mjeteve buxhetore nga projekti i ndërtimit të shkollës së mesme te kampusi i shkollave të mesme në vlerë 225,000.00€ ku prej tyre 150,000.00€ transferohen për ndërtimin e shkollës në fshatin Shajkoc projekt për të cilin është lidhë kontrata por që nuk i kemi mjetet e mjaftueshme financiare, si dhe 75,000.00€ për renovimin e disa shkollave. Pra bëhet fjalë për heqjen e 250,000.00€ nga projekti në fjalë dhe transferimin në 2 projekte të cilat i ceka.

z.Haki Rudari, theksoi, kemi një propozim vendim për transferimin e 250,000.00€ të cilat ashtu siç e ceku edhe drejtori parafolës që transferohen për ndërtimin e shkollë në fshatin Shajkoc dhe për renovimin e disa objekteve shkollore tjera, prandaj si Grup i LVV-ës e përkrahim sepse konsiderojmë se është interes të qytetarëve në përgjithësi por në veçanti në interes të nxënësve për arsye se në këto vende në një formë kemi mungesë të kushteve të cilat janë të vështira, prandaj këto investime vetëm sa e ngrisin cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpër shkolla.

z.Naim Çunaku, theksoi, Grupi i LDK-së e përkrahë këtë rialokim të mjeteve buxhetore nga projekti i cekur në projektet tjera përkatëse dhe besojmë se kjo do të jetë një ndihmesë për arsimndjekësit dhe arsimdashësit për kualifikime profesionale dhe do të kontribuoj në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe ngritjes së punësimit në Komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29.07.2024.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për Transferin e buxhetit të Komunës për vitin 2024, sipas materialit përkatës të paraqitur dërguar me Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 29.07.2024.

23. Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronën private në fshatin Llugë – Komuna e Podujevës, me qëllim të ndërtimit të trotuarit në fshatin Llugë.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF si dhe i autorizuar për ushtrimin e funksionit të drejtorit të DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, bëhet fjalë për një pronë private në fshatin Llugë e cila gjendet pran rrugës kryesore që një pjesë e saj të shpallet në interes të përgjithshëm publik në mënyrë që pastaj të hapet rruga për zhvillimin e procedurave për këmbim me qëllim që pastaj të realizohet projekti ndërtimit të trotuarit në atë rrugë.

mandej pasi të bëhet vlerësimi nga ana e Ministrisë së Financave sërish kjo çështje do të sjellët në Kuvendin e Komunës për shqyrtim, mirëpo hapi i parë është të shpallet në interes publik pjesa e pronës ku duhet të ndërtohet trotuari sipas skicës së bashkëngjitur ku bëhet fjalë për 338 m² që duhet t'i merren një personi sepse prona në fjalë është pronë private, me qëllim të realizimit të projektit me interes publik.

z.Florent Hasani, theksoi, duke ditur rëndësinë e interesit qytetar për rregullimin e urbanizimit në atë zonë, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë një projekt për realizimin e projektit të ndërtimit të trotuarit në fshatin Llugë e kemi përmendur disa herë dhe unë e di që këtu disa herë është thënë se po shkojnë investimet në atë pjesë e gjëra të ngjashme, mirëpo për njoftimin e juaj fshati Llugë, nga magjistratja Prishtinë-Podujevë dhe nga magjistratja Lluzhan-Orllan është një distancë prej 2.8 km në të cilën pjesa dërmuese e banorëve janë aty dhe në veçanti do të ishte një ndihmesë e madhe për nxënësit sepse shkolla e fshatit Llugë ka mbi 300 nxënës e që një pjesë e madhe e atyre nxënësve apo mbi 70% e tyre e frekuentojnë atë rrugë dhe ndërtimi i trotuarit ka qenë mëse i nevojshëm, andaj një iniciativë e tillë vërtetë duhet të përkrahet si dhe mendoj se është një projekt i cili kërkon përkrahje dhe do të jetë ndihmesë e madhe për sigurinë e atyre nxënësve të cilët vijnë në mësimin në shkollën “Ilir Konushevci” në fshatin Llugë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vërtetë është një projekt që vlen të përkrahet, mirëpo sigurisht se një projekt dhe iniciativë e mirë do të ishte edhe ndërtimi i trotuarit në fshatin Obranqë në rrugën që frekuentohet nga nxënësit dhe të tjerët sepse vërtetë paraqitet nevoja për trotuare në atë pjesë për çka besoj se jeni në dijeni shumica prej juve, me theks asambleisti z.Valon Demolli i cili vie nga ajo pjesë e që sa kujtoj e ka kërkuar një gjë të tillë në këtë Kuvend, andaj shpresoj se në një prej mbledhjeve të radhës do të sjellët në Kuvend një propozim i tillë për shpallje në interes publik të një pjese të pronave që gjenden buzë asaj rruge.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga anëtarët e Kuvendit që ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik, pronën private në fshatin Llugë - Komuna e Podujevës, me qëllim të ndërtimit të trotuarit në fshatin Llugë, sipas propozimit të paraqitur në fillim të kësaj mbledhje.

24. Të Ndryshme

z.Florent Hasani, theksoi, një familje në fshatin Dumnicë me mbiemër Zeqiri e që njihen si Igrishtët, janë rreth 10 shtëpi, ka kohë që kanë bërë një kërkesë për vendvarrime në fshatin Dumnicë sepse e kanë prejardhjen prej Malësive të Llapit, dhe gjatë dimrit për varrime për shkak të borës së madhe i'u pamundësohet për t'i kryer ritualet e varrimit, pra kanë paraqitur kërkesë në Komunë për një vend që t'ju lejohet për varreza, andaj kërkoj përgjigje për këtë, nëse jo sot mund të më dërgohet përgjigja edhe me e-mail.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS e cila jam në dijeni se është emëruar tash së voni por besoj se e ka shfletuar kontratën përkatëse sa i përket terreneve sportive, andaj pyes çka është puna e tyre dhe përse asnjë deri tani nuk është përfunduar, as në Sekiraçë, as në Siboc, as në Kaçybeg, as në Peran as askund tjetër, a ka ndonjë ndëshkim për atë operator dhe a ka autoritet i cili e thirre dhe i'a shkëputë kontratën.

Madje shembull në fshatin Peran janë dy kontrata për atë fushë të futbollit, pastaj janë ndërruar dimensionet e fushës, prandaj kërkoj një përgjigje rreth këtyre fushave sportive, a duhet tash ato të mbeten gjithmonë ashtu apo të ndërmerret diçka.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM z.Leutrim Krasniqi, projekti i asfaltimit të rrugëve në fshatrat Lluzhan, Llugë, Sallabaj, Godishnjak, Penuhë, Shakovicë në vlerë rreth 118,000.00€ e kam parë se është pezulluar për çka kam kërkuar informacion por që nuk e kam marrë ende, andaj edhe sot këtu kërkoj që brenda mundësive të më jepet një përgjigje se çka ka ndodh me këtë projekt.

Po ashtu një pyetje edhe për drejtoreshën e DKRS-së, është ndarë buxhet dhe ka qenë projekti për këtë vit për ndërtimin e në terreni sportiv në fshatin Lluzhan, pyes se ku ka mbete ai projekt sepse më nuk është duke u diskutuar andaj do të doja ta dija sepse qytetarët e asaj ane po pyesin kështu që mendoj se është mirë të jepet një përgjigje.

z.Naim Çunaku, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DPUMM se a mund të na informoj me dinamikën e zhvillimit të punimeve në rr."Vëllezërit Frashëri". Duke pas parasysh fluksin e madh që kemi të ngarkuar komunikacionin çdo ditë vonese e atij projekti shkakton telashe për qarkullim të lirë në qytetin e Podujevës. A është duke shkuar sipas dinamikës së paraparë të zhvillimit të këtij projekti, nëse jo cilat janë arsytet.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z.Bahri Selimi, a është bërë dezinfektimi i insekteve në fshatin Sfeçël.

E them këtë sepse gjendja është alarmante prej insekteve duke ditë edhe faktin që ka fermer të shumtë në atë fshat dhe të cilët hedhin plehra kimikale të shpezëve, lopëve e gjithçka tjetër, kështu që situata është shumë alarmante dhe shumë ankesa prej shumë banorëve të fshatit Sfeçël.

Nëse është bërë njëherë Dezinfektim a ka mundësi të bëhet edhe njëherë i nderuar drejtor sepse gjendja është shumë shumë e rëndë.

z.Valon Demolli, theksoi, pyetje për drejtorin e DSHPMSH, a janë duke u zhvilluar projekte për interesa të disa individëve apo e keni prioritet interesin e përgjithshëm qytetarë. Fjalën e kam për një urë që është në ndërtim e sipër tek Deputeti i "famshëm" i juaji.

Po ashtu pyetje kam edhe për drejtorin e DPUMM për një gropë në rr. Skënderbeu" më sakt tek "Kikollët" në afërsi të furrës së bukës, e cila t'ju them të drejtën është duke ma vrarë syrin shumë, a do të ndërmerri në shpejti diçka për rregullimin e saj sepse përnjëmend ajo rrugë është bërë sikur Ura Fshejtë.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, edhe unë kam pyetje për drejtorin e DSHPMSH z.Bahri Selimi, fjala është për një par të vogël tek Hoteli i vjetër “Iliria” ku është edhe një pompë e benzinës në rrugën që qon në Batllav, ku zakonisht kur është bërë krasitja e barit në atë vend është bërë edhe pjesa poshtë deri tek hekurudha dhe poshtë hekurudhës, kurse në këtë vit sa e vërejta duke kaluar andej krasitja e barit është bërë vetëm në pjesën e rrafshët kurse në hekurudhë dhe poshtë saj nuk ka ndodh, prandaj pyes a është ndonjë gabim i kompanisë, në qoftë se po a ka mundësi të lajmërohet ajo kompani dhe të kryhet krasitja edhe e asaj pjese.

z.Naim Çunaku, theksoi, po e shfrytëzoj rastin edhe për pyetjen e dytë, duke pas parasysh që nga buxheti i Komunës kemi të shpallura operator ekonomik i cili merret me përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin veror dhe atë dimërorë, dhe më parë kur e përmendëm trotuarin në rrugën e fshatit Llugë e që e di se një pjesë e Ekzekutivit e frekuenton atë rrugë, ana e djathtë e asaj rruge është e mbuluar me therra dhe deri në gjysmën e rrugës nuk e lejon qarkullimin e lirë të veturave e që në një formë paraqet pengesë dhe madje paraqet rrezik për të gjithë ata që e frekuentojnë atë rrugë, andaj duke pasë parasysh se si Komunë kemi Kompani dhe Operator ekonomik të përzgjedhur që duhet të përkujdeset për këtë ose të intervenohet në atë rrugë sepse janë në pronë komunale dhe duhet të eliminohen në funksion të qarkullimit të lirë.

z.Ardi Hasani, theksoi, pyetje për DKRS, e nderuar drejtoresh shtegun e vrapimit te Parku i Pishave a je e informuar dhe a je duke e inspektuar sepse mua më duket se janë disa vërejtje të fushës përkatëse për disa lëshime që janë bërë në shtresën e betonit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku ka mbete projekti që qytetarët kanë aplikuar për subvencion, sa kam informata unë peng i atyre mos pagesave janë 1 apo 2 matrapaz të ciklet i kam përmend këtu edhe me emër ku ka qenë diskutimi për këtë temë, të cilët kanë bërë shifra marramendëse dhe tani komplet për këtë projekt nuk është bërë pagesa. Prandaj mendoj se në fillim duhet të hiqen disa persona dhe të mos pengohen personat që vërtetë merren me atë fushë, kurse tani po paguhen të gjithë bashkë sikurse ata që punojnë sikurse ata që rrinë nëpër banesa në Prishtinë, prandaj pyetja është pse nuk është bërë pagesa.

znj.Edona Shabani, theksoi, deshta t’ia rikujtoj drejtorit të DSHPMSH se në Sheshin e 4 Dëshmorëve, prapa banesave tek ura që dërgon te Xhamia ka mbet në terr dhe nuk funksionojnë dritat qe një kohë si dhe afër lumit dritat e ndriçimit publik nuk janë duke funksionuar për çka nuk e di janë prishura apo po ndalen. Pra në këtë kohë kur tani janë ardhur edhe mërgimtarët dhe nuk e njohin sa duhet atë shëtitore dhe atë urë ashtu siç e njohim ne kështu që po paraqet problem paksa edhe për fëmijët, madje ka zëra që është duke u keqpërdorur shumë si Park.

z.Ardi Hasani, theksoi, kam edhe një pyetje për drejtorin e DPUMM se a është e mundshme që pengesat në rrugën “Skënderbeu” të gdhenden apo ndonjë formë tjetër të bëhen më të përshtatshme ngase njëmend ka shumë ankesa se ato janë shumë të larta.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, po mundohem që në pika të shkurtra të japë përgjigje në pyetjet dhe çështjet e ngritura nga ana juaj drejtorisë që unë e udhëheqë.

Sa i përket kërkesës për familjen e cekur në fshatin Dumnicë është e vërtetë se lagja Zeqiri ka bërë një kërkesë për një hapësirë në atë lokalitet që të merret në shfrytëzim për varreza e që ne i kemi zhvilluar procedurat dhe kemi parë që ajo pronë është zonë pyjore që është nën menaxhimin e Agjencionit të Pyjeve andaj ne si Komunën nuk kemi mund ta japim në shfrytëzim, por megjithatë kemi kërkuar një pëlqim nga Agjencioni Pyjor e që jemi në diskutime me zyrtarët e kësaj agjencie dhe po presim të na jepet një pëlqim në mënyrë që ne pastaj të zhvillojmë procedurat e dhënies në shfrytëzim. Pra jemi në dijeni që kjo kërkesë është bërë qe rreth 6 muaj mirëpo ato prona që janë nën menaxhim të Agjencioneve ndodh që të ketë paksa vonesa mirëpo unë në bazë të diskutimeve

që kamë pas me Agjencinë e cekur së shpejti ajo pronë do t'ju jepet në shfrytëzim atyre banorëve për varreza sepse na kanë thënë që në atë pjesë nuk ka varreza fare.

Sa i përket dezinfektimit në fshatin Sfeçël, në hapësirat e jashtme aty ku përgjegjësia i takon DSHPMSh është i përcaktuar të bëhet 2 herë brenda vitit brenda një sezoni, andaj në këtë aspekt unë ju them se kemi bërë dy herë dezinfektim në të gjitha zonat që përfshijnë përreth gjithë lumenjve ku përfshihet edhe fshati Sfeçël, pjesa qendrore e qytetit – sheshi, mirëpo jemi në dijeni se sërish janë paraqitur insekte e që po paraqesin probleme qoftë në qytet qoftë përreth lumenjve. Meqë pyetja ishte për fshatin Sfeçël mund të them se është një prej vendeve më problematike që të mbahet i dezinfektuar sepse ashtu siç e përmende edhe parafolësja ka edhe ferma të ndryshme, ka fabrikë të pulave sa jam në dijeni, pastaj është fabrika e madhe e cila bënë plehërosjen e arave me mbetje të shtazëve, andaj këto paraqesin goxha problem dhe është e pamundshme të hiqen gjitha insektet atje edhe pse dy herë është bërë deinfektimi aty, ndërsa për ta bërë edhe njëherë dezinfektimin në atë lokalitet nuk mund të jap përgjigje tani për tani sepse duhet të shohim qysh e kemi gjendjen e kontratës e që sa jam në dijeni tan është në përfundim e sipër por nëse gjendjet ndonjë hapësirë pse jo mund të bëhet edhe njëherë dezinfektimi i asaj pjese duke përfshirë edhe lumenjtë edhe pse besoj jeni në dijeni se gjithëherë prioritet është pjesa qendrore e qytetit.

Sa i përket pyetjes së z.Valon Demolli, ishte goxha interesante kur u tha se a po i bëni projektet për interesa individuale apo për interesa të përgjithshme, unë e them se nuk e di që ka ndonjë projekt që është për interesa individuale dhe për urën në fjalë që u potencua mund të them se nuk është ndërtuar për asnjë individ por është bërë për të gjitha lagjet dhe për të gjithë banorët e asaj pjese dhe për t'ju treguar bash sinqerisht dhe sakt qysh ka qenë situata e ndërtimit të asaj ure po e përmendi sepse pastaj po thuhet gjëra që nuk janë ashtu, kur e kemi bërë rregullimin e shtratit të lumit Llap në atë pjesë ku janë një numër i lagjeve siç janë Stubullakët, Bebushët, Tovërlanët e të tjera, për të mos e ngushtuar lumin dhe të del sërish lumi nga shtrati siç ka ndodh është dashtë të zgjerohet paksa dhe të hyhet në pronë të tyre në mënyrë që të mos ngushtohet edhe rruga pastaj ku pikërisht aty sigurisht tek një kthesë jeni në dijeni sa ngushtë ka mbet, andaj ne në marrëveshje dhe në bashkëpunim me banorët e asaj pjese kemi diskutuar dhe jemi marrë vesh gojarisht me marrëveshje “gjentëlmene” që të zgjerohet ajo pjesë e lumit që ka qenë në interes të tyre dhe të bëhet një urë në atë pjesë e cila lidhë rrugën “Vëllezërit Babatinca” me rrugën magjistrale tek “Market Agnesa” dhe përveç që e zhbllokoi paksa rrugën që lidh atë pjesë për ata banorë me rrugën tek rrethi i Shqiponjës ajo urë i'u hyn në punës sigurisht edhe pronat dhe shtëpitë e tyre e që janë një numër bukur i madh o shtëpive sepse më parë e kemi rregulluar edhe një kanalizim sepse ka qenë komplet pa kanalizim ajo pjesë. Pra kjo ka qenë marrëveshja që kemi bërë me banorët dhe ne i'u kemi qëndruar besnik dhe e kemi ndërtuar atë urë.

Sa i përket kositjes së barit në parkun që u përmend nga z.Artrit Mulliqi, e kam vërejtur se ka mbete pjesa nën hekurudhë mirëpo Operatori ekonomik përkatës e ka për obligim të bënë kositjen e gjithë asaj hapësire mirëpo për ngecjet aty besoj se ka hasë në ndonjë problem sepse edhe bari ka qenë shumë i rritur në atë hapësirë, mirëpo besoj se tani me kontratën e re që e kemi lidh do të vazhdoj dhe besoj se shumë shpejt do të kryhet edhe ajo pjesë edhe pse mund të them se këto kositje dhe gjëra të ngjashme po na marrin bukur shumë buxhet dhe kohë.

Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve, konkretisht për prerjen e drunjve në afërsi të bankinave në rrugën e fshatit Llugë më ka rastësisë të merrem shumë me atë pjesë sepse kemi pas shumë punë me trotuarin në anën e kundërt të rrugës, mirëpo unë kam biseduar me pronarin e asaj prone/are i cili më ka thënë se ne këtë rregullisht e kositim vet ne dhe edhe në këtë vit do ta kositim dhe do t'i heqim ato therra dhe ata drunj, por sigurisht se nëse nuk e bënë ai do ta bëjmë ne me këtë kontratën e re që e kemi nënshkruar në mënyrë që të rregullohet si bankinë e rrugës.

Sa i përket ndriçimit publik anash lumit Llap në qytet është një problem dhe çështje e ngritur shumë me vend dhe që ne e kemi parë se ndriçimi në atë pjesë është i dëmtuar dhe se është shumë i vjetër andaj në pamundësi për ta rinovuar ne kemi iniciuar kontratë të re për rregullimin e ndriçimit publik në komplet dy anët e lumit Llap që përfshin dy shëtitoret përkatëse (nga ura në afërsi të kafiterive deri te ura tek xhamia), do të thotë gjithë kjo pjesë do të bëhet ndriçim i ri dhe për herë të par një ndriçim me standarde të re të eko-sistemit.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, sa i përket pyetjes së z.Ekrem Rrahmani lidhur me pagesat e subvencioneve nëse mund të më sqarohet për cilat subvencione bëhet fjalë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, pyetje ishte për subvencionet e muajit janar 2023 dhe qershorit 2023 kur kanë qenë vërshimet.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, vazhdoi, atëherë lidhur me kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në vitin 2023 unë ju ftoj personalisht juve dhe do ta ftoj komisionin përkatës që t'ju përgjigjen me shkrim përmes e-mailit për t'ju informuar më saktësisht me procedurat që janë zhvilluar.

znj.Vlora Humolli Jashanica, U.D. drejtoresh e DKRS, theksoi, po përgjigjem në pyetjen e z.Ekrem Rrahmani sa i përket punës në terrenet sportive, unë jam duke i përcjellë punët në vazhdimësi por shumica e tyre sipas kontratës janë dy vjeçare kështu që duhet të presim.

Pra unë jam duke punuar në atë drejtim dhe tani do ta shohim rezultatin së shpejti.

Sa i përket pyetjes së z.Ardi Hasani, shtegu i vrapimit tek Parku i Pishave në qytet është duke shkuar në proces ashtu siç duhet, edhe ai projekt është dy vjeçar kështu që tani ka mbet vetëm pjesa e tratanit, disa pjesë të betonit që janë hedh vend e pa vend por janë tërheq dhe është kthyer në gjendjen e mëparshme, andaj nuk ka buxhet të mjaftueshëm deri në vitin e ardhshëm, prandaj vetëm tratanit ka mbet dhe besoj që në fillim vitin e ardhshëm vetëm do ta gëzojnë atletët tanë.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, unë parashtrova pyetje për projektin e paraparë për terren sportiv në fshatin Lluzhan në vitet 2023/2024 mirëpo nuk mora përgjigje, andaj sërish kërkoj të informohemi ku ka mbete dhe përse nuk po flitet më për atë terren sportiv.

znj.Vlora Humolli Jashanica, U.D. drejtoresh e DKRS, theksoi, lidhur me pyetjen e parafolësit, si çështje është në proces por për më shumë do t'ju informoj përmes e-mailit.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket pyetjes për infrastrukturën dhe inicimit të procedurës për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Lluzhan, Shakovic dhe Sallabajë, ne kemi iniciuar procedurën mirëpo ka pasë ankesë dhe si e tillë është në hapin e dytë të vlerësimit nga ana e Komisionit përkatës dhe pas përcaktimit dhe shqyrtimit të lëndës do të vendoset rreth kësaj procedure.

Sa i përket projektit të rrugës së re që lidhë rr."Vëllezërit Frashëri" me magjistralen Podujevë-Prishtinë, sigurisht të gjithë e dim se kjo rrugë ka një rendësi shumë të madhe për Komunën tonë, konkretisht për zonën urbane. Ne jemi duke u munduar që maksimalisht të përcjellim edhe procedurat e ekzekutimit të kontratës në kuptimin që të realizohet sa më shpejt që ka mundësi e që afati kohor i përfundimit të kontratës me plan dinamik është i përcaktuar të përfundoj në këtë vit dhe deri në këto momente është përfunduar pjesa e kanalizimit fekal dhe atij atmosferik, kurse janë duke u bërë mbushja me zhavorr sipas kontratës, mirëpo duhet pasur parasysh që rreth kësaj kontrate ne jemi duke pritur edhe pjesën e ekzekutimit të punimeve të urës për shkak të mos interferimit të dy projekteve të ndryshme dhe pas përfundimit të ndërtimit të urës ne do të vazhdojmë pjesën tjetër të lidhjes apo inkorporimit të rrugës në fjalë.

Sa i përket rr. Skënderbeu”, kjo rrugë ende nuk ka pranim teknik, ka pasë një defekt në sistemin e instalimit të ujit dhe tani është mënjanuar ai defekt andaj në pjesën e procedurës ka mbete edhe gropa që u cek e që edhe ajo gropë do të mbyllet shumë shpejt, ndërsa sa i përket çështjes së pengesave në këtë rrugë dhe të tjera tani ato janë vendos për shkak të kërkesave të shumicës së qytetarëve për shkak të ngasjes së veturave me një shpejtësi më të lartë, andaj si të tilla ato pengesa konsideroj se janë në rregull dhe si projekt ka dal ashtu me një formë të tillë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa po vërejë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, andaj e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje të rendit të ditës duke i’u dëshiruar pushime të këndshme deri në muajin shtator, përveç nëse paraqiten nevoja dhe situata eventuale për ndonjë mbledhje gjatë muajit gusht.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 16:40

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0050229/24

Podujevë,

31 korrik 2024

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, në pajtim me nenin 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, nenet 14, 15 dhe 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i

PROPOZON

VENDIM PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2025

Neni 1 Shkalla tatimore progresive

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2025 për të gjitha vlerat e pronave në territorin e Komunës së Podujevës, sipas vlerës së kombinuar të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit, si vijon:

- 1.1. Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.10 %**;
- 1.2. Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.20%**, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të këtij neni, **caktohet**;
- 1.3. Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.30 %**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të këtij neni;
- 1.4. Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.40 %**, plus tatimi nga nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni; dhe
- 1.5. Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.50%**, plus tatimi nga nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të këtij neni.

2. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform nenit 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Neni 2 Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021, dhe i njëjti zbatohet nga data 01 janar 2025.

Nr.prot. 02-400/01-0059814/24
Podujevë, datë: 02/09/2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Në bazë të nenit 62.3, ndërlidhur me nenet 11, 12 paragrafët 1 dhe shkronja d) dhe nenin 17 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 5 nën paragrafi 1.2.1, nenit 10 nën paragrafi 2.1, neneve 11, 15 dhe 26 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr.04/L-174, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, nenit 64 paragrafi 4, ndërlidhur me nenet 14, 15 paragrafi 2.4, nenin 19 paragrafi 1.2 të Statuti të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nin 13 paragrafi 1.1 të Rregullores(MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Kuvendit të Komunës, i,

Propozon

V E N D I M

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë Vendim fillohet hartimi i Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Podujevës.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Neni 3

Qëllimi i hartimit

Me Planin Zhvillimor Komunal nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor me kontekst të ndryshimeve të bërë dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor të Komunës së Podujevës, plotëson kërkesat ligjore për të përgatitur Planin strategjik multi-sektorial i cili përfshin planifikimin dhe zhvillimin e zonës urbane dhe rurale.

Neni 4

Kufiri i territorit të Komunës

Zonat kadastrale në territorin e komunës së Podujevës janë sipas ligjit nr 03/L-041 për kufijtë administrativ dhe atë, si vijon:

Nr.	Zonat kadastrale	Numri i zonës kadastrale	Sipërfaqja (km ²)	Sipërfaqja (ha)
1	Halabak	71712001	6.85	685
2	Bajçinë	71712002	8.92	892
3	Balloç	71712004	10.52	1052
4	Barainë	71712005	6.51	651
5	Batllavë	71712006	17.58	1758
6	Bellopojë	71712007	5.58	558
7	Bllatë	71712008	2.15	215
8	Brainë	71712009	17.39	1739
9	Bërvenik	71712010	5.18	518
10	Bradash	71712011	16.07	1607
11	Brecë	71712012	9.08	908
12	Buricë	71712013	2.96	296
13	Velikarekë	71712014	7.06	706
14	Gllamnik	71712015	12.57	1257
15	Godishnjak	71712016	2.43	243
16	Dumnicë e Epërme	71712017	7.36	736

17	Llapashticë e Epërme	71712018	20.61	2061
18	Pakashticë e Epërme	71712019	15.28	1528
19	Lupç i Epërm	71712020	8.15	815
20	Siboc i Epërm	71712021	2.56	256
21	Gërdoc	71712022	5.81	581
22	Dvorishtë	71712023	5.54	554
23	Dobërdol	71712024	6.7	670
24	Dobratin	71712025	15.25	1525
25	Dumnicë e Poshtme	71712026	20.52	2052
26	Llapashticë e Poshtme	71712027	9.65	965
27	Pakashticë e Poshtme	71712028	0.82	82
28	Lupç i Poshtëm	71712029	8.84	884
29	Siboc i Poshtëm	71712030	1.42	142
30	Dyz	71712031	8.51	851
31	Dumosh	71712032	3.65	365
32	Zhiti	71712033	12.7	1270
33	Zakut	71712034	2.4	240
34	Kalaticë	71712035	3.36	336
35	Kaçybeg	71712036	1.5	150
36	Sallabajë	71712038	2.66	266
37	Kunushec	71712040	3.64	364
38	Kërpimëh	71712041	5.65	565
39	Kushevicë	71712042	5.37	537
40	Lladoc	71712043	4.87	487
41	Llaushë	71712044	9.92	992
42	Letanc	71712045	3.13	313
43	Livadicë	71712046	2.71	271
44	Llugë	71712047	3.27	327
45	Lluzhan	71712048	2.31	231

46	Muhazob	71712049	4.54	454
47	Majac	71712050	14.32	1432
48	Metergoc	71712051	16.51	1651
49	Merdar	71712052	3.33	333
50	Metehi	71712053	7.12	712
51	Miroc	71712054	3.95	395
52	Murgull	71712055	37.21	3721
53	Obrançë	71712057	5.98	598
54	Orllan	71712058	16.93	1693
55	Pollatë	71712059	6.72	672
56	Penuhë	71712060	3.82	382
57	Peran	71712061	3.32	332
58	Podujevë	71712062	9.15	915
59	Popovë	71712063	17.27	1727
60	Potok	71712064	3.3	330
61	Përpellac	71712065	5.83	583
62	Radujevc	71712067	1.23	123
63	Rakinicë	71712068	4.35	435
64	Revuq	71712069	8.29	829
65	Repë	71712070	12.26	1226
66	Reçicë	71712071	12.18	1218
67	Sfeqël	71712072	5.03	503
68	Sylevicë	71712073	10.03	1003
69	Sllatinë	71712074	12.13	1213
70	Surdull	71712075	2.6	260
71	Surkish	71712076	2.6	260
72	Tërnavë	71712077	9.23	923
73	Tërnavicë	71712078	6.05	605
74	Turuçicë	71712079	15.08	1508

75	Herticë	71712080	22.65	2265
76	Shajkoc	71712081	9.62	962
77	Shakovicë	71712082	1.69	169
78	Shtedim	71712084	3.4	340
Totali			632.73	63273

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal caktohet Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes të Mjedisit.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

- 1.Mjetet për hartimin e Plani Zhvillimor Komunal sigurohen nga buxheti i Komunës së Podujevës.
- 2.Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Drejtoritë sektoriale do të kujdesen për procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe burimet njerëzore të stafit civil të Komunës, si dhe kompaninë projektuese.
- 3.Dokumenti i planifikimit – Plani Zhvillimor Komunal hartohet nga kompania kontraktuese e përzgjedhur përmes procedurave të prokurimit publik, në pajtim me Ligjin nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Neni 7

Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor, sipas nenit 1 të këtij Vendimi, është i obliguar që Planin Zhvillimor Komunal ta hartoj në afat prej 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 8

Konsultimet publike

8.1. Projekt-Plani Zhvillimor Komunal para finalizimit vihet në konsultime dhe shqyrtime publike.

8.2. Vënia e Projekt-Planit Zhvillimor Komunal në konsultime dhe shqyrtime publike duke përfshirë datën e mbajtjes së debatit publik dhe kohën për dhënien e vërejtjeve, plotësimeve dhe sugjerimeve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i vlefshmërisë

Plani Zhvillimor Komunal hartohet për periudhën 8 (tetë) vjeçare.

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij Vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare dhe në 3 (tre) ekzemplarë origjinal të nënshkruar dhe vulosur si dhe në 3 (tre) ekzemplarë digjital origjinal.

Neni 11

Programi

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë me nenin 11 paragrafi 1.3 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, nr.04/L-174.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr. 07-350/01-0060275/24

Podujevë, Datë: 03.09.2024

Drejtori

Leutrim Krasniqi



II. PËRSHKRIMI I DETYRAVE PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

1. Përgatitja e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033

1.1. Detyrat e përgjithshme

Plani Zhvillimor Komunal është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Plani Zhvillimor i Komunës duhet të përfshijë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën e ardhshme tetë (8) vjeçare 2025 -2033, përkatësisht periudhën tetë (8) vjeçare pas hyrjes në fuqi të PZHK-së.

Detyra projektuese për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2025- 2033 bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore të përmendura më lartë. Po ashtu në hartimin e detyrës projektuese janë marrë parasysh dokumentet planifikuese të nivelit nacional konform nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, pastaj Harta Zonale e Komunës së Podujevës (HZK) e miratuar në vitin 2022 dhe dokumentet tjera relevante të Komunës, të cilat kanë ndikim në hartimin e PZHK-së.

Gjatë procesit të hartimit të PZHK, kompania e kontraktuar për përgatitjen e PZHK duhet të marrë parasysh kërkesat shtesë nga Grupi Punues, Grupi Konsultativ dhe grupet e ekspertëve, si dhe të gjitha kërkesat tjera që parashtrihen në debatet publike dhe që konsiderohen me rëndësi në këtë proces dhe me ndikim në PZHK.

PZHK duhet të ruaj konsistencën e mundshme të planifikimit hapësinor dhe zhvillimit sipas PZHK të vitit 2017-2025 dhe të integroj HZK të vitit 2022.

PZHK duhet të hartohet në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor.

PZHK duhet të hartohet në formën e cila e bën më të lehtë përdorimin dhe lehtëson monitorimin dhe rishikimin.

PZHK duhet përmes pjesëmarrjes publike të marrë parasysh kërkesat e të gjithë qytetareve, si dhe kërkesat dhe nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, minoriteteve, fëmijëve, të rinjve dhe aspektet e ndjeshme gjinore.

PZHK duhet të bazohet në aktivitetet zhvillimore hapësinore përkatësisht nga harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës, planet zhvillimore sektoriale dhe plani i veprimt.

PZHK duhet të përcakton ndarjen precize të territorit të komunës në zona funksionale dhe për secilën zonë përcakton shfrytëzimet e tokës, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për periudhën e planifikuar të zhvillimit.

PZHK duhet të përmban zonat funksionale të cilat rrjedhin nga Harta Zonale e Kosovës dhe Planet Hapësinore për Zona të Veçanta.

Gjatë hartimit të PZHK duhet mundësuar promovimin e veprimtarive të organizuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, në zonat rurale në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore kualitative dhe kulturave të ndryshme.

Gjatë hartimit të PZHK duhet mundësuar sigurimin e mbrojtjes së investimeve të infrastrukturës publike, sociale, teknike dhe zhvillimit të integruar e të arritshëm në funksion të transportit urban, ndër urban, rural dhe menaxhim të mbeturinave.

Gjatë hartimit të PZHK duhet mundësuar promovimin e mundësive të barabarta për banim të qëndrueshëm për familjet që nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të banimit me qëllim të stabilitetit social, shëndetit dhe zhvillimit të mirëqenies njerëzore për të gjithë qytetarët nën administrimin territorial të komunës.

Gjatë hartimit të PZHK duhet mundësuar sigurimin e mundësisë së shfrytëzimit të tokës në koordinim me komunat fqinje, qeverinë qendrore dhe agjencitë tjera, veçanërisht në lidhje me resurset dhe shërbimet që shtrihen përtej kufijve të komunës apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në atë komunë si;

a. sigurimin që shfrytëzimi i tokës të përfshijë udhëzime të planifikimit dhe obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet dhe planet hapësinore për rajon më të gjerë e të cilat afektojnë komunën/komunat fqinje;

b. sigurimin e përfshirjes së elementeve hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunën në procesin e planifikimit hapësinor; dhe

c. sigurimin e rishikimit efikas të propozimeve për zhvillim dhe kërkesave për leje ndërtimore për sqarim dhe përshpejtim të procedurës administrative.

2. Parimet për hartimin e PZHK

Autoritetet përgjegjëse të Komunës së Podujevës dhe kompania e kontraktuar për hartimin e PZHK-së do të ndërtojnë një qasje të përbashkët të punës për hartimin e PZHK – bazuar në parimet e përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe parimet plotësuese të përcaktuara me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

III. PËRMBAJTJA E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL (2025-2033)

PZHK duhet të përmbajë dy pjesë themelore, të cilat duhet të përmbajnë të dhënat e duhura:

1. Pjesën tekstuale; dhe
2. Pjesën hartografike.

1. Pjesa tekstuale:

Pjesa tekstuale përfshinë pesë (5) kapituj themelor me të dhënat si në vijim:

1.1. Hyrjen

Në këtë pjesë duhet të përfshihen të gjitha informacionet e kërkuara me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

1.2. Profilin e Komunës

Profili komunal shqyrton dhe përmbledhë të dhënat lidhur me:

- Historinë e zhvillimit të komunës;
- Gjendjen ekzistuese të komunës (në të gjithë sektorët që trajtohen me PZHK);
- Kapacitetet njerëzore dhe financiare.

Mbledhja e të dhënave për Profilin Komunal bëhet në pajtueshmëri me Shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

1.3. Vlerësimi i Gjendjes

Vlerësimi i gjendjes shqyrton dhe vlerëson të dhënat e Profilit Komunal për t'i paraqitur trendet, nevojat, projeksionet dhe prognozatat, si dhe supozimet e ardhshme që janë relevante për komunën.

Fushat kyçe për analizë mund të përfshijnë:

- Projeksionet për popullsinë;
- Prognozatat e gjendjes ekonomike;
- Nevojat për banim në të ardhmen;

- Lëvizjen e njerëzve, mallrave dhe shërbimeve përgjatë rrugëve specifike të komunikimit.

Me vlerësimin e gjendjes shqyrtohen përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për komunën që përkufizojnë nevojat dhe kërkesat e fushave zhvillimore sektoriale.

Vlerësimi i gjendjes përfshinë shqyrtimin e fushave tematike për komunën, specifike dhe relevante për komunën si dhe me komunat fqinje, nivelin qendror dhe normat teknike të planifikimit hapësinor.

Vlerësimi i gjendjes përqendrohet në identifikimin e sfidave të lidhura me fushat tematike me vëmendje të veçantë lidhur me implikimet e tyre hapësinore.

Vlerësimi i gjendjes rezulton me gjetje kyçe dhe supozime të pranuar për:

- Konstatime gjeografike dhe mjedisore;

- Trendet dhe prognozat demografike;

- Gjendjen e secilës fushë sektoriale, nevojave dhe nevojave përkatëse, kërkesave dhe mundësive për zhvillim;

- Identifikimin e implikimeve hapësinore për komunën; dhe

- Identifikimin e nevojave që duhet adresuar dhe plotësuar në mënyrë që të tejkalohen sfidat kryesore të zhvillimit hapësinor.

Këto gjetje kyçe, përfundime koncize dhe supozime të pranuar duhet të përdoren për të krijuar bazën për hartimin e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor dhe Prioriteteve të Zhvillimit Strategjik.

Fushat tematike përfshijnë por nuk kufizohen në:

- Fusha ekonomike;

- Infrastruktura teknike;

- Infrastruktura e transportit dhe transporti;

- Infrastruktura publike dhe sociale;

- Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri;

- Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike;

- Vendbanimet;

- Banimi;

- Vendbanimet Joformale; dhe

- Shfrytëzimi i tokës.

Për më shumë lidhur me vlerësimin e gjendjes merren parasysh të gjitha kërkesat e nenit 8 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

1.4. Korniza e Zhvillimit Hapësinor

Korniza e Zhvillimit hapësinor përbëhet nga komponentët në vijim:

- Vizioni;
- Qëllimet;
- Objektivat;
- Koncepti i Zhvillimit Hapësinor.

Këto komponente duhet zhvilluar në përputhje të plotë me nenin 9 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Përveç kësaj, koncepti i zhvillimit hapësinor duhet të prezantohet përmes skenarëve të propozuar hapësinor (së paku tre (3) skenarë) që paraqesin përshkrime tekstuale dhe harta që përshkruajnë zgjerimet, kërkesat për shfrytëzimin e tokës në të ardhmen, masat mbrojtëse dhe zonat që do të mbrohen, si dhe ndryshimet e propozuara dhe zhvillimet e reja. Për secilin skenar duhet të prezantohen përparësitë, mangësitë dhe konkluzionet.

Skenarët e propozuar hapësinor diskutohen në shqyrtim publik.

Skenari i propozuar hapësinor dhe i përkrahur nga komuniteti dhe palët e interesit, zhvillohet tutje sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor përmes hartës për shfrytëzimin e planifikuar të tokës dhe hartave për planet zhvillimore sektoriale krijon bazën për Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Planit të Veprimit.

1.5. Prioritetet Strategjike Zhvillimore dhe Plani i Veprimit

Kjo pjesë analizon nevojat e identifikuara nëpërmjet vlerësimit të gjendjes dhe harton zgjidhje në formën e prioriteteve zhvillimore strategjike në përputhje me vizionin, qëllimet dhe objektivat.

Prioritetet e zhvillimit strategjik po ashtu caktojnë edhe aktivitetet për zbatimin e planeve zhvillimore sektoriale.

Analiza e të gjitha prioriteteve strategjike dhe zgjidhjeve të propozuara do të merr parasysh:

- Resurset e nevojshme financiare, njerëzore dhe hapësinore;

- Efektivitetin dhe afatin kohor; dhe

- Analizën e përfitimeve nga shpenzimi (kost-benefiti) në të cilën krahasohen shpenzimet e përfaqësuara me përfitimet publike dhe sociale që lidhen me projektet ose vendimet e veçanta.

Të gjitha Prioriteteve të Zhvillimit Strategjik u shtohen të dhënat si në vijim:

- Aktivitetet në formën e një plani ose projekti;

- Dobitë publike dhe sociale që rezultojnë nga projekti;

- Afatin kohor; dhe

- Vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese financuese për zbatimin e projektit dhe burimet shtesë të financimit dhe mekanizmat, nëse nevojiten.

Prioritetet e Zhvillimit Strategjik zhvillohen në bashkëpunim me udhëheqjen komunale dhe harmonizohen me strategjitë ekzistuese sektoriale para hartimit të Planit të Veprimit.

Plani i veprimit duhet të paraqet një përmbledhje të hollësishme të të gjitha projekteve dhe masave, si dhe veprimeve të nevojshme për të arritur objektivat dhe prioritetet e Zhvillimit Strategjik.

Për më shumë, Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Plani i Veprimit duhet të zhvillohet sipas kërkesave të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr.11/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.

2. Pjesa hartografike:

Pjesa hartografike duhet të përbëhet nga:

- Harta hapësinore konceptuale dhe
- Harta të planeve zhvillimore sektoriale.

Pjesa hartografike e PZHK-së përbëhet nga hartat e integruara sipas fushave tematike për tërë hapësirën e komunës të përgatitura në sistemin zyrtar të planifikimit hapësinor në platformën GIS, i cili paraqet informacion thelbësor për të gjitha planet zhvillimore sektoriale si rrjedhojë e Konceptit të Zhvillimit Hapësinor dhe Prioriteteve Strategjike të Zhvillimit. Këto harta përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në çështjet si në vijim:

-Harta e zhvillimit hapësinor të planifikuar paraqet të gjitha vendbanimet ekzistuese dhe të planifikuara më hapësirat për ndërtim dhe masat mbrojtëse për zhvillim;

- Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës përcakton shfrytëzimin e ardhshëm të tokës për bujqësi, banim, komerciale, teknologjike, industriale dhe shfrytëzim i përzier;

- Hartat e planeve zhvillimore sektoriale përfshirë hapësirat, ndërtimet dhe infrastrukturën e planifikuar me të gjitha instalimet mbivotkësore dhe nëntokësore, si më poshtë:
- Harta e Planit të Zhvillimit Ekonomik;
- Harta e Planit të Infrastrukturës së Transportit;
- Harta e Planit të Transportit urban dhe rural;
- Harta e Planit të Energjisë elektrike dhe termike;
- Harta e Planit të Ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Harta e Planit të Sistemit të Ujitjes dhe drenazhimit;
- Harta e Planit të Telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjashme;
- Harta e Planit të hapësirave publike dhe sociale;
- Harta e Planit të Hapësirave sportive;
- Harta e Planit të Hapësirave të hapura publike dhe të gjelbra;
- Harta e Planit të Menaxhimit të varrezave;
- Harta e Planit për Mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Harta e Planit për Mbrojtjen nga rreziqet natyrore;
- Harta e Planit për Menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin.

IV. ÇËSHTJET ME FOKUS TË VEÇANTË NË PRIORITETET SEKTORIALE

Në sektorin e turizmit duhet trajtuar resurset turistike dhe zona historike.

Zhvillimi ekonomik, infrastruktura teknike dhe transporti.

Në sektorin e bujqësisë duhet trajtuar sistemin e ujitjes së tokave bujqësore, duke përcaktuar zonat përkatëse, burimet e ujit dhe kapacitetet tjera materiale.

Lidhur me pylltarinë duhet hartuar projektin “strategjik” për pyllëzimin e zonave të zhveshura.

Duhet trajtuar zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe përcaktimin e masave parandaluese, përkatësisht mbrojtëse.

Mbrojtja e mjedisit, trajtimi i ujërave të zeza dhe ngritja e impianteve.

Menaxhimi i mbeturinave dhe riciklimi i tyre.

Mbrojtja e mjedisit nga mbetjet medicinale në kuadër të institucioneve që ofrojnë shërbime shëndetësore.

Mbrojtja e mjedisit duhet të trajtohet dhe të jetë pjesë përbërëse e të gjitha zhvillimeve dhe planifikimeve në fusha të tjera si:

Ekonomia – zhvillimi dhe mjedisi, veçanërisht trajtimi i masave mjedisore për:

Gurëthyesit;

Bazat për prodhimin e gëlqeres;

Bazat për prodhimin e betonit;

Infrastruktura dhe mjedisi; dhe

Shërbime publike-cilësia e shërbimeve dhe mjedisi.

V. ASPEKTET TEKNIKE TË PËRGATITJES SË PZHK 2025 -2033

I tërë teksti në të gjitha pjesët e PZHK-së duhet të jetë në gjuhët zyrtare. Pjesët tekstuale prezantohen në format A4 dhe atë në tri (3) kopje fizike si dhe në kopje elektronike.

Formati, përmbajtja dhe përpjesa e paraqitjes e të gjitha të dhënave dhe pjesëve hartografike duhet të bëhet në formën e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ për data bazën e Planifikimit Hapësinor.

Të gjitha hartat hapësinore konceptuale, hartat ilustrative dhe hartat e planeve zhvillimore sektoriale prezantohen mbi harta të gjeo-referencuara ortografike dhe topografike.

Të gjitha të dhënat bazë dhe të dhënat në GIS bëhen pronë e Komunës së Podujevës .

VI. TË TJERA

Pjesë e detyrës projektuese është edhe Programi i punës si pjesë e Vendimit të Kuvendit të Komunës për hartimin e PZHK. Programi është bashkëngjitur në Shtojcën 3.

Nëse ndonjë çështje nuk është paraparë në “Detyrën projektuese” apo parashtrohet ndonjë çështje shtesë nga autoriteti kontraktues, atëherë ato duhet të merren parasysh dhe vepronet drejtpërdrejt sipas legjislacionit në fuqi.

Programi i Punës

për hartimin dhe menaxhimin e Planit Zhvillimor Komunal

Bazuar në kërkesat ligjore, bartës i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), është Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor. Aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal:

1. Punët parapërgatitore

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përcaktimi i Grupit punues	A. Përcaktimi i udhëheqësit të projektit, koordinatorëve të drejtorive (KD) vijuese: a. Administratë e Përgjithshme b. Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim rural c. Zhvillim Ekonomik d. Kulturë, Rini dhe Sport e. Shërbime Publike dhe Emergjencia f. Inspektim Komunal g. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale h. Arsim i. Buxhet dhe Financa i. Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit j. Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.	Në mënyrë që PZHK të përgatitet, nevojiten të përcaktohen personat përgjegjës të cilët do të mbikëqyrin këtë proces dhe përmbajtjen që i përket drejtorive sektoriale	1 javë	Kryetari i Komunës
2. Përcaktimi i grupeve të interesit	A. Përcaktimi i grupeve lokale të interesit, institucioneve qendrore, organizata të jashtme që ofrojnë shërbime publike, OJQ, biznese, përfaqësues të fshatrave dhe bashkësive lokale(GP); B. Krijimi i listës dhe kontakteve të pjesëmarrësve.	Në mënyrë që PZHK të përkrahet nga banorët e Komunës, nevojitet që të përcaktohet organizatat dhe përfaqësuesit e komuniteteve.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

3. Trajnimi i punonjësve të Komunës	<p>A. Njoftimi i drejtorive rreth procesit të planifikimit hapësinor dhe PZHK nga Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor.</p> <p>B. Trajnimi i punonjësve nga kompania konsulente për shfrytëzim të GIS-it dhe aplikacioneve tjera;</p>	Në mënyrë që të përgatitet një dokument i harmonizuar dhe i qëndrueshëm, drejtoritë sektoriale duhet të njoftohen rreth implikimeve ligjore dhe të dhënave që nevojiten.	1 javë	Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor
4. Hartimi i konceptit dhe planit të punës	<p>A. Shqyrtimi i Kornizës Logjike të PZHK sipas UA dhe ligjit;</p> <p>B. Identifikimi i Rreziqeve/ Kërcënimeve;</p> <p>C. Vlerësimi i PZHK paraprake;</p> <p>D. Analizimi i Planit Hapësinor të Kosovës, që përcakton zhvillimet për Komunën.</p> <p>E. Krijimi i strukturës përmbajtësore të PZHK</p> <p>F. Prezantimi i strukturës dhe konceptit të punës, para drejtorive Komunale.</p>	Në mënyrë që të zhvillohet një koordinim i qëndrueshëm i drejtorive sektoriale, nevojitet që të miratohet një strukturë e dokumentit mbi të cilin do të bazohet një plan i hollësishëm i punës përgjatë hartimit të PZHK-së.	3 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
5. Zhvillimi i takimeve njoftuese me banorët	<p>A. Përgatitja e prezantimit të planit të punës dhe qëllimit të PZHK për takimin njoftues me banorët dhe GP;</p> <p>B. Takimi njoftues me banorë të zonës urbane dhe GP;</p> <p>C. Katër takime njoftuese me banorë të zonave rurale .</p>	Në mënyrë që banorët dhe GP të jenë të njoftuar rreth metodologjisë së kontributit të tyre, nevojitet një takim njoftues.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

2. Grumbullimi i dhe vlerësimi i të dhënave nga Drejtoritë Komunale

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Grumbullimi i të dhënave komunale	<p>A. Grumbullimi i të dhënave të drejtorive vijuese:</p> <p>a. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga drejtoritë përkatëse;</p> <p>b. Administratë e Përgjithshme</p> <p>c. Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik</p> <p>d. Kulturë, Rini dhe Sport</p> <p>e. Shërbime Publike dhe Emergjencë</p> <p>f. Inspektim Komunal</p> <p>g. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale</p> <p>h. Arsim</p> <p>i. Buxhet dhe Financa</p> <p>i. Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit</p> <p>j. Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.</p>	Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK nevojitet që grumbullohen të dhënat dhe e kërkuara sipas UA për PZHK.	3 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
2. Grumbullim i të dhënave të nivelit qendror dhe Kompanive regjionale	<p>A. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga ministritë përkatëse;</p> <p>B. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga ujësjellësi regjional.</p>	Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK nevojitet që grumbullohen të dhënat dhe e kërkuara sipas UA për PZHK	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
3. Grumbullimi të dhënave të operatorëve tjerë publik dhe organizata ndërkombëtar	A. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga furnizuesit me rrymë elektrike; B. Zhvillimi i takimeve dhe sigurimi i të dhënave të nevojshme nga operatorët e telekomunikacionit; C. Etj.	Në mënyrë që të përgatitet Profili i PZHK-ës nevojitet që grumbullohen të dhënat dhe e kërkuara sipas UA për PZHK.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
4. Vlerësimi i të dhënave nga konsulentët	A. Vlerësimi i të dhënave të grumbulluara dhe formatizimi i tyre sipas UA për PZHK.	Në mënyrë që të dhënat të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, nevojitet një vlerësim i plotësimit të këtyre kërkesave.	3 javë	Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor
5. Inkorporimi i sugjerimeve për të dhëna shtesë që ligjërisht kërkohen	A. Plotësimi me të dhëna shtesë, në rast se kjo vlerësohet e nevojshme.	Të gjitha të dhënat e grumbulluara duhet të jenë me kërkesat e UA për PZHK.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

3. Përgatitja e Profilit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografike të Profilit Komunal	<p>A. Plotësimi i Profilit me të dhënat e grumbulluara, si vijon:</p> <p>a. Historiku i zhvillimit të Komunës</p> <p>b. Pozita</p> <p>c. Gjendja ekzistuese demografike</p> <p>d. Gjendja ekzistuese e veçorive mjedisore</p> <p>e. Gjendja ekzistuese e zhvillimit ekonomik</p> <p>f. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike</p> <p>g. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së transportit dhe transportit publik</p> <p>h. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës publike</p> <p>i. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës sociale</p> <p>j. Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe sipërfaqeve merrezikshmëri</p> <p>k. Gjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike.</p>	<p>Në mënyrë që të përgatitet Vlerësimi i Gjendjes Ekzistuese është i domosdoshëm të përgatitet pasqyra e gjendjes ekzistuese.</p>	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
	<p>l. Gjendja ekzistuese e vendbanimeve</p> <p>m. Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës.</p>			
2. Konsultimi i Profilit Komunal nga Grupet Punuese	<p>A. Vlerësimi i Profilit nga KD</p> <p>B. Vlerësimi i Profilit nga GP</p> <p>C. Vlerësimi i Profilit nga GP</p> <p>D. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve</p>	Në mënyrë që të kompletohet Profili i PZHK nevojitet që të grumbullohen të dhënat e kërkuara sipas UA për PZHK.	2 javë	KD, GP
3. Shqyrtimi publik i Profilit	<p>A. Përgatitja e prezantimit të Profilit për shqyrtimin publik;</p> <p>B. Zhvillimi i shqyrtimin publik të Profilit.</p>	Në mënyrë që të plotësohet Profili me të dhënat e fundit, është i nevojshëm prezantimi publik i tij.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
4. Plotësim dhe përfundimi i Profilit	A. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët		1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

4. Përgatitja e Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografike të Profilit Komunal	<p>A. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese në raport synimet e qeverisë qendrore dhe standardeve hapësinore, si vijon:</p> <p>a. Gjendja ekzistuese e zhvillimit ekonomik</p> <p>b. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës teknike</p> <p>c. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës së transportit dhe transportit Publik</p> <p>d. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës publike</p> <p>e. Gjendja ekzistuese e infrastrukturës sociale</p> <p>f. Gjendja ekzistuese e mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri</p> <p>g. Gjendja ekzistuese e aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike</p> <p>h. Gjendja ekzistuese e vendbanimeve</p> <p>i. Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës.</p>	Përpilimi i përmbajtjes tekstuale, grafike dhe hartografike të Profilit Komunal	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
2. Konsultimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga Grupet Punuese	<p>A. Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga KD</p> <p>B. Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese Profilit nga GP</p> <p>C. Shqyrtimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese</p> <p>D. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve</p>	Konsultimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese nga Grupet Punuese	2 javë	KD, GP

<p>3. Shqyrtim i publik i Vlerësim it të Gjendjes Ekzistuese</p>	<p>A. Përgatitja e shqyrtimit publik të Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese për prezantim publik; B. Zhvillimi i shqyrtimit publik të Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese.</p>	<p>Prezantimi publik i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese</p>	<p>2 javë</p>	<p>Udhëheqë si komunal i projektit</p>
<p>4. Plotësimi dhe përfundimi i Vlerësim it të Gjendjes Ekzistuese</p>	<p>A. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët</p>	<p>Plotësimi dhe përfundimi i Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese</p>	<p>1 javë</p>	<p>Udhëheqë si komunal i projektit</p>

5. Analiza SWOT

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Zhvillimi punëtorisë për caktimin e SWOT analizës, Vizionit, Qëllimeve, Objektive dhe Prioriteteve Strategjike	<p>A. Përcaktimi i agjendës dhe pjesëmarrësve në punëtori</p> <p>B. Përcaktimi i SWOT analizës të gjendjes ekzistuese për:</p> <p>a. Gjendjen ekzistuese e zhvillimit ekonomik,</p> <p>b. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës teknike,</p> <p>c. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës së transportit dhe transportit publik,</p> <p>d. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës publike,</p> <p>e. Gjendjen ekzistuese të infrastrukturës sociale</p> <p>f. Gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri</p> <p>g. Gjendjen ekzistuese të aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike</p> <p>h. Gjendjen ekzistuese të vendbanimeve</p> <p>i. Gjendjen ekzistuese të shfrytëzimit të tokës.</p> <p>C. Përcaktimi i Vizionit dhe Qëllimeve</p>	Në mënyrë që planifikimi të jetë i harmonizuar dhe i qëndrueshëm, nevojitet që të zhvillohet një punëtori me KD, punonjës të drejtorive të ndryshme komunale dhe pjesëtarë tjerë të GP.	1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
	D. Përcaktimi i Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike për zhvillimin: a. Ekonomik b. Infrastrukturës teknike c. Infrastrukturës së transportit dhe transportit publik d. Infrastrukturës publike e. Infrastrukturës sociale f. Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri g. Aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike h. Vendbanimeve i. Shfrytëzimit të tokës.			
2. Përgatitja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor	A. Përgatitja e Kornizës së Zhvillimit Hapësinor dhe skenarëve të mundshëm; B. Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga KD C. Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor Profilit nga GP D. Shqyrtimi i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor nga konsulentët E. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve	Në mënyrë që të kompletohet Profili i PZHK nevojitet që të grumbullohen të dhënat e kërkuara sipas UA për PZHK.	4 javë	KD, GP

<p>3. Shqyrtimi publik i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor</p>	<p>A. Përgatitja e shqyrtimit publik të Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor për prezantim publik; B. Zhvillimi i shqyrtimit publik të Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor.</p>	<p>Në mënyrë që të kompletohet PZHK, të përkrahet dhe zbatohet nevojitet prezantimi i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor</p>	<p>2 javë</p>	<p>Udhëheqësi komunal i projektit</p>
<p>4. Plotësimi dhe përfundimi i Vizionit, Qëllimeve, Objektivave dhe Prioriteteve Strategjike dhe Kornizës së Zhvillimit Hapësinor</p>	<p>A. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët</p>		<p>1 javë</p>	<p>Udhëheqësi komunal i projektit</p>

6. Përgatitja e Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Përgatitja e Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim	<p>A. Përcaktimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim për arritje e qëllimeve dhe objektivave në fushën:</p> <p>a. Ekonomike</p> <p>b. Infrastrukturës teknike</p> <p>c. Infrastrukturës së transportit dhe transportit publik</p> <p>d. Infrastrukturës publike</p> <p>e. Infrastrukturës sociale</p> <p>f. Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri</p> <p>g. Aseteve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike</p> <p>h. Vendbanimeve</p> <p>i. Shfrytëzimit të tokës.</p>	Në mënyrë që planifikimi të jetë i harmonizuar dhe i qëndrueshëm, nevojitet që të zhvillohet një punëtori me KD, punonjës të drejtorive të ndryshme komunale dhe pjesëtarë tjerë të GP.	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
2. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim	<p>A. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim nga KD</p> <p>B. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim nga GP</p> <p>C. Shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim nga konsulentët</p> <p>D. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve</p>	Në mënyrë që të përcaktohen veprimet sipas planeve sektoriale dhe kornizës kohore nevojitet shqyrtimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim.	1 javë	KD, GP

3. Plotësimi dhe përfundimi i Planit të Veprimit, Dispozitave për Zbatim dhe Monitorim	A. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga banorët		1 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
--	--	--	--------	--------------------------------

7. Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së Planit Zhvillimor Komunal

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes së PZHK.	A. Përfundimi i Kapitullit të Sfondit B. Konsolidimi i tërë dokumentit	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK.	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
2. Dorëzimi i PZHK-së në MMPHI për vlerësimin e përmbajtjes para zhvillimit të Shqyrtimit Publik	A. Dorëzimi i draftit përfundimtar të PZHK në MMPHI; B. Përgatitja e prezantimit të draftit përfundimtar të PZHK-së në MMPHI; C. Prezantimi i draftit përfundimtar të PZHK në MMPHI. D. Miratimi i MMPHI-së për iniciimin e shqyrtimit publik të Draftit përfundimtar të PZHK-së në MMPHI	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

8. Shqyrtimi Publik i Planit Zhvillimor Komunal

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Vendimi për zhvillimin e Shqyrtimit Publik	A. Përgatitja e vendimit për shqyrtimin publik të PZHK-ës; B. Njoftimi i banorëve dhe akterëve tjerë për zhvillimin e shqyrtimit publik;	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK.	1 javë	Kryetari i Komunës

2. Zhvillimi i Shqyrtimit Publik	A. Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi publik i draftit përfundimtar të PZHK B. Mbajtja e ekspozitës të përmbajtjes së draftit përfundimtar të PZHK C. Pranimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve nga banoret dhe akterëve tjerë.	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK.	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
3. Raporti shqyrtimit Publik	A. Përgatitja e Raportit të Shqyrtimit Publik	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
4. Inkorporimi i vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve	A. Ndryshimi i PZHK në përputhje me vërejtjet, komentet dhe sugjerimet e arsyeshme të dorëzuara,	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK.	2 javë	Udhëheqësi komunal i projektit

9. Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal

Detyrat	Aktivitetet	Qëllimi	Kohëzgjatja	Përgjegjës
1. Miratimi i PZHK-së nga MMPHI	A. Dorëzimi i PZHK në MMPH për miratim B. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga MMPH, në rast se ka C. Miratimi i PZHK-së nga MMPHI	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK.	4 javë	Udhëheqësi komunal i projektit
2. Miratimi i PZHK-së nga Kuvendi Komunal	A. Dorëzimi i PZHK në Kuvend Komunal për miratim B. Inkorporimi i komenteve dhe sugjerimeve nga Kuvendi Komunal, në rast se ka; C. Miratimi i PZHK nga Kuvendi Komunal	Këto janë ecuritë ligjore që duhet përmbushur gjatë hartimit të PZHK.	2 javë	Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE MBROJTJES Së MJEDISIT

Bazuar në nenin 62.3, ndërlidhur me nenet 11, 12.2 shkronja d), nenit 17 shkronja b) dhe nenin 40 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 5 nën paragrafi 1.2.3, nenin 6 nën paragrafi 1.2, nenit 10 nën-paragrafi 2.3, nenin 11 nën paragrafët 1.2 dhe 1.6 dhe nenin 17 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr.04/L-174, Udhëzimin Administrativ MMPH nr.01/18 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimin Administrativ MMPH nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, në zbatim të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës e miratuar me Vendimin nr.prot.01-020/02-0030654/22 datë 29.04.2022, nenin 64 paragrafi 4, ndërlidhur me nenet 14, 15 paragrafi 2.4, nenin 19 paragrafi 1.2 dhe nenin 34 paragrafi 2.12 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPL) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Kuvendit të Komunës së Podujevës i,

Propozohet

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN INDUSTRIALE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Plani Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës, për periudhën 2024 - 2032.

Neni 2

Plani Rregullues i Hollësishëm sipas këtij Vendimi përcakton rregullimin e hapësirës përkatëse të Zonës Industriale në Komunën e Podujevës siç është përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal dhe me Hartën Zonale të Komunës.

Neni 3

Zona për të cilën është hartuar Plani Rregullues i Hollësishëm sipas këtij vendimi, është Zona Industriale në Zonat Kadastrale Podujevë dhe Livadicë - Komuna e Podujevës në sipërfaqe prej 613911 m².

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm mbulon periudhën 8 vjeçare, nga dita e hyrjes në fuqi, dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 5

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Podujevës është përgjegjëse për zbatimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës, në bashkëpunim dhe bashkërendim me Drejtorinë, sektorët dhe autoritet tjera relevante të Komunës së Podujevës

Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 07-350/01-0060273/24
Podujevë, datë: 03.09.2024

Drejtori
Leutrim Krasniqi



ARSYETIM

Pas miratimit të Hartës Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022-2030 me Vendimin nr.prot.01-020/02-0030654/22 datë 29.04.2022, është përcaktuar që në Hartën Zonale të identifikohen zonat për të cilat kërkohet të hartohen Plane Rregulluese të Hollësishme.

Me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0090910/23 datë 28.12.2023 është filluar hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale me qëllim të përcaktimit të kushteve dhe rregullimit të hapësirave për Zonën e cekur.

Me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-944/01-0015793/24 datë 04.03.2024 projekt dokumenti i Planit Rregullues të hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës është vënë në shqyrtim publik në mënyrë që qytetarët, Grupet e interesit, agjencitë si dhe departamentet dhe organet tjera të japin komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre lidhur me Projekt dokumentin Plani Rregullues i Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës.

Shqyrtimi publik i Projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës ka zgjatur 30 ditë sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin përkatës në fuqi.

Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Komunën e Podujevës si dokument final dërgohet në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) e ndërlidhur me nenet 5 shkronja b), 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 6 paragrafi 1.1 dhe 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 3 paragrafi 1.2, dhe 17 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2019, në kërkesë dhe propozim të Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i;

PROPOZON **VENDIM**

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS - Njësia kadastrale **P-437-1** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Podujevë me sipërfaqe prej **231m²** në vendin e quajtur “Qytet , Rruga Skenderbeu ” me shfrytëzim aktual shtëpi-ndërtesë me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Q2P-B1 zonë ndërtimore.

Neni 1

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim paraparak Njësia kadastrale **P-437-1** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Podujevë në vendin e quajtur “Qytet , Rruga Skenderbeu” me shfrytëzim aktual shtëpi-ndërtesë me destinim sipas Hartës Zonale Q2P-B1 zonë ndërtimore e evidentuara në çertifikatën pronësore **08-942/06-0054377/24** të datës 14.08.2024 dhe kopjën së planit, si dhe dokumentacionit përkatës bashkëngjitur këtij propozim vendimi.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij propozim vendimi, është shfrytëzimi për qëllime afariste, krijim i mundësive për vende të reja të punës dhe rritje e të hyrave vetanake.

Neni 3

Afati kohor për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 sipas këtij propozim vendimi është afatshkurtër përkatësisht në periudhë 10 (dhjetë) vite.

Neni 4

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtë realizohet përmes ankandit publik të cilat zbatohen nga Komisioni përkatës vlerësues i cili ngritet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi, pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi dhe procedurave përkatëse ligjore dhe nënligjore, kujdeset Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i cili formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 7

Pas shqyrtimit dhe miratimit, si dhe përfundimit të procedurave të shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë së këtij akti, i njëjti hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës.

Nr.Pro: 02-463/06-0059877/24
Me datë 02.09.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bëlliuq





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 18 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 18 të Rregullores QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 2.4, të Statutit të Komunës Nr.Prot: 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i

PROPOZON

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunes . Njësia kadastrale **P-4371** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Podujevë me sipërfaqe **231m²**, **shtëpi ndërtesë** në Vendin e quajtur “Qytet , Rruga Skenderbeu ” me destinim sipas hartës zonale kadastrale Q2P-B1 zonë ndërtimore.

Neni 1

FORMOHET KOMISIONI VLERËSUES për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për 10-të vite sipas vendimit

_____ të datës: ____/____/____ për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme të Komunës: Njësia kadastrale **P-4371** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Podujevë me sipërfaqe **231m²**, **shtëpi-ndërtesë** në Vendin e quajtur “Qytet ,Rruga Skenderbeu”.

1. _____, nga Kuvendi i Komunës
2. _____, nga Kuvendi i Komunës
3. _____, nga Ekzekutivi i Komunës
4. _____, nga Ekzekutivi i Komunës
5. _____, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit me

Nr.pro. _____ të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës: ____/____/____.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren Nr.06/2021.

Nr.Pro: 02-020/04-0053851/24
Më 02-03-2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712062-00437-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

08-942/06-0054377/24

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

14.08.2024 - 13:34

Komuna / Opština / Municipality:

PODUEJVE / PODUEVO / PODUEVË

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Podujevë / Podujevo / Podjêvë

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

PODUEJVE / PODUEVO / PODUEVË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71712062-00437-1	PARCELE / PARCELA / PARCEL.	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		231			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
QYTET-RR. SKENDERBEU				

A.2 LLOJIT I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORSCENJA / TYPE OF USE

Numri i Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto korscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kualiteti i klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Tokë Ndërtimore/Gradëvniko zemljište/Construction land	Shëqerj- Ndërtimor/Kucina Zgjerda/Liouse-Building		231

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personal Lienit broj ID. No.	Vendbanimi Prethvaliste Residenti	Kodi postaral Poštanski kod Postal code	Matësitë e adresës Poljednosti adrese Address details	Pjesa e pranis Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseduar individual Individualna Drzavina Single possessor	Komuna e Podujevës	600534946	PODUEVE / PODUEVO PODUEVE		NICHI GASHI	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : **PODUJEVË**

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: **Podujevë**

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71712062-00437-1	Parcelë / Parcela / Parcel	231



Shkalla/Razmera/Scale: 1:167

Punoi/Obradio/Created: Valon Beselica

Nënshkrimi/Potpis/Signature: 

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 14.08.2024

Koha/ Vreme/ Time: 03:01:56

Kërkoni në bazën e hartës kadastrale

Mjeshtëri administrative

Komuna: **PODULJEVE**
Zona kadastrale: **Poduljeve**

Mjeshtëri kadastrale

Parcelë: **00437-1**
Lloji i njësive kadastrale: **P-71712062-00437-1**
ID e njësive kadastrale: **P-71712062-00437-1**

Derishtsi objektet e arkivës
 Derishtsi objektet e së ardhmës

Kërkoni në bazën e

identifikuesit i plotë: **197/202** Valide prej: **29.05.2019** Valide

Raporti i njësive kadastrale on





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) e ndërlidhur me nenet 5 shkronja b), 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 6 paragrafi 1.1 dhe 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 3 paragrafi 1.2, dhe 17 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2019, në kërkesë dhe propozim të Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i;

PROPOZON **VENDIM**

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS - Njësia kadastrale **P-704-0** dhe **P- 706-0** të cilat gjenden në Zonën Kadastrale Llapashticë e Poshtme me sipërfaqe prej **9937m²** ku nga kjo sipërfaqe planifikohet të ipen në shfrytëzim **5500 m²** në vendin e quajtur “ Arë nën Vorreza ” me shfrytëzim aktual kullosë me klasë 2 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale një pjesë shfrytëzim i përzier ndërsa pjesa tjetër Zonë bujqësore .

Neni 1

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim paraprak Njësia kadastrale **P-704-0** dhe **P- 706-0** të cilat gjendet në Zonën Kadastrale Llapashticë e Poshtme në vendin e quajtur “Arë nën Vorreza ” me shfrytëzim aktual kullosë me klasë 2 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale një pjesë shfrytëzim i përzier ndërsa pjesa tjetër Zonë bujqësore të evidentuara në çertifikatën pronësore **08-942/06-0054377/24** të datës 14.08.2024 dhe kopjes së planit, si dhe dokumentacionit përkatës bashkëngjitur këtij propozim vendimi.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij propozim vendimi, është shfrytëzimi për qëllime afariste, krijim i mundësive për vende të reja të punës dhe rritje e të hyrave vetanake.

Neni 3

Afati kohor për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 sipas këtij propozim vendimi është afatshkurtër përkatësisht në periudhë 10 (dhjetë) vite.

Page 1 of 2

Neni 4

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtë realizohet përmes ankandit publik të cilat zbatohen nga Komisioni përkatës vlerësues i cili ngritet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi, pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi dhe procedurave përkatëse ligjore dhe nënligjore, kujdeset Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i cili formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 7

Pas shqyrtimit dhe miratimit, si dhe përfundimit të procedurave të shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë së këtij akti, i njëjti hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës.

Nr.Pro: 02-463/06-0059880124

Me datë 02.09.2024

Kryetari i Komunës

Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 18 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 18 të Rregullores QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 2.4, të Statutit të Komunës Nr.Prot: 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i

PROPOZON

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunes . Njësia kadastrale P-704-0 dhe P-706-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Llapashticë e Poshtme me sipërfaqe 9937m², ku nga kjo sipërfaqe planifikohen të ipen në shfrytëzim 5500 m² me shfrytëzim aktual kullosë me klasë 2 në Vendin e quajtur “Arë nën Vorreza ” me destinim sipas hartës zonale kadastrale një pjesë shfrytëzim i përzier ndërsa pjesa tjetër zonë bujqësore.

Neni 1

FORMOHET KOMISIONI VLERËSUES për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për 10-të vite sipas vendimit

_____ të datës: ____/____/____ për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme të Komunës: Njësia kadastrale P-704-0 dhe P-706-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Llapashticë e Poshtme me sipërfaqe 9937m², ku nga kjo sipërfaqe planifikohen të ipen në shfrytëzim 5500 m² në Vendin e quajtur “Arë nën Vorreza”.

1. _____, nga Kuvendi i Komunës
2. _____, nga Kuvendi i Komunës
3. _____, nga Ekzekutivi i Komunës
4. _____, nga Ekzekutivi i Komunës
5. _____, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Page 1 of 2

Mandati i Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit me

Nr.pro. _____ të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës: ____/____/_____.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

